ISSN 1857-6443

Për rroga 2 miliardë euro

FAQE 2

Kursimi ruan portofolin

FAQE 4

Nxënësit e Novosellës në dy objekte

FAQE 5

Balfin me investim 300 mln euro!

FAQE 6

www.koha.mk

Koha

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3204 • E mërkurë 25 tetor 2017 | 15 DEN

Mos pushoni së luftuari

FAQE 16

Garë agresive për fitore

Shkup, 24 tetor - Në ditët e fundit të fushatës për rrethin e dytë zgjedhor, gara politike po bëhet më agresive në terren në të dyja kampet politike. Partitë opozitare maqedonase dhe ato shqiptare akuzojnë partitë në pushtet për blerje të votave në rrethin e parë dhe se vazhdojnë shfrytëzimin e resurseve shtetërore për rrethine dytë të zgjedhjet lokale. LSDM në pushtet dhe lideri i saj, Zoran Zaev, përveç që zhvillon një luftë të drejtpërdrejtë në terren me VMRO-në e Nikolla Gruevskit, në 40 komuna, ata janë po aq aktiv në kampin shqiptar krah për krah me kandidatë e BDI-së për kryetar komune kundrejt kandidatëve të koalicionit ASH-BESA. LSDM me BDI-në ka lidhur më herët një koalicion për ta ndihmuar në Komunën e Tetovës dhe Çairit, por që tani kanë zgjeruar bashkëpunimin...

Faqe 3

Zgjidhje e përkohshme për kontestin në Manastir

Muzeu i Alfabetit merr muzeun me qira

Por pavarësisht marrëveshjes së qiramarrjes, e cila do të sigurojë që të paktën në hyrje të muzeut të mos shiten materiale hidrosanitare, kjo pjesë e muzeut nuk do të rikonstruktohet nga fondet Ipa, projekt ky që duhet të nisë muajin e ardhshëm dhe që do të rikthejë në identitet një prej objekteve më emblematike të historisë dhe kulturës shqiptare

FAQE 2

GLOBI

Përdorimi i urisë si armë lufte është një krim lufte

Raportuesja Speciale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ushqimore, Hilal Elver thotë se uria dhe sëmundjet po shkaktojnë më shumë vdekje se sa përleshjet në rajonet e luftës. Elver në një konferencë për media në Qendrën e Përgjithshme të OKB-së njoftoi për raportin vjetor të prezantuar në Këshillin e....

FAQE 15

SPECIALE

Tri dekadat e Murit që ndau botën

FAQE 16

GLOBI

Gjermania edhe i shet dhe i paguan nëndetëse Izraelit

FAQE 15

Vendoset për ekstradimin e Grujoskit dhe Boshkovskit

Shkup, 24 tetor - Gjykata Penale e Shkupit, gjatë ditëve në vazhdim pritet të miratoi vendim se vallë do të lejojë përmbylljen e procedurës për ekstradim të Goran Grujoskit dhe Nikolla Boshkovskit, ose do të vazhdojë me praktikën e deritanishme të bllokimit të punës së Prokurorisë Speciale Publike. Në një prononcim për media nga GJPSH-ja kanë thënë se të premten e kaluar Këshilli penal i sektorit për krim të organizuar, nga Gjykata e Apelit e ka pranuar kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, për kompletim të dokumentacion për ekstradim të dy ish agjentëve të DSK-së, nga Greqia në Maqedoni. Mirëpo, nga GJPSH-ja, nuk kanë treguar se kur pritet të miratohet ky vendim, por vetëm kanë theksuar se Këshilli Penal është duke e proceduar kërkesën e organeve përkatëse dhe se opinionin me kohë do të njoftohet për të gjitha risitë që lidhen me këtë temë. Procedura e ekstradimit për dy të akuzuarve...

FAQE 5

REPORTAZH

Rreziku nga depërtimi



FAQE 17

Që kur u hap për herë të parë në vitin 2007, me rastin e 100 vjetorit të Kongresit të Manastirit, kjo godinë sinjifikative për historinë dhe kulturën shqiptare nuk është mirëpritur nga banorët joshqiptarë të qytetit

Zgjidhje e përkohshme për kontestin në Manastir

Muzeu i Alfabetit merr muzeun me qira!

Por pavarësisht marrëveshjes së qiramarrjes, e cila do të sigurojë që të paktën në hyrje të muzeut të mos shiten materiale hidrosanitare, kjo pjesë e muzeut nuk do të rikonstruktohet nga fondet Ipa, projekt ky që duhet të nisë muajin e ardhshëm dhe që do të rikthejë në identitet një prej objekteve më emblematike të historisë dhe kulturës shqiptare

Koha Evis HALILI

Shkup, 24 tetor - Rreth një mijë euro në muaj do të paguajë Ministria e Kulturës për të shfrytëzuar katin e parë të Muzeut të Alfabetit në Manastir. Kjo është marrëveshja e bërë me pronarin e katit të parë të godinës, me të cilin deri tani kanë dështuar të gjitha tentativat për të rimarrë pronësinë e kësaj pjese të muzeut nga ana e Ministrisë së Kulturës. Por, pavarësisht marrëveshjes së qiramarrjes, e cila do të sigurojë që të paktën në hyrje të muzeut të mos shiten materiale hidrosanitare, kjo pjesë e muzeut nuk do të rikonstruktohet nga garanti i Fondeve të zhvillimit Ipa, projekt ky që duhet të nisë muajin e ardhshëm dhe që do të rikthejë në identitet një prej objekteve më emblematike të historisë dhe kulturës shqiptare. Edhe pse bëhet fjalë për investimin më serioz për këtë institucion, i cili prej vitesh është në gjendje shumë të keqe, vetë projekti me të cilin u konkurrua në fondet IPA nuk u perceptua seriozisht nga institucionet shtetërore. Për rrjedhojë edhe rikonstruktimi i plotë është refuzuar prej tyre, për shkak se pronar nuk është shteti. Kështu sqaron drejtori Nuer Arsllani, sipas të cilit kjo ka qenë një prej pengesave dhe ndryshimeve në projektin rikonstruktues prej 300 mijë euro, me të cilin Shtëpia e Alfabetit do të rikonstruktohet tërësisht dhe do të kthehet në identitet.

"Është mirë që arritëm një marrëveshje me pronarin, qoftë edhe për ta marrë me qira. Kjo është një praktikë që e has edhe nëpër muze të tjera në vend, dhe për në është një hap i leverdishëm. Meqenëse kontesti i pronësisë nuk u zgjidh dhe katin e parë nuk e kemi në pronësi, me projektin e miratuar nga IPA, kjo pjesë e muzeut nuk do të rikonstruktohet, por do të mundohemi që të sigurojmë fonde të tjera për ta adaptuar dhe për të qenë në funksion të muzeut. Të paktën e dimë që aty, në dyqanet ne hyrje të muzeut nuk do të shiten më pllaka dhe aksesorë për banja", thotë Arsllani. Sipas tij ambientet e katit të parë do të përshtaten për të siguruar shërbime shtesë, si sportel dhe sallë pritje, kafe librari, e të tjera. Ndërsa kati i sipërm dhe fasada do të kthehen në gjendjen që kanë qenë, duke iu referuar dokumenteve dhe fotografive që ruhen pas rindërtimit që i është bërë godinës në 1925, kur ish hotel Liria në pronësi të Themistokli Gërmenjit, mbas viteve 20-të të shekullit të kaluar kaloi në një pronësi tjetër dhe u shndërrua në një shtëpi. Gjatë periudhës së Ish Jugosllavisë ka qenë në shërbim të komunës, administratës së ujësjellësit. Projekti që realizohet me grantin e Ipa-s duhet të përfundojë brenda dhjetë muajsh dhe po ashtu parashikon instalimin e një rrjet të ri hidraulik dhe elektrik.

Që kur u hap për herë të parë në vitin 2007, me rastin e 100 vjetorit të Kongresit të Manastirit, por edhe pasi u shpall muze disa vjet më vonë, kjo godinë sinjifikative për historinë dhe kulturën shqiptare nuk është mirëpritur nga banorët joshqiptarë të qytetit duke u shndërruar në një tabelë të shfrimit të urrejtjes etnike. Jo vetëm që është zhgarravitur me parulla raciste antishqiptare, por disa herë janë thyer xhamat dhe është tentuar që të digjet. Kjo është edhe një prej arsyeve kryesore që edhe shënimi i 22 nëntorit, Ditës së Alfabetit të gjuhës shqipe, zakonisht zhvillohet vetëm atë ditë, edhe përkundër tentativave për ta shënuar si një javë, aq sa edhe zgjatën punimet e Kongresit.

Sfidë nëse dimë të shfrytëzojmë IPARD fondet

Shkup, 24 tetor - Para institucioneve përgjegjëse për zbatimin e IPARD-it vijon një sfidë e madhe që të realizohen me kohë kërkesat nga Programi 2014-2020 dhe të përmirësohet situata me përdorimin e fondeve parainkuadruese, konsideron drejtori i përgjithshëm për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Komisionit Evropian, Jerzhi Bogdan Pleva. Në takimin e punës me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Lupço Nikolovski në Bruksel, Pleva edhe një herë ka porositur se resurset njerëzore dhe funksionaliteti i Agjencisë Pagesore janë kyçe për përdorimin efikas të fondeve IPARD. Sipas MBEU, Pleva pozitivisht e ka vlerësuar interesin e madh dhe numrin e kërkesave për përdorimin e mjeteve financiare nga IPARD 2014-2020 në thirrjen e parë publike 01/2017 dhe ka shprehur shpresë se përvoja me shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD 2007-2013. Për Qeverinë e re të Republikës së Maqedonisë, anëtarësimi në BE është një përparësi kryesore dhe në këtë drejtim tashmë janë bërë analiza dhe janë ndërmarrë masa për zbatimin e suksesshëm të mjeteve IPARD 2014-2020, ka informuar ministri Nikollovski. Sipas tij, dy aktivitetet e rëndësishme në të cilat punohet për forcimin e Agjencisë Pagesore dhe shërbimeve këshilldhënëse si dhe vendosjen e mekanizmit për para financimin e shfrytëzuesve të IPARD-it. Planifikohet, ka theksuar Nikollovski edhe vendosjen e masave të reja në IPARD 2014-2020: investime në infrastrukturën rurale publike dhe qasjen LEADER. Pleva e ka përshëndetur idenë për vendosjen e masave të reja, veçanërisht në qasjen LEADER, i cili, siç ka vlerësuar, është tregim i suksesshëm në vendet anëtare. Në takimin në Bruksel nga ana e Komisionit Evropian kanë marrë pjesë edhe drejtori për zhvillim rural dhe mbështetje parainkudruese Mario Millusev, si dhe persona të tjerë udhëheqës pranë KE-së, kompetentë për Republikën e Maqedonisë dhe për mbështetje parainkuadruese për hyrje në Bashkimin Evropian.

Sektori privat vitin e kaluar me qarkullim vjetor prej 18 miliardë euro

Për rroga janë harxhuar 2 miliardë euro

Pjesa më e madhe e kompanive apo 41 për qind janë firma tregtare që përbëjnë një të tretën nga gjithsej 375.129 të punësuar dhe kanë realizuar gjysmën e qarkullimit vjetor prej 18 miliardë euro, gjegjësisht 24 për qind të vlerës së shtuar

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 24 tetor - Mbi 50 mijë kompani në Maqedoni që në mënyrë aktive ushtrojnë veprimtari, vitin e kaluar kanë realizuar qarkullim vjetor prej mbi 18 miliardë euro, ndërsa të gjithë kompanitë bashkë nga sektori privat, për një të punësuar mesatarisht brenda një viti kanë paguar rrogë vjetore prej 5.331 euro apo mbi 2 miliardë euro kanë ndarë rroga për gjithsejtë 375.129 të punësuar, që i bie të jetë 11 për qind nga vlera e përgjithshme e qarkullimit vjetor prej 18 miliardë euro. Kështu tregojnë të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikës (ESHS) për punën e mbi 50 mijë kompanive nga sektori privat gjatë vitit 2016. Me këtë qarkullim vjetor, kompanitë private në Maqedoni kanë realizuar rreth 4 miliardë euro nga vlera e shtuar. Krahasuar me vitin paraprak 2015, të dhënat e ESHS-së për firmat private me orientim të tregut, qarkullimi vjetor është rritur për 3 për qind, ndërsa vlera e shtuar është rritur për 7 për qind. Sipas këtyre të dhënave, pjesa më e madhe e kompanive apo 41 për qind janë firma tregtare që përbëjnë një të tretën nga gjithsej 375.129 të punësuar dhe kanë realizuar gjysmën e qarkullimit vjetor prej 18 miliardë euro, gjegjësisht 24 për qind të vlerës së shtuar. Numri më i madh i të punësuarve, gjegjësisht 36 për qind nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin privat, është në industrinë e përpunimit, e cila ka krijuar një të katërtën apo 26.4 për qind nga totali i vlerës së shtuar. Vitin e kaluar edhe ndërtimtaria mori pjesë me 11 për qind në krijimin e vlerës së shtuar, transporti me 8.6 për qind, furnizimin me energji elektrike me 7.1 për qind. Firmat private në Maqedoni në përgjithësi kanë më pak se 10 të punësuar dhe në këto kompani të vogla punojnë rreth 90 për qind nga numri i përgjithshëm i subjekteve afariste të regjistruar në Regjistrin qendror të Maqedonisë dhe për veprimtari kryesore kanë tregtinë me shumicë dhe pakicë. Në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ku ka më pak se 10 të punësuar punon çdo i treti punëtor nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin privat në Maqedoni. Dhe këto firma të vogla dhe të mesme krijojnë 22 përqindëshin e tatimit të shtuar. Në anën tjetër, në firmat e mëdha punojnë 0.3 për qind e punonjësve nga numri i përgjithshëm i të punësuarve dhe atë në përgjithësi në sektorin e industrisë përpunuese, duke krijuar kështu 34.2 për qind të tatimit të shtuar. Edhe përkundër qarkullimit vjetor prej 18 miliardë euro, të gjithë kompanitë së bashku për rrogat e punëtorëve apo për një të punësuar mesatarisht në vitin 2016, kanë paguar pagë vjetore prej 5.331 apo për gjithsej 375.129 të punësuar në mbi 58 kompani private, brenda një viti totali i pagave të paguara për vitin 2016 është diçka më shumë se 2 miliardë euro.

Ditët e fundit të fushatës për rrethin e dytë zgjedhor

Garë agresive për fitore

Partitë opozitare maqedonase dhe ato shqiptare akuzojnë partitë në pushtet për blerje të votave në rrethine parë dhe se vazhdon shfrytëzimi i resurseve shtetërore për rrethine dytë të zgjedhjet lokale. LSDM në pushtet dhe lideri i saj, Zoran Zaev, përveç që zhvillon një luftë të drejtpërdrejtë në terren me VMRO-në e Gruevskit, ai është po aq aktiv edhe në kampin shqiptar - krah për krah me kandidatë e BDI-së për kryetar komune kundrejt kandidatëve të koalicionit ASH-BESA

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 24 tetor - Në ditët e fundit të fushatës për rrethin e dytë zgjedhor, gara politike po bëhet më agresive në terren në të dyja kampet politike. Partitë opozitare maqedonase dhe ato shqiptare akuzojnë partitë në pushtet për blerje të votave në rrethin e parë dhe se vazhdojnë shfrytëzimin e resurseve shtetërore për rrethine dytë të zgjedhjet lokale. LSDM në pushtet dhe lideri i saj, Zoran Zaev, përveç që zhvillon një luftë të drejtpërdrejtë në terren me VMRO-në e Nikolla Gruevskit, në 40 komuna, ata janë po aq aktiv në kampin shqiptar krah për krah me kandidatë e BDI-së për kryetar komune kundrejt kandidatëve të koalicionit ASH-BESA. LSDM me BDI-në ka lidhur më herët një koalicion për ta ndihmuar në Komunën e Tetovës dhe Çairit, por që tani kanë zgjeruar bashkëpunimin në të gjitha komunat ku BDI është në balotazh me kandidatë e ASH- së dhe Lëvizjes BESA. Këta të fundit lidhën koalicion vetëm pas rrethit të parë, në të cilin BDI doli e para në shumicën e komunave, ndërsa fitoi pa balotazh në Kërçovë dhe në Pllasnicë. Shikuar në numra, votat e ASH-së dhe Lëvizjes BESA po të mblidhen në të gjitha komunat dalin më shumë se votat që morën kandidatët e BDI-së në rrethin e parë, por mbetet të shihen nëse do të ruhen këto vota për rrethin e dytë dhe nga ana tjetër - sa do të ndikojë ndihma e LSDM-së për BDI-në, ku në disa qytete mund të jetë vendimtare si në Tetovë, Gostivar dhe në Strugë. Kur jemi tek Struga, në opinion pati zëra se Zaev nuk do të del hapur të përkrah Ramiz Merkon siç bëri në Gostivar me Nevzat Bejten dhe Visar Ganiun në Çair. Por nga BDI, zyrtarë të lartë të saj thonë se të enjten, Zaevi do të dalë në krah ta Merkos, duke ju bërë apel mbi 7 mijë votuesve të tij në këtë komunë që të votojnë kandidatin e BDI-së për kryetar. Sipas këtyre zyrtarëve, ASH duke pasur partner LSDM-në dhe BDI-në në Qeveri, u ngut të lidh koalicion me një parti opozitare, dhe kjo në politikë nuk lexohet drejt. "ASH duke na pasur neve partner në qeveri dhe LSDM-në, po ashtu u ngut të bëjë koalicion me një parti tjetër opozitare në vend së të ulet dhe të merret vesh me BDI-në. Kjo do të thotë se ASH nuk ka besim tek ne, por BDI do ta mund Selën në Strugë dhe pastaj ai e di vetë se a do të rrijë apo jo në Qeveri, por BDI nuk është për dalje të ASH nga Qeveria parimisht", thonë zyrtarë të lartë të LSDM-së. Ndryshe, në opinion kishte zëra se pas rrethit të dytë zgjedhor, ASH do të dalë nga Qeveria dhe partner i ri qeveritar do të jetë PDSH e Menduh Thaçit. Në prononcimin e fundit për media, kryeministri Zaev tha se e mirëpret bashkëngjitjen e PDSH-së në krah të shumicës parlamentare. "Nëse dëshiron, PDSH e Menduh Thaçi është e mirëseardhur në shumicën parlamentare", deklaroi Zaevi, duke paralajmëruar edhe zgjerimin e shumicës parlamentare. I pyetur nëse me këtë strategji pranon edhe deputetë të ri nga opozita dhe nëse partitë e shumicës kërkojnë përkrahje për hapjen e problemit të ndryshimit të emrit, Zaevi tha se pa përkrahjen e VMRO-së, kjo problematikë as që mund të diskutohet. Zaevi është i bindur se jo vetëm që do të zgjerojë shumicën, por edhe do të vetëdijesohet opozita, pasi deputetët nën llupën e VMRO-së tashmë janë deklaruar se nuk pajtohen me politikat e Gruevskit, por ai pret që të rreshtohen në radhët e shumicës. Zaev është i habitur nga deklaratat e Gruevskit se zgjedhjet lokale janë të manipuluara, pasi sipas tij, nuk ka pasur asnjë parregullsi. Kur jemi tek bashkëpunimet për rrethin e dytë - në Tetovë ka rëndësi edhe nga do të shkojë 4 mijë votat e kandidatit të PDSH-së që i fitoi në rrethin e parë Bardhyl Dautit. Nga ana tjetër, gara mes nënkryetares së BDI-së, Teuta Arifi dhe kryetarit të Lëvizjes BESA, Bilall Kasami, ka hyrë në fazën vendimtare kur duhet bindur elektoratin sidomos atë të partive tjera shqiptare dhe atyre maqedonase për tua dhënë votën më 29 tetor. Kandidati i Lëvizjes BESA të martën ka akuzuar kryetaren Arifi se ka shpenzuar mbi një milion euro për kontrata mbi vepër për të punësuar, siç ka thënë Kasami, anëtarë partiak. "Gjatë kësaj periudhe katërvjeçare të qeverisjes së saj të dështuar, u evidentuan harxhime marramendëse për shpenzimet e saj dhe stafit, si dhe për punësime të personave me kontratë mbi vepër, kryesisht militantë partiak dhe grupe interesi që këto shërbime ia 'shpaguajnë' kryetares në ikje duke shpifur ulët për çdokënd që i zbulon dhe i shpërfaq këto fakte korruptive. Sipas informatave tashmë të publikuara nga organizata që monitorojnë komunën, 113.6 milionë denarë janë shpenzuar për kontrata mbi vepër (1 milionë e 830 mijë euro), ndërsa e pushtuar nga paniku i humbjes, tashmë vijnë informata se ajo nënshkruan dhjetëra kontrata të tilla të shërbimeve mbi vepër për periudhën pesë mujore, e të cilat në fakt janë shërbime që i ofrohen vetëm asaj, e jo qytetarëve të komunës", thuhet në komunikatën e Kasamit.

Pas zgjedhjeve, Qeveria i kthehet agjendës reformuese

Shkup, 24 tetor - Zëvendëskryeministri i angazhuar për çështje evropiane, Bujar Osmani, në takimet me funksionarë të lartë francezë në Paris e potencoi atmosferën e shkëlqyeshme dhe kushtet për mbajtjen e rrethit të dytë të zgjedhjeve lokale. Ai, siç kumtoi Sekretariati për Çështje Evropiane, theksoi se rrethi i parë ka kaluar në atmosferë të qetë, të drejtë dhe garuese, që u konfirmua në raportin preliminar të OSBE/ODIHR-së, mbështetur nga delegacioni i BE-së, Ambasada e SHBA-së, si dhe nga vëzhguesit relevant vendor. Osmani gjatë vizitës zyrtare në Paris, realizoi takime të ndara me Emanuel Lenan, këshilltar në kabinetin e kryeministrit Filip, Sabine Tilae, kryetaren e komisionit për Çështje Evropiane në kuvendin nacional të Republikës së Francës dhe me Bertrand Sore, kryetar i grupit Franko- Maqedonas në Parlamentin Francez. Gjatë takimeve zëvendëskryeministri Osmani njoftoi bashkëbiseduesit me rrjedhën e zbatimit të reformave, të cilat i përmban Plani 3-6-9. "Pjesa 3 e Planit është në fazën përfundimtare, realizimi i së cilës mbaron me përfundimin e zgjedhjeve lokale. Në një atmosferë të shkëlqyer dhe kushtet për mbajtjen e rrethit të parë të zgjedhjeve lokale dhe të cilat kaluan në një atmosferë të qetë, të drejtë dhe garuese, e cila u konfirmua edhe në raportin paraprak të OSBE/ODHIR, mbështetur nga Delegacioni i BE-së, ambasadës së SHBA-ve, si dhe nga monitorues relevant vendor" theksoi Osmani. Osmani konfirmoi edhe përkushtimin e Qeverisë për zbatimin e mëtutjeshëm të reformave të thella në drejtim të avancimit të proceseve euroatlantike të vendit. "Pas përfundimit të zgjedhjeve lokale Qeveria i kthehet agjendës reformuese, dhe në mënyrë me agresive do të ju përkushtohet masave dhe aktiviteteve të cilat janë në drejtim të shmangies të të gjitha vërejtjeve dhe pengesave për proceset euro integruese të Republikës së Maqedonisë", theksoi Osmani. Ai shtoi se qytetarët dërguan porosi të qartë deri tek përfaqësuesit politik, në rrethin e parë të zgjedhjeve lokale, që paraqet konfirmim të korrektësisë së agjendës euroatlantike të Qeverisë. Në vazhdim, siç kumtohet nga kabineti i zëvendëskryeministrit, Bujar Osmani, u hapën edhe tema lidhur me sfidat evropiane me të cilat ballafaqohen gjitha vendet evropiane, pa marrë parasysh janë ose jo anëtarë të Unionit, mes të cilave njëkohësisht edhe vendi ynë.

Tetë vende i kërkojnë Mogerinit ndërprerjen e propagandës ruse në Ballkan

Letra, e cila është dërguar para dhjetë ditëve, është nënshkruar nga ministritë e jashtme të Kroacisë, Republikës së Çekisë, Letonisë, Lituanisë, Polonisë, Rumanisë, Suedisë dhe Britanisë së Madhe, shkruan gazeta "Jutarnji list" duke theksuar që pasqyrë në letrën ka pasur portali i Brukselit "BEobserver"

Bruksel, 24 tetor - Tetë shtete evropiane nënshkruan letër deri te përfaqësuesja e lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federika Mogerini, me të cilën kërkojnë të ndërpritet propaganda ruse, veçanërisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Letra, e cila është dërguar para dhjetë ditëve, është nënshkruar nga ministritë e jashtme të Kroacisë, Republikës së Çekisë, Letonisë, Lituanisë, Polonisë, Rumanisë, Suedisë dhe Britanisë së Madhe, shkruan gazeta "Jutarnji list" duke theksuar që pasqyrë në letrën ka pasur portali i Brukselit "BEobserver". Këto vende kërkojnë që Shërbimi evropian për veprim të jashtëm (EEAS) dukshëm t'i zgjerojë aktivitetet gjatë shkatërrimit të propagandës nga Rusia, veçanërisht në rajonin e Evropës Jugore dhe Ballkanit Perëndimor. Theksohet se në letër janë treguar pohimet se "janë përballur me fushatë intensive për dezinformim, të cilën e zbaton një vend i tretë (Rusia), dhe për këtë kanë nevojë urgjente për përforcim e mëtejshëm të kapaciteteve të StratKom BE-së". Gazeta kroate përkujton se Zyra e StratKom është themeluar pranë BE-së, me vendim të mbështetur nga të gjithë anëtaret, me qëllim që të zbulohen dhe përgënjeshtrohen të pavërtetat të cilat për BE-në i përhap Rusia. Në letër kërkohet të fillojnë të punojnë me kapacitet të plotë edhe dy filiale të BE-së StratCom-it - për Jugun dhe për Ballkanin Perëndimor. StratCom është formuar para dy viteve me një vendim të Këshillit Evropian dhe vepron në kuadër të EEAS-së. Disa diplomatë besojnë se kjo u themelua kryesisht për shkak të rolit të kryetarit të Këshillit Evropian Donald Tusk, derisa Mogerini as atëherë kurrë nuk ka treguar ndonjë interes të madh për këtë. BE kërkon financim më të madh dhe mjete të mjaftueshme, që të mund të investohet në teknologji inovative. Sipas pohimeve të portalit të Brukselit, StratKom përmes Tuitter dhe rrjeteve të tjera sociale po përpiqet t'i përgënjeshtrojë dezinformatat ruse dhe të promovojë ndjekje pozitive përmes veprimit të BE-së në territorin e ish-Bashkimit Sovjetik. StratCom ka rreth 30.000 ndjekës në Tuiter. Për StratKom punojnë vetëm 14 persona, prej të cilëve 10 janë diplomatë nga shtetet anëtare të BE-së. Në departamentin për Ballkanin Perëndimor punojnë edhe dy diplomatë ndërsa gjashtë në Departamentin jugor i cili kryesisht merret me fushata kundër islamizimit radikal.

Përllogaritjet tregojnë se nëse në Maqedoni ka 550 mijë amvisëri që në mesatare përdor dy poçe nga katër orë në ditë, atëherë konsumi në nivel vjetor i rrymës arrin në afër 160 mijë megavat orë

Energjia, shumë mënyrë për të kaluar më lirë

Kursimi ruan portofolin

Njohësit e sektorit të energjetikës thonë se përkundër faktit se kursimet më të mëdha arrihen me ndryshimin e dritareve, apo izolimin e shtëpisë ose banesës që kërkon edhe mjete jo edhe aq të vogla, megjithatë ekzistojnë mënyra që të kursehet në mënyra të ndryshme si energjia elektrike ashtu edhe ajo e ngrohjes prej 10 deri në 20 për qind.

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 24 tetor - Ulja e temperaturave dhe rritja e konsumit të energjisë elektrike për ngrohje, pritet që në periudhën e ardhshme të shtrenjtojë edhe faturat e rrymës për amvisëritë në Maqedoni. Njohësit e sektorit të energjetikës thonë se përkundër faktit se kursimet më të mëdha arrihen me ndryshimin e dritareve, apo izolimin e shtëpisë, apo banesës që kërkon edhe mjete jo edhe aq të vogla, megjithatë ekzistojnë forma që të kursehet në mënyra të ndryshme, si energjia elektrike ashtu edhe ajo e ngrohjes prej 10 deri në 20 për qind. Një nga zgjidhjet që propozohet nga ekspertët për harxhimin sa më të ulët të energjisë, është edhe zbatimi i parimeve të efikasitetit energjetik që nënkupton jo kursimin e energjisë, por kryerjen e sasisë së njëjtë ose edhe më të madhe të aktiviteteve me harxhim të sasisë së njëjtë ose më të vogël të energjisë.

"Efikasitetit energjetik nënkupton të mbani temperaturën prej 20 gradë celzius në hapësirën banuese, ndërsa të harxhoni më pak energjens, të keni ndriçim në dhomë dhe të harxhoni më pak duke përdorur poçe jo me fije që harxhon 100 vatë, por mundësisht me neon që harxhon 400 vatë që në të njëjtën kohë ju jep të njëjtin ndriçim. Apo të përdorni frigoriferët për ftohje prej të cilave disa harxhojnë 600, ndërsa ato me efikasitet energjetik harxhojnë 200 vat", thonë ekspertët e energjetikës.

Nga ana tjetër, edhe ndriçimi më efikas harxhon deri në 5 herë më pak energji. Zëvendësimi i poçeve inkandeshentë me poçet kompaktë fluoreshentë (që kursejnë energji) ose me poçe LED, është gjëja e parë që duhet të bëjë çdo familje, rekomandojnë ekspertët e energjetikës. Kursimi i energjisë elektrike është 40 për qind kur bëhet zëvendësimi i poçeve inkandeshentë me poçe fluoreshente kompakte dhe 80 për qind kur bëhet zëvendësimi i poçeve me LED. Në ndërkohë, edhe përllogaritjet e Agjencisë së Energjetikës së Maqedonisë tregojnë se me miliona euro mund të kursehen me një zëvendësim të thjeshtë të poçeve të vjetra me ato led apo fluoreshent. Përllogaritjet tregojnë se nëse në Maqedoni ka 550 mijë amvisëri që në mesatare përdor dy poçe nga katër orë në ditë, atëherë konsumi në nivel vjetor i rrymës arrin në afër 160 mijë megavat orë. Nga ana tjetër nëse shfrytëzohen poçet led, konsumi do të ulet në afër 24 mijë megavat orë që nënkupton një kursim prej afër tetë milion euro.

Gjithashtu efikasiteti energjetik nuk nënkupton vetëm izolimin e mirë të një banese por edhe ngjyrën e errët apo të çelur, që gjithashtu ndikon në kursimin e energjisë. Kursimi i energjisë mund të realizohet edhe me përdorimin e aparateve që shfrytëzojnë energjinë në mënyrë efikase. Vlerësohet se aparatet e klimës janë ndër të parët që kursejnë rrymë, ndërsa harxhues më i madh është frigoriferi. Kursim i energjisë prej 5-10 për qind mund të arrihet dhe pastrimin e filtrit të klimës. Me një pajisje të klasës A harxhohet energji elektrike më pak se gjysma e krahasuar me pajisjen e klasës G. Rekomandohet të blihen pajisjet e klasës A, A+, A++ dhe A+++, të cilat janë më efikase dhe përdorin më pak energji elektrike për të njëjtat orë pune. Preferohet edhe heqja e pajisjeve elektrike (TV, Lap¬top, DVD) nga priza që bën të mundur një kursim të energjisë elektrike deri në 10 për qind. Këto pajisje edhe në "Sleep Mode/Stand By" shpenzojnë energji. Në varësi prej mundësive financiare ia vlen të mendohet edhe për përdorimin e energjisë diellore për përgatitjen e ujit të ngrohtë sanitar dhe për ngrohjen e hapësirës banesore. Për një familje mesatare është e mjaftueshme sipërfaqja efektive e kolektorëve prej 3,6 metër katror dhe rezervuari prej 200 litër. Ngrohja diellore është zgjidhje ideale për kursimin e energjisë. Numri i madh i ditëve me diell në Maqedoni dhe shtetet e rajonit, rezulton me efikasitet të lartë, sepse sistemet diellore mesatarisht kursejnë 50-60 për qind në vit të nevojave për energji për ngrohjen e ujit. Në periudhën e verës sistemi konvencional i ngrohjes së ujit sanitar mundet plotësisht të shkyçet. Rekomandim tjetër është edhe pastrimi i rregullt i sipërfaqeve të gypave nga akulli, për shkak se shtresat e akullit në frigoriferin tuaj kontribuojnë në shpenzimin më të madh të energjisë dhe mirëmbajtjen më të dobët të ushqimit. Me rastin e pastrimit kontrolloni gjendjen e tyre si dhe gjendjen e komponentës në pjesën e pasme. Mirëmbajeni pastër gomën e derës dhe kontrollojeni që të puthitet mirë. Testi i thjeshtë i puthitjes është që të vendosni një fletë të letrës në mes gomës në derë dhe shtëpizës së frigoriferit. Nëse letra tërhiqet lehtë, atëherë ndërrojeni gomën në derë. Ndryshe, faktin se standardi i ulët i pamundëson qytetarët që më shumë të kursejnë energji përmes izolimit të shtëpive të tyre e mbështesin edhe të dhënat e institucioneve shtetërore. Sipas analizave të Entit të Statistikës, në përqindje pjesëmarrja e amvisërive që kanë vendosur izolim të ngrohjes në banesat e tyre, në raport me të gjithë amvisëritë e tyre, është 18 për qind. Analizuar sipas rajoneve, përqindja më e madhe e amvisërive me izolim me 29 për qind është në rajonin e Shkupit, ndërsa më e vogël është në rajonin e Pellagonisë me 7 për qind. Në rajonin e Pollogut izolimi është 18 për qind, në atë jugperëndimor është 27 për qind dhe në atë verilindor 12.41 për qind. Prej amvisërive që kanë të vendosur izolim në banesat e tyre, përkundër vitit të vendosjes, në pjesën më të madh kanë vendosur izolime në muret e jashtme, pastaj pasojnë izolimet e tavanit dhe pullazit, ndërsa më pak ka izolim në dyshemetë.

Luftën të përbashkët kundër krimit të organizuar

Shkup, 24 tetor - Gatishmëri për thellim të bashkëpunimit, veçanërisht në fushën e krimit të organizuar dhe hetimeve financiare kanë shprehur në takimin e së martës në Trieste ministrat e Punëve të Brendshme të Maqedonisë dhe Italisë, Oliver Spasovski Marko Miniti. Ata e kanë potencuar bashkëpunimin e shkëlqyer mes dy ministrive, i cili siç potencuan po zhvillohet në frymën e marrëdhënieve miqësore tradicionalisht të mira mes dy vendeve. Në takim, siç bëri të ditur MPB, është vënë theks në bashkëpunimin në fushën e luftës kundër drogës dhe në këtë kuptim përfaqësues të MPB-së së Maqedonisë marrin pjesë në trajnime për luftë kundër tregtisë me drogë, kryesisht në Drejtorinë qendrore për luftë kundër drogës në Romë. Miniti e ka potencuar mbështetjen pa rezervë nga Italia për reformat në Maqedoni. Ministri Spasovski dje edhe sot merr pjesë në Konferencën përfundimtare për projektin "Luftë kundër krimit të organizuar: Bashkëpunim ndërkombëtar në të drejtën penale", që mbahet në Trieste.

Fundjava fillon me llogaritjen dimërore të kohës

Shkup, 24 tetor - Llogaritja dimërore e kohës fillon fundjavën e ardhshme kur të shtunën ndaj të dielës në orën tre pas mesnate shigjetat e orës do të zhvendosen një orë pas. Kjo do të thotë se koha në orën tre do konsiderohet si ora dy. Llogaritja dimërore e kohës fillon fundjavën e fundit të tetorit dhe zgjat deri në fundjavën e fundit në mars kur fillon llogaritja verore e kohës.

Ministri Bekteshi në Sofje

Shqyrtohen mundësitë për gazsjellësin me Bullgarinë

Shkup, 24 tetor - Mundësitë për ndërtim të lidhjes së re interkonektive midis Maqedonisë dhe Bullgarisë në sferën për gaz natyror, duke i përfshirë teknikat, financat dhe aspektet rregullatore të ndërtimit të kësaj lidhjeje të re ka qenë temë e takimit të parë të punës midis delegacioneve të Maqedonisë dhe Bullgarisë në kuadër të Memorandumit për bashkëpunim në sferën e gazit natyror. Takimi i parë i grupit të punës, siç kumtoi Ministria e Ekonomisë, është mbajtur në Sofje gjatë vizitës

zyrtare të ministrit të Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, ndërsa Memorandumi për bashkëpunim në sferën e gazit natyror u nënshkrua më 1 gusht këtë vit në Shkup. Gjatë vizitës ministri Bekteshi u takua me ministren e Energjetikës, Temenuzhka Petkova. Në Takim është biseduar për bashkëpunimin midis Bullgarisë dhe Maqedonisë në sferën e energjetikës, sigurisë së furnizimit me energji, diversifikimit të burimeve energjetike, si dhe rëndësinë e lidhjeve të reja interkonektive dhe bashkëpunimi rajonal. Siç informojnë nga Kabineti i Bekteshit, theks i veçantë gjatë takimit është dhënë në marrjen e kryesimit me Këshillin e Bashkimit Evropian nga ana e Bullgarisë nga 1 janari i vitit 2018, me përqendrim Ballkani Perëndimor, me ç'rast pala bullgare ka shprehur gatishmëri që ta mbështesë Maqedoninë në investimet infrastrukturore në sferën e energjisë dhe rrugën e saj drejt integrimit në strukturat e BE-së. Sipas ministres bullgare të Energjetikës, për rajonin ballkanik problem i madh është infrastruktura e pamjaftueshme, ndërsa Bullgaria në mënyrë aktive punon në tejkalimin e kësaj mangësie.

Ish agjentët e DSK-së gjykohen në Selanik

GJPSH vendos për ekstradimin e Grujoskit dhe Boshkovskit

Procedura e ekstradimit për dy të akuzuarve kryesor të PSP-së, për lëndën e bashkuar "Fortesa dhe Target", për realizimin e përgjimeve masive nga viti 2008-2015, nga Ministria e Drejtësisë kanë thënë se do ta realizojnë komfor legjislacionit vendas dhe konventave ndërkombëtare për ekstradim

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 24 tetor- Gjykata Penale e Shkupit, gjatë ditëve në vazhdim pritet të miratoi vendim se vallë do të lejojë përmbylljen e procedurës për ekstradim të Goran Grujoskit dhe Nikolla Boshkovskit, ose do të vazhdojë me praktikën e deritanishme të bllokimit të punës së Prokurorisë Speciale Publike. Në një prononcim për media nga GJPSH-ja kanë thënë se të premten e kaluar Këshilli penal i sektorit për krim të organizuar, nga Gjykata e Apelit e ka pranuar kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, për kompletim të dokumentacion për ekstradim të dy ish agjentëve të DSK-së, nga Greqia në Maqedoni. Mirëpo, nga GJPSH-ja, nuk kanë treguar se kur pritet të miratohet ky vendim, por vetëm kanë theksuar se Këshilli Penal është duke e proceduar kërkesën e organeve përkatëse dhe se opinionin me kohë do të njoftohet për të gjitha risitë që lidhen me këtë temë. Procedura e ekstradimit për dy të akuzuarve kryesor të PSP-së, për lëndën e bashkuar "Fortesa dhe Target", për realizimin e përgjimeve masive nga viti 2008-2015, nga Ministria e Drejtësisë, kanë thënë se do ta realizojnë komfor legjislacionit vendas dhe konventave ndërkombëtare për ekstradim.

PRITET HETIMI I SAIGJ-IT EDHE NË GJYKATËN E APELIT

Grupi punues në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga gjykatësi, Llazar Nanev, brenda kësaj jave do të vlerësojë se si ka funksionuar Sistemi i automatizuar i informacioneve për menaxhim me lëndët gjyqësore (SAIGJ) në Gjykatën e Apelit në Shkup. Skandali me "SAIGJ-in" erdhi pasi që u tha se sistemi nuk ka qenë funksional, si pasojë e së cilit gjykatësit lëndët e Prokurorisë Speciale Publike i kanë ndarë vetë (doré më dorë). Pas këtij vlerësimi, pritet që grupi punues të njëjtin vlerësim ta bëjë edhe në Gjykatën Supreme, pas së cilit do të duhet të finalizohet edhe raporti i cili do t'i prezantohet opinionit. Nga Ministria e Drejtësisë informojnë se ministri, Bilen Saliji, duhet të takohet sërish me grupin punues, i cili do të duhet të informojë për zhvillimet e deritashme. Nga Gjykata Supreme njoftuan se ende nuk janë gati konkluzionet pas vizitës së kryetarit të Gjykatës Supreme dhe udhëheqjes së shërbimeve të informatikës, të cilët para një jave kanë realizuar kontroll në funksionimin e SAIGJ-it në Gjykatën e Gjevgjelisë. Përndryshe, rasti i sistemit SAIGJ, sistem ky që në Gjykatën Penale të Shkupit, dedikohet për ndarjen e lëndëve te gjykatësit kompetent, përfshirë edhe gjykatësin Vladimir Pançevskin, i cili i shqyrtoi pothuajse të gjitha lëndët e PSP, tani më edhe zyrtarisht hetohet si i dyshuar për kryerjen e veprave penale "keqpërdorim të detyrës zyrtare" dhe "publikim të sekretit zyrtar".

Ndërkohë, duke e ditur mënyrën e punës së deritanishme të GJPSH-së, nga kjo ministri për gazetën KOHA, kanë theksuar se nuk presin bllokimi të procesit të ekstradimit. Nga ana tjetër, para se Goran Grujoski dhe Nikolla Boshkovski, të ballafaqohen me provat dhe faktet e PSP-së, ata gjatë ditës së martë janë paraqitur para Gjykatës së Selanikut, nën akuzën e falsifikimit të dokumenteve të udhëtimit. Ndryshe, javë më parë Goran Grujovski dhe Nikolla Boshkovski, dy ish-shefa të lartë në MPB, u arrestuan në Aeroportin e Selanikut, gjatë tentimit për të udhëtuar në Budapest. Autoritet greke, gjegjësisht zyra e Interpolit në Selanik, ka njoftuar se dy personat në fjalë kanë pasur dokumente të rrejshme udhëtimi, me çka Goran Grujoski identitetin e ka zëvendësuar me Hristo Atanasov, ndërsa Nikolla Boshkovski, ka qenë i maskuar me identitetin e Nexhbi Hasan. Dy personat, ndoshta më të kërkuar në shtet, për autoritet e vendit kanë qenë të pakapshëm plotë 84 ditë, me çka gjatë kësaj periudhe në GJPSH janë zhvilluar tre seanca gjyqësor kundër tyre dhe gjashtë nëpunësve tjera të DSK. Procesi gjyqësor për lëndën e bashkuar "Fortesa dhe Target", pritet të zhvillohet me 3 nëntor, ndërkohë që deri atëherë gjasat janë shumë të vogla që të realizohet ekstradimi i Goran Grujoskit dhe Nikolla Boshkovskit nga Greqia në Maqedoni.

Padi për tre punonjës të Komunës së Prilepit

Shkup, 24 tetor - Policia parashtroi padi penale kundër katër personave të punësuar në komunën e Prilepit, kundër një menaxhuesi të Pellagonia Turs nga Prilepi dhe një gjeodet të autorizuar i punësuar në GPS "Premer" SHPPKNJ Prilep për keqpërdorim të detyrës zyrtare, vepër penale me të cilën e kanë dëmtuar buxhetin e Republikës së Maqedonisë për 7.995.00 denarë, kumtoi MPB.
Padi penale janë parashtruar kundër I.K (61) i punësuar në Komunën e Prilepit në vendin e punës menaxher në Sektorin për urbanizëm, I.Ç (66), i punësuar në komunën e Prilepit në vendin e punës Sektori për urbanizëm , K.B (60), i punësuar në komunën e Prilepit - anëtarë i Komisionit për konfirmimin e gjendjes faktike në vend e ngjarjes në procedurat për legalizim dhe B.V (62), i punësuar në komunën e Prilepit - anëtarë i Komisionit për konfirmimin e gjendjes faktike në vendngjarje në procedurën për legalizimin kundër S.K (61), Meanxhues në SHPK "Pellagonia Turs" Prilep, P.I (50), gjeodet i autorizuar në GPS "Premer" SHPPK Prilep .

Plaçkitet një kazino dhe një bastore

Shkup, 24 tetor - Persona të panjohur dje në dy raste kanë kryer plaçkitje në një kazino në rrugën "Gjorgji Popo Hristov" në Shkup dhe në një bastore afër tregut të gjelbër në Shkup. Ministria e Punëve të Brendshme informon se mbrëmë në orën 21:37 është denoncuar se në një bastore afër tregut të gjelbër në Shkup dy persona të panjohur kanë kryer plaçkitje ndaj të punësuarve. Autorët me kërcënim me armë e kanë marrë fitimin ditor dhe kanë ikur në drejtim të panjohur. Plaçkitja e dytë është denoncuar mbrëmë në orën 24:26. Autorët, dy persona të panjohur, me kërcënim me armë automatike kanë marrë para nga fitimi ditor dhe kanë ikur në drejtim të panjohur. Ndërmerren masa për zbulimin e autorëve dhe për zbardhje të tërësishme të rastit.

Shkup, 41 aksidente në fundjavë

Shkup, 24 tetor - Gjatë katër ditëve të fundit, në rajonin e Shkupit kanë ndodhur gjithsej 41 aksidente trafiku, prej të cilëve në tre lëndime të rënda trupore kanë tre persona. Në 17 aksidentet e tjera lëndime të lehta trupore kanë marrë 28 persona, ndërsa 21 aksidente kanë kaluar me dëme materiale. Siç njofton MPB, të premten policia e trafikut ka bërë ekspertizë në 11 aksidente, nga të cilat në pesë aksidente më lehtë janë lënduar tetë persona, ndërsa gjashtë kanë kaluar vetëm me dëm material. Të shtunën është kryer ekspertizë në 10 aksidente.
Në dy prej tyre, dy persona kanë marrë lëndime të lehta trupore. Në katër aksidente janë lënduar katër persona ndërsa në katër është shkaktuar dëm material. Të dielën është krye ekspertizë në 10 aksidente.
Në njërën prej tyre, një person ka marrë lëndime të rënda trupore dhe dy persona me lëndime trupore, në tre aksidente me lëndime të lehta kanë marrë tre persona, ndërsa gjashtë kanë kaluar vetëm me dëme materiale. Të hënën, në Shkup është kryer ekspertizë në gjithsej 10 aksidente trafiku.
Në pesë aksidente janë lënduar pesë persona, ndërsa në pesë aksidente është shkaktuar dëm material. Gjatë katër ditëve të fundit, policia ka zbuluar dhe sanksionuar 17 shoferë të cilët kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit dhe janë përjashtuar nga trafiku, 17 shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, tetë shoferë kanë kaluar në dritë të kuqe, tetë shoferë nuk u kanë dhënës përparësi këmbësorëve në vendkalim të shënuar për këmbësorë, si dhe 82 shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin pa patentë shoferi ose të paregjistruar. Janë hasur edhe 83 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit karrotreci janë larguar 98 automjete.

Nxënësit e Novosellës mësojnë në dy objekte

Tetovë, 24 tetor - Pas djegies së objektit shkollor në fshatin Novosellë të Komunës së Bogovinës, të martën 207 nxënës të këtij fshati janë sistemuar në dy objekte në këtë fshat, gjegjësisht në ambulantën e fshatit dhe në objektin në bashkësisë lokale. Po ashtu sot në këtë fshat kanë qëndruar edhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të cilët kanë bërë vlerësime të gjendjes së kësaj shkolle pas përfshirjes nga zjarri të dielën në mesditë. Ndërkaq, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë të ditur se janë marrë masa për rikonstruimin

e shkollës së djegur "11 Tetori" në fshati Novosellë të Komunës së Bogovinës. "Gjatë dy ditëve të kaluara, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me drejtorin e shkollës për të gjetur zgjidhje më adekuate që procesi mësimor të zhvillohet pa pengesa, me ç`rast janë krijuar kushte që mësimi të vijohet, ndërsa nxënësit prej sot kanë vijuar mësimin në ambientet e Bashkësisë Lokale të këtij fshati dhe në ambulantën e fshatit", njoftuan nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Më tej, nga kjo ministri njoftojnë se përfaqësues të Njësisë për Investime Kapitale të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës kanë qenë sot në këtë fshat për të inspektuar gjendjen me shkollën e djegur dhe do të ndërmerr të gjitha hapat e mëtejshëm për përpunim të dokumentit teknik që objekti të rikthehet në gjendje të rregullt në pajtim me standardet e parapara me ligj. Në ditët në vijim, Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të jetë në koordinim të përhershëm me komunën për realizimin e projektit deri në fund. Por, një ditë më parë, ministrja e Arsimit dhe Shkencës, Renata Deskoska, ka thënë se janë koordinuar me zëvendëskryeministrin Hazbi Lika që i njëjti të vizitojë këtë shkollë dhe njëkohësisht ka dhënë mbështetje për zgjidhje të shpejtë të këtij problemi. Ajo tha se është dëgjuar edhe me drejtorin e kësaj shkolle dhe punohet që të gjendet zgjidhje e përkohshme, ndërsa Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të përpunojë projekt dhe do të mbështetet ndërtimin e një objekti të ri shkollor. Përndryshe, ditë më parë, nga shkaqe ende të panjohura, por me dyshim se mund të jetë nga energjia elektrike dhe instilacioni i vjetërsuar, u përfshi nga flakët dhe vetëm 30 minuta u dogj tërësisht objekti i shkollës fillore "11 Tetori" e fshatit Novosellë të Komunës së Bogovinës. Nga zjarri u përfshi edhe një veturë që ishte parkuar afër shkollës dhe pjesërisht edhe një kasolle që ishte ngjitur me objektin e shkollës.

Së bashku me qendrën tregtare, zona e re me sipërfaqe ndërtimi prej 100.000 m2 për banesa të reja, është planifikuar të ndërtohet përgjatë 5 viteve të ardhshme

Balfin me investim 300 milionë euro!

Në Shkup do të ndërtohet kompleksi i parë me destinacion miks që do të përfshijë qendrën më të madhe tregtare, një kompleks apartamentesh dhe një park zyrash!



Shkup, 24 tetor - Kompania "Shkupi East Gate" do të ndërtojë kompleksin e parë me destinacion miks, i cili do të përbëhet edhe nga një qendër tregtare, kompleks apartamentesh dhe park zyrash në sipërfaqe prej 155.000 m2. Kompleksi atraktiv do të gjendet vetëm 1.5 km larg qendrës së Shkupit, në Komunën e Gazi Babës, në kryqëzimin ndërmjet dy rrugëve kryesore, përgjatë hapësirës ndërmjet bulevardit Aleksandri i Madh dhe rrugës "Bellasica". Investimi total në periudhë prej 5-7 vjet planifikohet të jetë më tepër se 300 milionë euro, duke krijuar mijëra mundësi dhe vende të reja pune. Sipas njoftimit të Grupacionit "Balfin", së pari do të ndërtohet qendra tregtare, ndërsa kompleksi i apartamenteve dhe parku i zyrave do të ndërtohen gjatë 5-7 viteve të ardhshme. Me "Shkupi East Gate", Shkupi merr një imazh të ri, ndërsa për qytetarët e pjesës lindore të Shkupit krijohen kushte për një jetë më cilësore, sipas modelit të qyteteve të zhvilluara evropiane. Ky kompleks, siç thuhet në njoftimin e grupit "Balfin", në tregun e patundshmërive do të sjellë më shumë se 250.000 m2 sipërfaqe të re bruto në ndërtim, që vlerësohet si investimi më i madh privat i këtij lloji në Maqedoni. "Planet zhvillimore përfshijnë dhe ndërtimin e qendrës më të madhe tregtare në Maqedoni, në sipërfaqe bruto për dhënie me qira prej 45.000 m2, kompleks apartamentesh dhe park zyrash. Qendra tregtare do të ketë dy nivele me rreth 2500 vend-parkime nëntokësore. Vëmendje e posaçme do ti kushtohet avancimit të eko-jetesës urbane. Plani I kompleksit parashikon çerdhe dhe zona të gjelbra sipas modelit të tendencave moderne arkitekturore", thuhet në njoftim.

Duke e konsideruar suksesin e qendrës tregtare City Mall në Shkup, si dhe nevojën e identifikuar të shitësve me pakicë për t'u zgjeruar në Maqedoni, vazhdon më tej njoftimi, është vendosur se një qendër tjetër tregtare në Maqedoni është një mundësi investimi i realizueshëm. "Qendra tregtare "Shkupi East Gate" planifikon të ndërtojë qendrën e re tregtare në bashkëpunim me një investitor tjetër. Ndërtimi do të fillojë në vjeshtën e vitit 2018, kurse qendra tregtare pritet të hapet zyrtarisht në fund të vitit 2020. Lokacioni dhe madhësia e qendrës së re tregtare paraqesin mundësi të shkëlqyeshme për thithjen e brandeve të reja botërore në Maqedoni, përveç brandeve ekzistuese në treg. Së bashku me qendrën tregtare, planifikohet të ndërtohet edhe një hapësirë banesash me rreth 100 000 m2 bruto, e cila do të ndërtohet gjatë 5 viteve të ardhshëm". Aksionari kryesor i "Shkupi East Gate" është Grupi "Balfin", grupacion i cili e ndërtoi dhe qendrën tregtare "City Mall" në Shkup (37.000 m2), historikisht transaksioni më i madh kapital në tregun e patundshmërive në Maqedoni, i cili vitin e kaluar iu shit një investitori të huaj. Grupi Balfin është një ndër kompanitë më të mëdha rajonale, i pranishëm në 9-të vende të botës me investime në qendra tregtare, projekte të ndërtimit të pasurive të patundshme dhe komerciale, si dhe një sërë aktivitetesh me pakicë siç është zinxhiri i dyqaneve Neptun, Jumbo dhe shitës me pakicë të modës.

Qytetarët kanë 3.8 miliardë euro në banka, depozitat të sigurta

Shkup, 24 tetor - Depozitat e qytetarëve në bankat dhe kursimoret në vend janë të sigurta, tha Borçe Haxhiev, drejtor i Fondit për Sigurim të Depozitave në Maqedoni, në intervistën për MIA-n në prag të Ditës Botërore të Kursimeve - 31 tetori. "Depozitat e kursimeve për secilin depozitues në shumë deri në 30 mijë euro në kundërvlerë të denarit janë të siguruar në Fond dhe janë të sigurta. Dhe nëse ndonjë bankë ose kursimore ka ndonjë ngjarje të rrezikshme, ata depozitues kompensohen", sqaron Haxhiev. Të dhënat nga Fondi tregojnë se për momentin shtetasit e Maqedonisë kanë 3.8 miliardë euro kursime në banka dhe kursimoret në vend. "Më shumë se gjysma apo 50.5 për qind", siç tha Haxhiev janë në denarë, ndërsa 49.5 për qind në euro. Sipas tij, shumica e kursimeve në denarë me siguri ka të bëjë në normat më të larta të interesit të këtyre depozitave kursyese por edhe të kursit të qëndrueshëm të denarit. Ai i porosit qytetarët vetëm të kursejnë dhe se nuk ka rëndësi në cilën monedhë. Qytetarët më shumë u besojnë bankave të mëdha dhe atje janë numri më i madh i depozitave. Haxhiev shton se numri më i madh i depozitave të kursimit është deri në 30 mijë euro. "Kjo shumë është e garantuar, por ka depozita mbi këtë shumë. Pjesa më e madhe e tyre janë deri në 30 mijë euro. Qytetarët e dinë këtë dhe ata vetë e disperzojnë rrezikun duke vendosur depozita në disa banka apo më shumë persona nga familja", tha në intervistën drejtori i Fondit për Sigurim të Depozitave. Ai theksoi se kjo shumë me hyrjen e Maqedonisë në BE do të rritet në 100 mijë euro, siç është në vendet e Bashkimit Evropian, por se edhe do të sigurohen edhe depozitat e kursimeve të personave juridik.

Publicitet

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KËSHILLI I INSPEKTORATEVE

Në bazë të nenit 19 paragrafi 5 dhe nenit 16-a paragrafi 13 të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/10, 162/10, 157/11, 147/13, 41/14 , 33/15, 193/15 dhe 53/16), ndërsa në pajtim me Rregulloren për mënyrën për dhënie të provimit për inspektorë si dhe formën dhe përmbajtjen e kërkesës për dhënie të provimit për inspektorë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 21/16) Këshilli i inspektorateve në vijim publikon:

THIRRJE PUBLIKE
Nr. 02-919 të datës 24.10.2017
Për paraqitje të kandidatëve për dhënie të provimit për inspektorë për sesionin e tretë të provimit për vitin 2017

I. LËNDË E THIRRJES PUBLIKE
I.1 Lëndë e thirrjes publike është paraqitja e kandidatëve për dhënie të provimit për inspektorë për llojet e inspektorëve në vijim:
1. Inspektor shtetëror për deviza
2. Inspektor shtetëror i tregut
3. Inspektor shtetëror gjeologjik
4. Inspektor shtetëror i xeheve
5. Inspektor shtetëror për elektrikë në xehetari
6. Inspektor shtetëror për pajisje nën presion
7. Inspektor shtetëror për teleferikë, ashensorë, vinça dhe transportierë
8. Inspektor shtetëror për stacione, vegla dhe pajisje elektro-energjetike
9. Inspektor shtetëror sanitar dhe shëndetësor
10. Inspektor për mbrojtje dhe shpëtim
11. Inspektor shtetëror për mbrojtje të natyrës
12. Inspektor shtetëror të ekonomisë së ujërave
13. Inspektor shtetëror për mjedisin jetësor
14. Inspektor shtetëror për rrugë
15. Inspektor shtetëror për komunikacion rrugor
16. Inspektor për teleferikë dhe ski ashensorë
17. Inspektor për siguri në lundrim të brendshëm
18. Inspektor shtetëror për bujqësi
19. Inspektor shtetëror fitosanitar
20. Inspektor shtetëror për gjueti
21. Inspektor shtetëror për pylltari
22. Inspektor shtetëror për ushqim
23. Veterinar zyrtar
24. Inspektor shtetëror për arsim
25. Inspektor për trashëgimi kulturore
26. Inspektor për kulturë
27. Inspektor shtetëror administrativ
28. Inspektor për material arkivor
29. Inspektor për sport
30. Inspektor shtetëror komunal
31. Inspektor i ndërtimtarisë
32. Inspektor urbanistik
33. Inspektor për mbrojtje sociale
34. Inspektor për mbrojtje të fëmijëve
35. Inspektor shtetëror i punës
36. Inspektor për siguri radiatike
37. Inspektor shtetëror për vetëqeverisje lokale
38. Inspektor për siguri të tërheqje të trenave dhe mjeteve të trenave
39. Inspektor për siguri të transportit të udhëtarëve dhe kafshëve në hekurudhë
40. Inspektor për siguri të infrastrukturës hekurudhore
41. Inspektor për shenja të sigurimit, telefonike-telegrafike
42. Inspektor farmaceutik
43. Inspektor i kemikaleve
44. Inspektor për menaxhim me krizat
45. Inspektor për siguri të informacioneve të klasifikuara

I.2 Provimin e realizon dhe licencën për inspektor e jep Këshilli i inspektorateve.
I.3 Provimi do të mbahet në lokalet e **Fakultetit juridik "Justiniani i Parë" pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" bul. "Goce Dellçev" 9b, 1000 Shkup Republika e Maqedonisë**, në lokalet për dhënie të provimit, posaçërisht e pajisur për dhënie të provimit profesional me pajisje materiale-teknike dhe informatike, internet lidhje dhe pajisje për xhirim të provimit.

II. PERIUDHA E MBAJTJES SË SESIONIT TË PROVIMIT
II.1 Sesioni i tretë i provimit për vitin 2017 do të mbahet më datë 01 dhjetor 2017.
II.2 Këshilli i inspektorateve së paku 8 ditë para mbajtjes së provimit përmes ueb faqes së Këshillit të inspektorateve dhe Shërbimit publik radiodifuziv do të informojë kandidatët dhe publikut për datën dhe kohën e dhënies së provimit.

III. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE
III.1 Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë kandidatët të cilët kanë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën përkatëse të shërbimit inspektues pas diplomimit.

IV. MËNYRA DHE AFATI I PARASHTRIMIT TË KËRKESËS
IV.1 Kërkesa për dhënie të provimit bëhet me plotësimin e Formularit në formë me shkrim i cili gjendet në ueb faqen e Këshillit të inspektorateve www.is.gov.mk
IV.2 Me kërkesën dorëzohen:
- Biografia e shkurtë (CV);
- Certifikatë e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë,
- Diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter) dhe
- Vërtetim për stazh të punës nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor.

IV.3 Kërkesat mund të dorëzohen në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të thirrjes publike.
IV.4 Kërkesat dorëzohen drejtpërdrejtë në arkivin e Këshillit të inspektorateve ose përmes postës në adresën në vijim: rr. Dame Gruev nr. 3 bllok 2, lokali 5 Shkup

V. PROVIMI
V.1 Provimi realizohet tre herë gjatë një viti kalendarik për secilën sferë të shërbimeve inspektuese.
V.2 Provimi përbëhet nga pjesa teorike dhe studimeve të rastit të cilat jepen në mënyrë elektronike në formë të testimit edhe atë:
- pjesa e parë (pjesa teorike), me të cilën kontrollohet njohuria teorike e kandidatëve dhe
- pjesa e dytë (studim të rastit), me të cilën kontrollohet aftësia për aplikimin e ligjeve në praktikë.

V.3 Pyetjet dhe studimet në rast të dhënies së provimit për inspektorë janë publikuar në ueb faqen e Këshillit të inspektorateve www.is.gov.mk dhe në e-prashanja http://www.prasanja.mk
V.4 Provimi do të konsiderohet si i dhënë nëse nga numri i pikëve (pjesa e parë dhe e dytë) kandidati ka të fituar më shumë se 70%.
Kërkesës i paguhet taksë administrative në shumë prej 50 denarëve.

PAGESA E TAKSËS ADMINISTRATIVE
Paguhet në xhiro llogari në formularin PP 50
Nga ana e djathtë:
Emri dhe selia e pranuesit: Ministria e financave
Banka e pranuesit: BPRM
Llogaria transaksione: 10000000063095
Llogaria paguese: 840 Shifra e komunës 03161
Shifra e të hyrave dhe programi: 722313 00 :
Nga ana e majtë: Emri dhe selia e paguesit të taksës: Emri dhe mbiemri i juaj
Numri tatimor ose NVP: Numrin tuaj të amzës
Qëllimi i pagesës: Taksa administrative për provim për inspektorë

Për informata plotësuese
Daniella Jakimovska
Telefoni për kontakt: 075/338-792

Ditët e fundit uji në Tetovë mban erë të pazakontë, si ajo e pesticideve kimike. Kjo dukuri ka ndodhur në shumë lagje të Tetovës, prej nga kanë raportuar se uji mban një erë të rëndë

Në pritje të rezultateve nga Qendra e Shëndetit Publik

Probleme me ujin e pijshëm në Tetovë

"Nuk ka vend për ndonjë shqetësim më të madhe, por, ne, duke parë situatën se ka pasur shumë reagime dhe denoncime nga qytetarët, kemi bërë analiza tona dhe të njëjtat, për çdo rast, i kemi dërguar edhe në Shkup që të jemi më të sigurt. Rekomandimi është që të mos përdoret për pije derisa të marrim analizat nga Shkupi", tha mjeku Davidovski

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 24 tetor - Uji në qytetin e Tetovës, sipas Qendrës për Shëndet Publik, rekomandohet që të mos shfrytëzohet për pije, derisa nuk arrijnë ditëve në vijim rezultatet më të detajuara nga Qendra për Shëndet Publik në Shkup. Këtë e ka bërë të ditur mjeku Ratko Davidovski, i cili tha se analizat e ujit të bëra në 20 pika në vende të ndryshme në Tetovë, nuk kanë dhënë ndonjë indikacion se uji nuk i përmbush parametrat e parapara, por për shkak të erës dhe shijes nuk rekomandohet që të përdoret për arsye preventive.

"Ne kemi bërë analiza dhe uji i plotëson standardet si në aspektin biologjik po ashtu edhe kimik. Por i njëjti mban erë të pakëndshme, prandaj edhe rekomandojmë që të mos përdoret. Nuk ka vend për ndonjë shqetësim më të madhe, por, ne, duke parë situatën se ka pasur shumë reagime dhe denoncime nga qytetarët, kemi bërë analiza tona dhe të njëjtat, për çdo rast, i kemi dërguar edhe në Shkup që të jemi më të sigurt. Rekomandimi është që të mos përdoret për pije derisa të marrim analizat nga Shkupi", tha Davidovski.

Ditët e fundit uji në Tetovë mban erë të pazakontë, si ajo e pesticideve kimike. Kjo dukuri ka ndodhur në shumë lagje të Tetovës, prej nga kanë raportuar se uji mban një erë të rëndë me ç`rast krahas raportimit në rrjetet sociale po ashtu ata këtë e kanë raportuar edhe në qendrën për shëndet publik. Autoritetet kompetente rekomandojnë që uji në Tetovë të mos përdoret për pije. Qytetarët e Tetovës dje dhe sot raportuan për një erë dhe shije të pazakontë në ujin për pije nga ujësjellësi i qytetit, pas çka qendra për shëndet publik mori monstrat dhe, sipas rezultateve të para, uji i pijshëm është në rregull, por për shkak të asaj se era dhe shija e pazakontë ende është prezent në ujë, sot monstrat janë dërguar në Shkup. Qendra për shëndet publik rekomandon që për pije dhe gatim të përdoret uji në shishe derisa të merren rezultatet përfundimtare nga analizat që po kryhen në Shkup. Me këtë rast, kanë reaguar edhe nga Organizata Ecoguerilla.

"Kërkojmë nga organet kompetente të marrin masa urgjente për këtë rrezik që nuk është parë deri më tani dhe t'i njoftojnë qytetarët për këtë problem!", thuhet në reagimin e kësaj organizate. Përndryshe, ende nuk ka ndonjë qëndrim nga ana e Ndërmarrjes Publike Komunale-Tetova-Tetovë lidhur me këtë situatë në rrjetin e ujësjellësit të Tetovës. Dukuri të këtilla kohë pas kohe përsëriten në Tetovë, ku uji është i turbullt. Përndryshe, edhe një dyshim tjetër është se gjatë dy ditëve të kaluara ka pasur mungesë të ujit në Tetovë dhe kjo mund të ketë shkaktuar probleme gjatë lëshimit të sërishëm të ujit të pijshëm, por ende nuk ka konfirmim zyrtar nga autoritetet lokale. Problemi me cilësinë e ujit tani më një kohë të gjatë është shqetësues në rajonin më të gjerë të Tetovës. Po ashtu nëpër komunat rurale shumë pak bëhen analiza të ujit brenda vitit. Nga Qendra për Shëndet publik në Tetovë, thonë se qeveria brenda një viti ndan mjete që gjashtë herë në vit të bëhen analiza, kurse që rezultatet të jenë gjithmonë të saktë duhet që të bëhen 12 analiza brenda vitit. Sipas mjekëve në këtë qendër, ata kryejnë analiza në 92 fshatra në rajonin e ish Komunës së Tetovës.

"Maqedonia ka ujë të pijshëm cilësor, por uji ndotet si rezultat i problemeve me zonat e mbrojtura dhe mungesës së dezinfektimit. Ne ndotim ujin vetë, me pakujdesinë tonë. Shpesh herë hasim kapakët e rezervuarëve të hapura, hasim në kaptazhe të mbushura me gjethe dhe prania më e vogël e një gjethi në ujë për një kohë të shkurtë krijon baktere. Me rëndësi është që të mirëmbahen rrjetet e ujësjellësit, ndërsa pjesa më e madhe e ujësjellësve në Tetovë janë mirë të ndërtuar, por kur nuk kujdesemi mundësia e ndotjes së ujit është e madhe ", thekson Davidovski. Ai nënvizoi se komunat janë të obliguara që të themelojnë Këshillin për shëndet publik dhe në atë këshill duhet që të ketë edhe një përfaqësues të Qendrës së shëndetit publik.

Përfundoi edicioni i 21-të i FNP "Ditët e Naimit"

Program i ngjeshur letrar, artistik dhe kulturor

Në ditën e tretë poetë pjesëmarrës vendosën buqete lulesh te shtatorja e poetëve, Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kuteli

Tetovë, 24 tetor - Është mbyllur Edicioni i 21-të i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit", i cili u mbajt prej 19-22 tetor 2017, në Tetovë dhe në Pogradec. Atë e karakterizoi një program i ngjeshur letrar, artistik dhe kulturor. U mbajtën dy lexime letrare, u promovuan 6 libra të rinj të shtëpisë botuese "Ditët e Naimit", si dhe u bënë vizita të ndryshme në monumentet kulturore, historike dhe fetare në qytetin e Tetovës dhe të Pogradecit.

Në Edicionin e 21-të të Festivalit Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit" morën pjesë poetë nga vende të ndryshme të botës, si: Xhorxh Uallas (SHBA), Riki Daskal (Izrael), Gustavo Vega (Spanjë), Tonia Passola (Kataloni), Nivedita Lakhera (Indi), Poul Lynggaard damgaard (Danimarkë), Giuseppe Napolitano (Itali), Dinos Koubatis (Greqi), Abel D Andrea (Porto Riko), Silke Liria Blumbach (Gjermani), Sema Guler (Turqi), Milosava Pavloviç (Serbi), Anton Baev dhe Elka Dimitrova (Bullgari), Slavica Gaxhova dhe Marta Markoska (Maqedoni), Belfjore Qose dhe Arjan Kallço (Shqipëri), Bardh Frangu, Migena Arllati dhe Ndue Ukaj (Kosovë), Iljaz Osmani dhe Ekrem Ajruli (Maqedoni).

Hapjen e Edicionit jubilar e bëri, drejtori i Festivalit, z. Shaip Emërllahu, i cili tha se, "Botën vazhdojnë ta shoqërojë një dis-'harmoni, një kaos që herë herë është i përmasave shumë shqetësuese. Ky dimension disharmonie të kujton mitin e Abilit dhe Kabilit, ku vëllai vret të vëllanë dhe nis rruga e një lufte në mes të mirës e të së keqes. Për të bërë peshoren të anojë nga e mira shoqëria ka njohur projekte profetësh dhe libra të shenjtë, të cilët kanë luajtur një rol të rëndësishëm për të bërë një botë më të mirë".

Në hapje të këtij Edicioni, aktori Arsim Kaleci, recitoi poezinë "Fjalët e Qiririt" të Naim Frashërit, ndërsa një pikë muzikore me piano ekzekutoi, pianistja e talentuar, Biondina Selami. Në orën e madhe letrare 'Globi poetik', poetët nga vendet e

ndryshme lexuan poezitë e tyre, ndërkaq kryetari i Jurisë, Ndue Ukaj, lexoi motivacionin. Drejtori i Festivalit, Shaip Emërllahu ia dorëzoi laureatit çmimin e madh 'Naim Frashëri' që jepet për "Vlera të larta estetike dhe artistike", si dhe ia akordoi titullin Anëtar Nderi të Festivalit, poetit të njohur amerikan Xhorxh Uallas. Me këtë rast, laureati taivanez Lee, pasi falënderoi organizatorët dhe Jurinë për dhënien e këtij çmimi të lartë të Festivalit, theksoi se" është një nder i madh për mua të ndërohem me këtë çmim letrar, që bart emrin e poetit kombëtar shqiptar Naim Frashëri..."

Titullin e lartë, Anëtarë Nderi të Festivalit, deri tani e kanë marrë shkrimtarët dhe intelektualët e njohur, si Ismail Kadare (Shqipëri), Desmond Egan (Irlandë), Thomas Tidholm (Suedi), Manlio Argueta (Salvador), Abdellatif Laabi (Marok), Peter Poulsen (Danimarkë), Lionel Ray, (Francë), Eva Lipska (Poloni), Craig Czury (SHBA), Tua Forsstrom (Finlandë), Athanase Vantchev de Thracy (Francë), Sebastiano Grasso (Itali), Kuei shien Lee (Taivan) etj . Në këtë edicion, poetit grek Dino Koubatis, iu dha titulli i lartë Anëtar Nderi i Festivalit, për kontributin e dhënë në letërsi.

Në ditën e dytë të Programit, në lokalin e artistëve "Oda" u bë përurimi i gjashtë titujve të rinj të shtëpisë botuese "Ditët e Naimit". Programi i Edicionit të 21-të i Festivalit Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit" u mbyll me orën e madhe letrare 'Meridiane poetike', e cila u mbajt në qendrën e kulturës "Lasgush Poradeci" në Pogradec, ku poetët lexuan poezitë e tyre dhe u ndanë edhe çmimet e tjera letrare të Festivalit. Çmimi për vlera të veçanta poetike 'Menada' iu dha poetes katalonase, Tonia Passola. Çmimi letrar 'Ditët e Naimit', që jepet për karrierë letrare iu nda poetit shqiptar, Bardh Frangu.

Çmimin letrar për ciklin më të mirë poetik 'Oaeneumi' e mori poetja shqiptare, Belfjore Qose. Çmimin letrar 'Qiriu i Naimit' për poezinë më të mirë iu dha poetes turke, Sema Guller. Në ditën e tretë poetë pjesëmarrës vendosën buqete lulesh te shtatorja e poetëve, Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kuteli. Në sheshin e poetëve, drejtori i Festivalit Shaip Emërllahu, ia dorëzoi edhe mirënjohjet kryetarit të Bashkisë së Pogradecit, Eduart Kapri dhe zevendeskryetarit të Bashkisë, Avdulla Cano të dhënë për ndihmesën e dhënë për organizimin e Festi. Ata, më pas vizituan disa monumente kultuore dhe historike të qytetit të Pogradecit, pastaj Drilonin, Ohrin dhe Strugën. Drejtoria e Festivalit edhe në këtë edicion botoi antologjinë e poezive të poetëve pjesëmarrës, 'Ti shfaqesh si ishull", të përgatitur nga Shaip Emërllahu. Në 21 vjetorin e Festivalit, Drejtoria ndau Mirënjohje për kontributin e dhënë në plotësimin e programit me vepra muzikore dhe ngritjen e Festivalit, Jeton Pustinën, Naser Dulen, Shkëlzen Pajaziti dhe Biondina Selami.

Qilimarën e gjeti me 200 punëtorë krahu, pa asnjë kuadër me shkollim të lartë, ndërsa pas 17 vitesh e la me mbi 700 punëtor, ndër të cilët ishin 35 kuadro me shkollim të lartë, universitar në fusha të ndryshme

Iqmet Krifca, personalitet i nderuar i Dibrës

Ai nuk la çifligje, as vila; por la një familje të shëndoshë. Meti e meriton t'i shkruhet një monografi, ashtu siç meriton edhe Qilimara, e cila është një histori në vete për Dibrën. Mbase, ajo monografi mund të jetë një e përbashkët e dy sinonimeve, Meti-Qilimara apo Qilimara-Meti. Ish ministër pa portofol në Republikën e Maqedonisë, ish drejtori më jetëgjatë i "Qilimare"

Nga Bardhyl KUKA



Edhe pse kaluan më se dy vjet nga vdekja e tij, ai përsëri është gjallë në kujtesën tonë. Nuk mund të ketë dibran të moshuar që nuk e ka njohur birin e Dibres se Madhe, Iqmet Krifcen-Metin. Megjithëse ka ushtruar funksione të shumta, madje edhe anëtar qeverie njerëzit atë, më së shumti, e kujtojnë si drejtorin më jetëgjatë dhe më të suksesshëm të industrisë së qilimave, apo Qilimarës, siç thotë populli dibran. Andaj, të kujtosh Metin, domosdo ke kujtuar edhe Qilimarën, dhe anasjelltas. Meti dhe Qilimara mbeten sinonime. Drejtor Iqmeti me drejtimin e Qilimares bëni bum në zhvillimin ekonomik, shoqëror, social e kulturor në vendlindjen e tij –Dibrën e Madhe. Atij, popullaritetin nuk ia dhanë funksionet që ushtroi, por, para së gjithash, puna që e ngriti lartë, ndershmëria e tij, karakteri i tij i fortë dhe fisnik, modest, human, goja e ëmbël dhe urtësia. Që në moshën e re nevojat familjare e shtynë të përballet me vështirësitë e jetës për të ndihmuar familjen. Punën e filloi në "Rasatnik", madej në "Gipsarë" , në vitin 1960 kaloi me punë në Qilimarë, ku, për tri vitet e para ishte drejtor financiar, më vonë drejtor i përgjithshëm deri në vitin 1978. Krahas punës zyrtare vazhdonte shkollimin pa shkëputje nga puna, ia doli të diplomohej në kohë dhe me sukses ekonomikun. Sa për dijeni, Qilimara u hap në vitin 1947 si një repart i kooperativës së qilimave të dorës të fshatit Lazaropole. Në vitet 50-60 në të gjallëronin repartet për qilima dore të prodhuara në vek apo avëlmend dhe për riza e shamia. Në vitin 1962 filloi prodhimi i qilimave të makinës "Bukle" dhe "Velvet", por, fillimisht me dimensione rrugicash dhe qilimash të vegjël. Meti, kurrë nuk thoshte "unë bëra këtë apo atë punë", por gjithmonë shprehej "ne, të Qilimarës e bëmë. Andaj, edhe ne me këto pak fjalë përkujtimi do të përpiqemi që edhe pas vdekjes Metit t'ia respektojmë modestinë e tij. Qilimara në vitet në vazhdim u zgjerua edhe me dy reparte të rinj atë të tjertorës dhe ngjyrosjes. Në 1965, këto reparte u shtuan dhe u pajisën me makina më modern, që prodhonin qilima me përmasa më të mëdha, ashtu siç e kërkonte tregu. Me makinat e blera nga importi, Qilimara rriti asortimentet, duke prodhuar qilima të llojit "Aks-mister" që, në atë kohë, ishte prodhuesi i parë dhe i vetëm në ish Jugosllavi madje edhe në Ballkan. Hapërimi i Qilimarës kah më e mira vazhdonte me ritëm të pandalshëm. Nomenklaturës së prodhimeve të qilimave të dorës, "Velvet" dhe "Bukle" , tashmë, ju shtua edhe prodhimi i qilamave "Friz", "Tebriz", "Supertrebriz" dhe "Nodison". Punohej në tre turne. Makinat pushonin vetëm gjatë ditëve të festave. Me këto suksese, Qilimara u ngrit në një rang kombinati qilimash, të cilët pushtonin tregjet e botës, u ngrit në një fabrikë që për vitet, nën drejtimin e Metit, kurrë nuk diti përmbyllet viti me bilanc negativ. Jo vetëm Meti, por të punësuarit dhe mbarë familjarët dibranë i gëzoheshin këtij rezultati. Meti bashkëjetonte me hallet e të vuajturve. Donte çdo njërin ta ndihmonte. Përveç që punoi me përkushtim për Qilimarën, ai kujdes të veçantë u kushtoi edhe shkollimit të kuadrove. Qilimarën e gjeti me 200 punëtorë krahu, pa asnjë kuadër me shkollim të lartë, ndërsa pas 17 vitesh e la me mbi 700 punëtor, ndër të cilët ishin 35 kuadro me shkollim të lartë, universitar në fusha të ndryshme. Numri i kuadrove me shkollim të mesëm kaloi trefishin. Këta kuadro janë fryt i një program për zhvillim nga viti 63 dhe në vazhdim. Vazhdimisht favorizonte kuadrot vendase. Bursistët e Qilimarës ishin të gjithë bijtë e bijat të punëtorëve të saj. Pra, shkollimi i kuadrove ishte një nga synimet kryesore të tij. Kur shihte frytet e këtij kombinati, atij i bëhej zemra mal. Edhe në ditët e pleqërisë fliste me kënaqësi të veçantë për shkollimin që u dha dibranëve.

Dera e Qilimarës gjithmonë ishte e hapur për të punësuar (pa konkurrencë) hallexhinjtë. Kur ndonjë grua mbetej pa burrë, pa asnjë mbështetje ekonomike, fëmijët jetim, në çdo kohë, ato derën e Qilimiras e kishin të hapur. Veshte rrobat e punës dhe me djersë të ballit, jetimëve u siguronte bukën e gojës, pa qenë nevoja të zgjaste dorën e lëmoshës. Këtë rregull të pashkruar Meti e zbatonte pa përjashtim edhe ndaj grave bashkëshortët e të cilëve, për çdo qoftë motivi, burgoseshin. Më se gjysma e familjeve dibrane, por edhe të fshatrave përreth, bukën e gojës e siguronin nga Qilimara. Hapi kuzhinën e punëtorëve, ku sidomos fshatarët hanin drekën. Nga shpirti fisnik që kishte, ndër të parët e ndërmarrjeve e të Dibrës, krijoi arkën e përbashkët për ndihma. Nga një përqindje simbolike e rrogës të të punësuarve krijoi fondin e ndihmave. Çdo punëtor që i binte mbi kokë ndonjë hall (dasmë, mort, sëmundje me kohëzgjatje, ndërtim apo rinovim shtëpish, sigurim të druve të dimrit etj.), arkën e përbashkët e kishte "derë babe". Kjo arkë është një "minibankë" - thoshte Meti. Ideja e Metit për ndërtimin e një banese banimi në Dibër me mjete financiare të vetë fabrikës gjetën strehim 15 familje të punëtorëve të saj. Ishte shembulli që ai deshi t'i mbajë kuadrot, por jo si H.C.Shpile që ndërtonte banesa në Shkup e Dibër për punëtorët e saj pa pikën e djersës duke e shfrytëzuar Udovën, që ua morën dibranëve. Të shumta janë zërat e të gjithë të punësuarve hallexhinj si vejushat, ish te burgosurit, ish bursistët, që Metin e urojnë nga thellësia e shpirtit dhe lëshojnë një bekim: "Metit shpirti i shkoftë në parajsë". Qilimara "lindi" edhe Shoqatën Kulturore Artistike "Liman Kaba", e cila luajti rol për emancipimin e femrës dibrane në përgjithësi e asaj shqiptare në veçanti. Femrat e para dibrane që, aso kohe sapo kishin flakur ferexhenë, nisën rrugën e emancipimit. Ndaj, përbërja e të punësuarve ishte mbi 70% femra. Meti u zgjodh edhe Kryetar i Shoqërisë Kulturore Artistike "Liman Kaba" të cilën e udhëhoqi në shumë aktivitete, ku u paraqitën si në vend ashtu edhe në Shqipëri e Kosovë. Nga Qilimara, anëtarë të kësaj shoqërie ishin fizarmonisti Eshtref Cutra, këngëtari Sulejman Borova, Violeta Turkeshi, klarinetisti Sabri Meçe etj. Pjesëmarrësit në aktivitetet e shoqërisë gjithmonë kishin mbështetjen e drejtorit dhe kryetarit Meti. Asokohe të viheshe në ballë të një shoqërie këngësh e vallesh shqiptare, kur hegjemonizmi dhe ultranacionalizmi pansllavist për moto të politikës ditore kishte luftën kundër armikut të shpifur, nacionalizmin, irredentizmin dhe separatizmin shqiptar. Vërtet ka qenë guxim patriotik por edhe i vetëdijshëm se do të jesh vazhdimisht nën përgjim dhe ne vëzhgim të UDB-së. Në aso rrethanash rreziku për të rënë në ndje-kje penale deri në burgim për delikt verbal ka qenë më se i pranishëm dhe i mundshëm. Megjithatë, Meti doli faqebardhë dhe me sukses.

Dashuria ndaj Dibrës Metit nuk iu shua kurrë. Ai, edhe pas largimit në Shkup, vazhdonte të jetonte me hallet dibrane. Duke patur funksionet e larta si në Odën Ekonomike të Maqedonisë e madje edhe si anëtar i Këshillit Ekzekutiv Republikan (sot Qeveria) vazhdimisht me përkushtim kontribuonte për zhvillimin ekonomik të ndërmarrjeve të Dibrës. Kështu, duhet ti jemi mirënjohës për kontributin që ka dhënë për investimet në fabrikën e përpunimit të dyerve dhe dritareve "Depllast", për investimet e Gipsarës, përmes shfrytëzimit të mjeteve të ashtuquajtura "Bashkim i punës dhe mjeteve" për më shumë kredi të "Shpile-transit" për të blerë kamionë, për kredi të ndërmarrjes së bukëve "Kllas", për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese. Meti ka kontribut të veçantë për marrjen e statusit të mëvetësisë së H.C."Spile" – Dibër nga Hidrocentrali "Gllobojca". Ndërmarrja tregtare "8-Shtatori", falë angazhimit të tij shpejt fitoi të drejtën e tregtimit ndërkufitar me Republikën e Shqipërisë. Ai nuk është kursyer të ndih-mojë edhe për ndërtimet në Dibër, siç janë ujësjellësi nga Rosoku dhe ndërtimi i Shtëpisë së Mallrave "Merkur". Andaj, ai prore e meriton nderimin e dibranëve. Por, nuk duhet ta harroj një moment, edhe pse shpesh herë bisedonim për rrjedhat e Qilimarës, që kur ajo filloi "të lindë" e gjer kur një dorë e zezë e shiti tek "Knauf" i Austrisë, e rrënoi dhe e pruri në nivelin zero. Kur kalonte aty pranë ai e kthente kokën nga ndërtesa e komunës qe rri si një nuse përballë disa pemëve të nivelit zero te ish parku i Qilimarës.

Për t'i dhënë edhe pak lëng këtij shkrimi unë takova në Dibër edhe tre drejtorët që e pasuan Iqmetin. Të treve u shtrova të njëjtën pyetje: Përshtypjet për punën e Iqmet Krifcës në Dibër dhe për Dibrën. Fillimisht fillova nga mosha. Magjister Muhamed Kaba, ndër të tjera shprehet: "Ndjehem fort i respektuar që kam nderin e më jepet mundësia të them fjalë mirënjohje për kolegun, bashkëqytetarin e veçanërisht bashkëpunëtorin t' im të ndjerin Iqmet Krifca. Një dekadë të tërë kam punuar me të në zhvillimin, rritjen dhe afirmimin e fabrikës së qilimave në Dibër ku shumë familje dibrane siguruan me punë të ndershme ekzistencën e tyre esenciale. Femrat u emancipuan më shumë se sa në shumë qytete të tjera, ku jetonin shqiptarët. Iqmet Krifca, punëtor i palodhshëm, çdo veprim e bënte me dashuri të sinqertë për Qilimarën". Mr. Kaba shkon edhe më tutje:" Në kujtimet e mia, Iqmet Krifca, Abdul Vojnika, Sado Hame, Shaban Qemali disa të tjerë janë një kaptinë e veçantë për zhvillimin e Dibrës. I pa harruar qoftë kujtimi për Metin". Ramazan Pahumi: "Me Iqmetin-Metin kemi kaluar së bashku më shumë se 40 vite ai me virtytet e tija dallohej si njeri i urtë, punëtor dhe ambicioz. Në moshë të re u rrit pa babë dhe ai interesohej për mbarëvajtjen e familjes duke punuar punë të ndryshme, por edhe duke u shkolluar. Mbaroi fakultetin ekonomik dhe magjistroi në këtë lëmi. Me plotkuptimin e fjalës ai ishte edhe krijues i fabrikës së qilimave në Dibër, të cilën nga 200 të punësuar e zgjeroi në 600. Me përpjekje të mëdha bëri katër investime për prodhimin e perit prej fazës së ngjyrosjes, prodhimin e qilimave klasik dhe në fund edhe prodhimin e qilimave "Tafting". E zgjeroi objektin duke arritur ne 11 mijë metër katror. I deshi shumë kuadrot e reja dhe u mundësoi që të shkollohen dhe të specializohen për punë profesionale te tekstilit. Përveç qe ishte në organet më të larta të institucioneve ekonomike ai u zgjodh edhe deputet republikan. Si ekonomist dhe ekspert i dalluar, pas vitit 1978, punësohet nënkryetar i Odës Ekonomike të Maqedonisë. Nga viti 1992 punon përfaqësues i kësaj ode në Shqipëri e më vonë përfaqësues per Shqipëri i ndërmarrjes për Import Eksport "Tehnometal"-Shkup. Në çdo investim për Dibrën ai u angazhua qe nga fondet republikane të ndahen mjete për këtë qytet, pra Dibrën. Ishte i përpiktë në planifikimin e kohës si në pune ashtu edhe në jetën e përditshme"-shprehet me shumë respekt kolegu, shoku dhe miku i ngushtë.

Ndërsa, Ramazan Ballanca, që e pasoi Pahumin, thotë:"Iqmet Krifca ishte për mua një mësues ë palodhur. Më ka ndihmuar në ç'do aspekt. Pa ndihmën e tij, me sinqeritetin më të madh, them se nuk do të mund ta udhëheqja dhe zgjeroja Qilimarën. Për ç'do iniciativë konsultohesha dhe më jepte sugjerime dhe këshilla, të cilat asnjëherë nuk më kanë zhgënjyer. Kur, në mandatin tim u ndërtua reparti i fjollave punonin afër 300 punëtore. Hapëm edhe shitoret, jo vetëm në disa qytete të Maqedonisë, por edhe në Kosovë. Gjithmonë kur vinte në Dibër e vizitonte dhe më këshillonte. I jam borxh këtij kuadri që kontribuoi në mandatin tim të punësohen gjer në një mijë e 36 punëtorë". Meti vdiq në Shkup, ndërsa u varros në varrezat e Dibrës së Madhe më 17 Nëntor 2011. Në varrim morën pjesë shumë shokë, miq dhe të afërm nga Dibra, Shkupi dhe shumë qytete nga Maqedonia,Kosova dhe Shqipëria. Kortezhi ishte aq i gjatë sa kishte me qindra e qindra përcjellës. Ai nuk la çifligje, as vila, por la një fa-milje të shëndoshë, bashkëshorten, Shqipen, arsimtare e nderuar, fëmijët, Ismailin (Malin), poliglot e përkthyes, Dritanin, biznesmen që ka depërtuar edhe jashtë kufijve të Maqedonisë dhe bijën, Mirlindën - profesoreshë universitare për gjuhë dhe letërsi. Meti e Meriton ti shkruhet një monografi, ashtu siç e meriton edhe Qilimara, e cila është një histori në vete për Dibrën. Mbase, ajo monografi mund të jetë një e përbashkët e dy sinonimeve, Meti-Qilimara apo Qilimara -Meti.

Shoqata e Pensionistëve të Luftës së RM

Ekskursioni dhe vizita e SHP Gostivar

Pensionistët ushtarak vizituan Myftiu i Bashkësisë Islame të Gostivarit, ku i përshëndeti zëvendësi i myftiut kryesor, Milazim Zendeli dhe i njoftoi me misionin që e realizon kjo bashkësi fetare

Më 16 shtator 2017, me iniciativë të Shoqatës së Pensionistëve të Luftës, u organizua takim me udhëheqjen e SHP Gostivar dhe është realizuar vizitë të qytetit dhe rrethinës me dyzet pensionistë të luftës. Pas mirëseardhjes së ngrohtë, kryetari i SHP Gostivar, Nijazi Xhelili, përshëndeti mysafirët dhe në emër të Këshillit ekzekutiv dhe anëtarësisë shprehu falënderim për inicimin e këtij takimi, të cilin e vlerësoi si shumë të rëndësishme për afrimin e pensionistëve të etniteteve të ndryshme dhe zgjerimin e miqësisë.

Gjatë takimit ai foli edhe për aktivitetet dhe sukseset që i ka arritur shoqata në shumë sfera si në nivel rajonal ashtu edhe republikan.

Nijaziu tha se ky shembull duhet të ndiqet edhe nga shoqatat tjera të pensionistëve, ndërsa që të përforcohet bashkëpunimi dhe shoqërimi, propozoi iniciative për vëllazërimin e dy shoqatave. Fjalën përshëndetëse e përfundoi me shpërndarjen e materialit promovues dhe fletushkave për infrastrukturë në Komunën e Gostivarit si dhe bukuritë natyrore të rrethinës.

Në emër të udhëheqjes dhe anëtarësisë SHPL, falënderim për praninë dhe fjalët e mira të nikoqirëve shprehu sekretari i SHPL, Eftim Mishovski. Falënderim të posaçëm shprehu edhe anëtari i KE të SHPL, Mendo Dimovski, i cili theksoi aspektet pozitive të këtij takimi edhe e përshëndeti iniciativën për vëllazërimin e shoqatave.

Pastaj, pensionistët ushtarak vizituan Myftiu i Bashkësisë Islame të Gostivarit, ku i përshëndeti zëvendësi i myftiut kryesor, Milazim Zendeli dhe i njoftoi me misionin që e realizon kjo bashkësi fetare. Mysafirët e vizituan kompleksin e BFI, ndërsa hoxha Jakup Jakupi i njoftoi me rëndësinë dhe funksionimin e Medresesë, Xhamisë dhe Saat Kullës.

Të udhëhequr nga nikoqirët, pensionistët ushtarak e vizituan edhe Kishën Shën Bogorodica dhe Xhaminë . Takimi përfundoi në fshatin Vrutok tek burimi i Vardarit ku u shkëmbyen përvoja nga aktiviteti i shoqatës dhe në atmosferë relaksuese në restorantin Burimi 3 të gjithë u shoqëruan dhe u kënaqën në ambientin e bukur natyror.

Kjo ngjarje u ndjek nga mediet lokale, ndërsa deklarata për media dhanë Nijazi Xhelili dhe sekretari i ZVP Eftim Mishofski. *(Vadije Zendeli)*

SHP Kumanovë

Takimi multietnik në Likovë

SHP Kumanovë, në bashkëpunim me Degën e pensionistëve të Likovës, më 12 tetor kanë realizuar ekskursion njëditor deri tek Liqeni i Likovës dhe dy akumulimet, Glanja dhe Likovë. Takimi tradicional multietnik këtë vit ka përjetuar edicionin e katërt, ndërsa pensionistët kanë pasur një mundësi të jashtëzakonshme për të parë liqenin, të shëtisin përreth digës gjithë atë ta vërejnë përmes fotografive.

Mirëseardhje të ngrohtë mysafirëve në emër të nikoqirit u dëshiroi Hulusi Saliu, ndërsa për aktivitetet më të reja të shoqatës së pensionistëve nga Kumanova, informoi Spirko Nikollovski. Përshëndetjet e tyre i përcollën edhe përfaqësuesit e SHP Kriva Pallanka, të cilët janë vizitorët e rregullt të takimit.

Pamja e vetë liqenit ishte e mrekullueshme, e shkëlqyer nga rrezet e diellit, pamje jashtëzakonisht e bukur. Ditë e ngrohtë tetori, me diell, çdo gjë u shkonte për shtati vizitorëve të digës Gllanja. I pashmangshëm ishte edhe fotografimi për kujtim nga shëtitja dyorëshe. Shoqërimi më tutje vazhdoi në restorantin "Kodra", i vendosur në vet liqenin, ku Shoqata e të sëmurëve nga diabeti organizoi aksion për matjen e sheqerit në gjak. Në mënyrë më të detajuar për sëmundjen e sheqerit ka folur doktori specialist Ismail Bajrami, i cili në këtë rast ka potencuar shkaqet për paraqitjen e sëmundjes, por edhe mënyrat e shërimit dhe parandalimit të së njëjtës. Pensionistët me kujdes të madh kanë përcjellë ligjëratën edukative, ndërsa pastaj parashtronin pyetje, ndërsa një pjesë e tyre kanë ndarë përvojat dhe pikëpamjet e tyre në lidhje me sëmundjen e sheqerit.

Pas shoqërimit disa orësh, pensionistët e Kumanovës u larguan nga Likova, të kënaqur nga ajo që kanë kaluar një ditë të këndshme, me dëshirë që vitin e ardhshëm sërish të vizitojnë liqenin dhe të shijojnë bukuritë natyrore. *(Jasmina Todorovska)*

SHP Strugë

Në rekreacion klimatik në Banjat e Dibrës

Nga numri i madh i pensionistëve të interesuar strugan për rekreacion klimatik në banja, këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar vetëm 50 anëtarë të shoqatës, të cilët kanë qëndruar kryesisht në Banjat e Dibërs – Kosovrasti dhe Capa – Banishte. Impresionet për shërbimet kualitative dhe cilësitë shëruese të banjave na i dhanë pensionistet Dafina, Radmilla, Borka, Zorica, si dhe pensionistët nga grupi i meshkujve: Anxhellko Budinoski, Viktor Dishlioski, Stojani, Nuredini, Lupço, Klimeja dhe të tjerë, të cilët me kënaqësi kanë treguar për qëndrimin e tyre dhe përmirësimin e shëndetit. Të dyja grupet, të cilat në tetor të këtij viti qëndruan në banjat, koha e bukur ju mbajti që në mënyrë të pavarur të organizojnë vizitë të dy manastireve të kësaj ane, Shën Jovan Bigorski dhe Shën Georgi Pobedonosec në fshatin Rajçica.

Në manastirin Bigorski kanë vizituar ikonostasin dhe ikonën e Shën Xhon Pagëzorit, për të cilën besohet se ka fuqi çudibërëse, ndërsa gjithashtu ishin të impresionuar nga manastiri i njohur i grave, shenjtërinë shpirtërore në Rajçicë, ku motrat me kënaqësi kanë shëtitur pensionistët kureshtar nëpër konakë.

Disa prej tyre për herë të parë kanë parë punëtorinë e Zografskit dhe u njoftuan me mjeshtërinë e prodhimeve të rrobaqepësisë, ndërsa i pashmangshëm ishte edhe llokumi i përgatitur në këtë manastir. Gjatë qëndrimit në banja pensionistët këndshëm janë befasuar dhe jashtëzakonisht të lumtur nga vizita e anëtarëve të KE të Shoqatës të udhëhequr nga kryetari Millorad Trposki, nënkryetari Zija Asllani dhe sekretari Idriz Mustafai, ku u njoftuan me kushtet dhe kualitetin e shërbimeve. *(Stojan Kukuneshoski)*

SHIP SHPI Tetovë

Ndihma humanitare për 60 anëtarë

Në Shoqatën e invalidëve të punës dhe shfrytëzuesve të pensionit invalidor realizohen dy aktivitete më masovike, për të cilat janë të interesuara anëtarët: ndihma humanitare në të holla të kategorisë së pensionistëve me të ardhura më të ulëta dhe furnizim me dru për ngrohje për të gjithë të interesuarit. Këtë vit ndahen mjete të njëhershme humanitare financiare për 60 anëtarë, ndërsa shuma është nga 2000 denarë. Shfrytëzuesit janë kryesisht me propozim të organizatave të vendit, me të cilat mbulohet i gjithë rajoni i veprimit të Shoqatës dhe të 25 delegatëve të Kuvendit. Për ndarjen e ndihmës humanitare respektohen dispozitat nga rregullorja e posaçme.

Kryetari i Shoqatës, Gido Bojçevski, ka informuar se sivjet janë paraqitur 350 anëtarë të cilëve u ndahen rreth 3000 metra kub dru për ngrohje. Sipas Bojçevskit, dy arsye kanë kushtëzuar interesimin e këtillë të madh: pagesa me këste dhe çmimi më i ulët se ai që ofrohet në treg. Drutë për ngrohje falas transportohen edhe tek secili shfrytëzues, pasi të paguhet kësti i fundit. ky është viti i nëntë që kur Shoqata realizon këtë aktivitet.

Në Shoqatë thonë se në tërësi realizohen detyrat programore, falë angazhimit jo vetëm të delegatëve të Kuvendit, por edhe të të gjithë 27 degëve të vendit në të cilat janë përfshirë 2800 anëtarë. Me kryetarët e degëve të vendit mbahen këshillime të kohëpaskohshme, përmes të cilave planifikohen aktivitete masovike dhe individuale. Shoqata ka lidhur marrëveshje me të gjitha banjat shëruese, ndërsa për anëtarët është siguruar lirim prej 10 për qind nga çmimi i pansionit. Për ndryshe, Shoqata e invalidëve të punës dhe shfrytëzuesve të pensionit invalidor Tetovë vepron në rajonin e Pollogut të poshtëm në të cilin gjenden komuna e Tetovës, Tearcës, Jegunovcës, Zhelinës, Brvenicës dhe Bogovinës. (G. Eftoski)

Ndërmjetësuesi

Agron DEMI

Prapaskenat e negociatave për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, të pasqyruara në librin "Ndërmjetësuesi – një biografi e Martti Ahtisaarit", të autorëve finlandezë Katri Merikallio dhe Tapani Ruokanen ("The Mediator – a biography of Martti Ahtisaari", Hurst&Company, Londër, 2015)

"Tung Kofi, si je?", ishte përgjigjur Martti Ahtissari në telefonatën e natës së 14 gushtit 2005. Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan, kishte telefonuar dhe po i kërkonte Ahtisaarit që të angazhohej si ndërmjetësues në negociatat për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Në kohën e telefonatës, Ahtisaari vetëm se ishte i angazhuar si ndërmjetësues në zgjidhjen e statusit të provincës indoneziane, Aceh. Sipas autorëve të librit "Ndërmjetësuesi", një biografi voluminoze për jetën private dhe karrierën profesionale të Martti Ahtisaarit, para se Ahtisaari të konsiderohej për ndërmjetësues në negociatat Kosovë-Serbi, si emra potencialë ishin konsideruar edhe Kai Eide dhe Carl Bildt. Eide, atë kohë ambasador norvegjez në OKB, u largua nga kombinimi për shkak se vendi i tij nuk ishte anëtar i Bashkimit Evropian dhe Grupi i Kontaktit kërkonte një ndërmjetësues, i cili do të arrinte një marrëveshje të pranueshme për të gjitha vendet anëtare të BE-së. Kurse Bildt, një njohës i mirë i rrethanave në Ballkan nuk ishte i pranueshëm për administratën e George W. Bushit, ngase shihej si person i afërt me Beogradin.

"Pranoj me një kusht: që ndihmës i imi të jetë Albert Rohan", ishte përgjigja e Ahtisaarit për ofertën e Annan. Ahtisaari po pranonte për herë të dytë detyrën e ndërmjetësuesit për rastin e Kosovës. Më 1999, ishte ai, së bashku me diplomatin amerikan Strobe Talbott dhe atë rus Victor Chernomyrdin, i cili bindi diktatorin serb Milosheviç që të pranojë kushtet e komunitetit ndërkombëtar për të larguar ushtrinë serbe nga Kosova dhe për të pranuar misionin paqeruajtës të NATO-s dhe atë të OKB-së. "Gjatë bisedës sonë të parë telefonike pas pranimit të rolit ndërmjetësues në negociatat për Kosovën, Martti më pyeti nëse e dëshiroja Pavarësinë e Kosovës", kujton Albert Rohan, i intervistuar nga autorët e librit "Ndërmjetësuesi". "Po", ishte përgjigjur Rohan. "Nuk ka asnjë rrugë tjetër", kishte deklaruar Ahtisaari. Qartësimi i pozicioneve kishte bërë që tandemi Ahtisaari-Rohan të ishin në valë të njëjta që nga fillimi. Sipas Ahtisaarit, negociatat asnjëherë nuk fillojnë nga një pozicion neutral. Është e rëndësishme të merren parasysh rrethanat që sollën deri tek negociatat. Në sytë e Ahtisaarit, ajo çfarë Milosheviç kishte bërë në Kosovë thjesht nuk mund të injorohej. Dhe, sipas tij, Milosheviçi nuk ishte i vetëm, ai kishte mbështetjen e tërë aparatit shtetëror. Kësisoj, e tërë Serbia ishte përgjegjëse. Ahtisaari nuk beson se një ndërmjetësues duhet të jetë neutral.

"Për mua është shumë me rëndësi që t'i bëj të qarta qëndrimet e mia që në fillim, që palët të dinë se ku qëndroj dhe cilat janë vijat e mia të kuqe. Në këtë mënyrë unë mund të punoj ndershmërisht. Sa më shumë që ndërmjetësuesit përpiqen të fshehin qëllimet e tyre, aq më shumë duken si hipokritë dhe kjo e rrënon besimin e palëve në proceset negociatore."

Për Ahtisaarin, Pavarësia e Kosovës do të duhej që të zgjidhej qysh më 1999. Sipas tij, që atëherë do të duhej të vendosej se pas një periudhe tranzicioni prej pesë vjetësh, Kosova do të jetë shtet i pavarur. Kjo do të vendoste fajin për humbjen e Kosovës tek Milosheviç, kurse qeveritë e tjera në Serbi do të pajtoheshin shumë më lehtë me këtë zgjidhje. Tani mbetej që të gjendej një zgjidhje e pranueshme edhe për Serbinë, zgjidhje e cila do t'u garantonte të drejta të zgjeruara serbëve në shtetin e pavarur të Kosovës. Ekipi i Ahtisaarit që përbëhej prej rreth 50 vetash ishte kompletuar aty nga fundi i vitit 2005. Zyrat e UNOSEK u vendosën në Vjenë. Në vitin që do të pasonte, në moshën 69-vjeçare, Ahtisaari do të kalonte 260 ditë në udhëtime mes Vjenës, Prishtinës, Beogradit, Washingtonit, Moskës, Pekinit, Brukselit e shumë kryeqyteteve të tjera evropiane.

Vizita e parë e Ahtisaarit në Prishtinë ishte realizuar në nëntor 2015, ku kishte takuar liderët kryesorë institucionalë. Ashtu siç kishte pritur, kërkesa e liderëve shtetërorë të Kosovës ishte pavarësia e plotë. Sipas intervistës dhënë autorëve të librit, ishte ideja e Ahtisaarit që Kosova të formonte një Ekip të Unitetit. Për Ahtisaarin ishte me rëndësi që liderët politikë të flisnin me një zë, ngase edhe ashtu atij i duhej të manovronte në mes kundërshtimeve të shumë vendeve të cilat mbanin qëndrime të ndryshme për statusin final të Kosovës. Por me gjithë këshillën për një ekip uniteti të lidership-it të Kosovës, për shkak të qëndrimeve të kundërta të vetë delegacionit kosovar në bisedime, shumë shpejt në Vjenë ekipi i Kosovës kishte filluar të quhet "Ekipi i Përçarjes".

Pas Prishtinës, Ahtisaari kishte takuar në Beograd kryeministrin e atëhershëm Koshtunica dhe presidentin Tadiç, ku të dyve ua kishte bërë të qartë që ka ardhur koha për të diskutuar për Pavarësinë e Kosovës. Deklaratë e cila kishte ngjallur reagim të ashpër, sidomos nga kryeministri Koshtunica. Një deklaratë kaq e hapur e Ahtisaarit nuk ishte mirëpritur as nga shumë pjesëtarë të delegacionit që e shoqëronin atë në Beograd. Por, sipas Ahtisaarit, sa më herët që palët ta kuptonin se nuk do të kishte asnjë gjasë për kthim të Kosovës nën subordinim të Serbisë, aq më lehtë do të vazhdonin bisedimet.

Sipas Ahtisaarit, me propozim të tij, serbët e Kosovës po fitonin të drejta dhe garanci të cilat nuk i gëzonte asnjë grup minoritar në asnjë vend të botës. Por ajo që kishte vënë re Ahtisaari, liderët e Beogradit nuk ishin të interesuar për të

Gjeopolitika e re e Lindjes së Mesme

Rami KHOURI

Nuk ka asgjë të mistershme apo të papritur në gjithë këtë. Vendet e qeverisura në mënyrë të tmerrshme, popullsitë e të cilëve janë të poshtëruara dhe të cilave u mungon shpresa, nuk duan të mbeten në një gjendje ankthi të përhershëm. Disa rezistojnë. Disa janë rebelë. Disa kërkojnë, pak a shumë, të reformojnë. Shumë prej tyre copëtohen, për të rilindur në mijëra copa të vogla, ose në një seri grupesh militare, ose si ekzekutorë të vullnetit të fuqive të huaja, ose edhe vetëm si një banda të reja kriminale, të financuara nga vendet fqinje

Dinamikat politike të Lindjes së Mesme janë përmbysur plotësisht. Në përpjekje për të kuptuar se çfarë po ndodh sot në rajon duhet së pari të vëzhgojmë situatën në Rusi, Ankara, Teheran, Tel Aviv dhe në periferi të Dahieh, në jug të Bejrutit, dhe më pas të përqendrohemi në Abu Dhabi, Rijad dhe Kajro, me ndonjë vështrim rrëmbimthi edhe në Uashington dhe Bruksel. Çështjet që dikur pushtonin vëmendjen tonë, duken më pak urgjente. Të pyesësh se si do të zhvillohet situata në rajonet kurde të Irakut dhe Sirisë, çfarë do të bëjnë dhjetëra e mijëra xhihadistë në të gjithë rajonin pas shkatërrimit të grupit të Shtetit Islamik (IS) dhe cili do të jetë fati i Jemenit, Libisë dhe Palestinës është ende interesante, por ndoshta më pak shqetësuese se disa vjet më parë. Çështja më e rëndësishme e javës është fati i një qyteti të vogël të banuar përgjatë kufirit turko-sirian? Apo është më mirë të pyesësh se kush do ta ketë kontrollin e rajonit të fushës së Eufratit, ndërmjet Sirisë dhe Irakut? Deri kur Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe do të vazhdojnë fushatat e dështuara, atë ushtarake në Jemen dhe rrethimin e Katarit?

Nuk mund të parashikojmë se cilat faktorë do të ndikojnë në ngjarjet e viteve të ardhshme, edhe sepse marrëdhëniet politike ndërmjet fuqive të ndryshme që veprojnë në të gjithë Lindjen e Mesme, janë vazhdimisht në zhvillim. Por, për një gjë nuk ka pikë dyshimi: dinamika e vetme që kapërcen të tjerat ka të bëjë me ndikimin e paparashikueshëm të kësaj periudhe të gjatë lufte, në një duzinë vendesh. Forcat lokale, rajonale dhe globale luftojnë njëratjetrën, duke vlerësuar paralelisht aleanca të reja të mundshme me fuqitë jo-arabe, si Rusia, Turqia dhe Irani.

Të gjitha pyetjet e mëdha nuk mund të vlerësohen në dritën e interesave dhe sjelljeve të parashikueshme, siç është bërë që nga vitet tridhjetë. Sot, Turqia, Irani dhe Rusia koordinojnë praninë e tyre ushtarake brenda Sirisë, për të shpëtuar regjimin e Bashar al Assadit, më pas do të kërkojë një mënyrë për menaxhimin e ushtrisë amerikane, mbetjet e Shtetit Islamik, me dhjetëra grupet e vogla militare xhihadiste, koalicionet fisnore dhe aspiratat kurde.

Ndërkohë, mbreti saudit shkon në Rusi për të vlerësuar marrëveshjet e reja ushtarake, tregtare dhe politike, megjithëse ndoshta thjesht po luan me bllofin. Turqia, e cila është pjesë e NATO-s, po blen sisteme të përparuara raketore nga Rusia. Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Egjipti po punojnë së bashku për të rikonfiguruar sistemin e qeverisë në Gaza, duke lejuar një ish kriminel palestinez me profil të ulët, Mihama Dahlan, që të ndajë pushtetin në Rripin e Gazës, së bashku me Hamasin, Fatahun dhe këdo që është i gatshëm që të ofrojë shërbimet e veta, në këmbim të parave. Mbijetesa e tyre kolektive është në lojë në Palestinë, dhe ndoshta nuk kanë askënd tjetër kujt t'i drejtohen: thjesht nuk e dinë se çfarë të bëjë në këto kohë të ndërlikuara, por vetëm të kërkojnë një njeri të fuqishëm, i cili mund t'i shpëtojë duke arkëtuar paratë e tjetërkujt.

BUdallallëku skandaloz i politikës amerikane lidhur me konfliktin izraelito-

Koha
E përditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 24 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

drejtat e serbëve në Kosovë, krejt çfarë dëshironin ishte shtyrja e negociatave në pafundësi, me qëllim që askush nga ta të mos hynte në histori si lideri shtetëror nën udhëheqjen e të cilëve "Serbia humbi Kosovën". Në sytë e Ahtisaarit, liderët politikë serbë të përfaqësuar në negociata po e ndiqnin vijën nacionaliste të Milosheviçit; ata silleshin sikurse Serbia nuk kishte kryer asnjë krim në Kosovë. Për Ahtisaarin ishte me rëndësi që negociatat të përfundonin sa më shpejt që ishte e mundur, ngase zvarritja vetëm do t'i komplikonte gjërat. Në fund, për shkak të kundërshtimit rus, Plani i Ahtisaarit nuk kishte dalë për aprovim në Këshillin e Sigurimit. Në vitin 2006 kur filluan negociatat, Rusia kishte pranuar edhe publikisht që çdo zgjidhje për Kosovën duhet të marrë për bazë vullnetin e shumicës së popullsisë së Kosovës. Por në 2007, qëndrimi rus filloi të ndryshojë dukshëm. Sipas Ahtisaarit, deri tek ky ndryshim kishte ardhur pasi që presidenti rus, Vladimir Putin, kishte filluar të interesohej më shumë, duke mos e lënë të vetëm në këtë proces ministrin e Jashtëm Lavrov. Në të njëjtën kohë, kishte filluar acarimi i marrëdhënieve SHBA-Rusi, për shkak të planeve amerikane për të vendosur mbrojtjen raketore në Poloni dhe Çeki. Gjatë tërë procesit, Ahtisaari nuk kishte vërejtur "dashuri vëllazërore" të rusëve ndaj serbëve. Për Rusinë, bllokimi i Kosovës ishte thjesht hakmarrje ndaj Perëndimit.

Frank Wisner, ambasadori amerikan i angazhuar po ashtu në negociatat për Kosovën, ka një tjetër teori përse rusët mendonin se Ahtisaari ka një inat ndaj tyre. Në fëmijërinë e tij, për shkak të pushtimit rus, Martti ishte detyruar të zhvendosej nga shtëpia e tij dhe të merrte statusin e refugjatit. Se statusi i refugjatit kishte ndikim në formimin e qëndrimeve të Ahtisaarit, këtë e pranon edhe ai vetë për autorët e librit. Në fillim të vitit 2000, derisa po kalonte kufirin Kosovë-Maqedoni, në Bllacë, atu ky deri para pak muajsh kishin qëndruar me mijëra refugjatë kosovarë, Ahtisaari pohon t'i jenë rishfaqur të gjitha kujtimet e fëmijërisë së tij si refugjat. Dokumenti i tij për zgjidhjen e statusit final të Kosovës nuk kishte marrë aprovimin ndërkombëtar, por ai ishte pranuar njëanshëm nga Qeveria e Kosovës. Në deklaratën e shpalljes së pavarësisë, emri i Ahtisaarit ishte përmendur tetë herë. Një vit më vonë, Komiteti Norvegjez i Nobelit do ta dekoronte atë me çmimin Nobel për Paqe, për rolin e tij në konfliktin e Namibisë, Indonezisë, Kosovës dhe Irakut. Një ndër të parët që do ta thërriste për të uruar ishte presidenti i Kosovës atë kohë, Fatmir Sejdiu.

Në fund të vitit 2010, Kosova do të vendoste që të hynte edhe një herë në negociata me Serbinë, duke i përsëritur të gjitha gabimet të cilat Ahtisaari me këmbëngulje mundohej t'i evitonte. E para, Qeveria e Kosovës nuk krijoi ekip uniteti, por negociatat u zhvilluan nga partitë në pushtet; ky gabim u kuptua tepër vonë. E dyta, përderisa Ahtisaari e kuptoi shpejt qëllimin e Serbisë për të zvarritur negociatat, ngase kjo do të dëmtonte vetëm Kosovën, liderët politikë të Kosovës vazhdojnë negociatat tani e tetë vjet, pa një datë të përmbylljes së tyre. E treta, përderisa Ahtisaari definoi që në fillim temat për të cilat do të diskutohej, siç ishin të drejtat e zgjeruara për serbët e Kosovës, riorganizimi i komunave dhe mbrojtja e objekteve religjioze, liderët politikë të Kosovës hyn në negociata pa i definuar asnjëherë temat e bisedimeve. Kësisoj, kur shikohet prej një distance mbi një dekadë, del se Ahtisaari ishte një negociator shumë më i mirë për interesat e Kosovës sesa vetë liderët politikë të saj. *(koha.net)*

palestinez është i mishëruar nga vendosmëria e Donald Trump për t'i besuar dhëndrit të tij, Jared Kushner (i cili me sa duket as nuk e ka idenë e situatës), ndërsa ambasadori amerikan në Izrael vazhdon të bëjë deklarata që mohojnë pushtimin izraelit të tokave palestineze, dhe të sanksionojë kolonizimin e paligjshëm të tokave arabe.

Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, ndërkohë, kanë përgatitur një listë të kompanive izraelite që shfrytëzojnë tokat e kolonizuara arabe, në mënyrë që bota të mund të shmangë të bërit biznes me to. Këto dhe zhvillime të tjera të çuditshme paralele në luftërat e vazhdueshme në Lindjen e Mesme, tregojnë se natyra e sovranitetit kombëtar të bazuar në kontrollin territorial, vazhdon të sfilojë, në shumë zona të kufijve. Historia e shteteve të pavarura që kontrollojnë territorin e tyre, ekonominë e tyre, burimet e tyre dhe dhunën me forcat e tyre të armatosura dhe policinë, për më pak se një shekull, është duke rrëshqitur gradualisht nga gishtat e historisë moderne, që nga ana tjetër, nuk kanë dhënë kurrë provë se kanë pasur një mbërthim dhe kontroll të fortë në rajonin tonë.

Për këtë arsye ne vazhdojmë të pyesim veten, pa gjetur përgjigje të besueshme: kush komandon në verilindje të Sirisë këtë javë? Si do të zhvillohet situata në pjesën tjetër të Sirisë dhe Irakut, në rajonet kurde, në Jemen dhe në Libi? Çfarë do të bëjnë militantët për të mbështetur aventurën e shkurtër, ekstremiste dhe të dhunshme të Shtetit Islamik? Cila është e ardhmja e Jeruzalemit?

Sovraniteti, autoriteti, legjitimiteti dhe fuqia ushtarake në disa vende nuk janë më në duart e qeverive qendrore arabe. Ky mosfunksionim Arab na bën të jetojmë në një rajon të shteteve sovrane, gjysmë-shtete, kuazi-shtete, shtete të copëtuar, shtete brenda shteteve, shtete pushtues, shtete virtuale, mini-shtete, shtete etnike dhe sektare dhe shtete boshe, të varfër dhe të dëshpëruar që do të bënin çdo gjë, vetëm për para. Këto shtete janë të gjithë në garë mes tyre për tokën, burimet dhe për autoritetin, në një rajon që ka me bollëk toka dhe burime, por që ka pak autoritete të besueshme kombëtare, me dhjetëra forma të tjera të pushtetit, fuqisë, sovranitetit, territorialitetit dhe legjitimitetit, që shpërfaqen dhe rrisin kakofoninë.

Nuk ka asgjë të mistershme apo të papritur në gjithë këtë. Vendet e qeverisura në mënyrë të tmerrshme, popullsitë e të cilëve janë të poshtëruara dhe të cilave u mungon shpresa, nuk duan të mbeten në një gjendje ankthi të përhershëm. Disa rezistojnë. Disa janë rebelë.

Disa kërkojnë, pak a shumë, të reformojnë. Shumë prej tyre copëtohen, për të rilindur në mijëra copa të vogla, ose në një seri grupesh militare, ose si ekzekutorë të vullnetit të fuqive të huaja, ose edhe vetëm si një banda të reja kriminale, të financuara nga vendet fqinje. *(Bota.al)*

Sulmuesit nga brenda të Europës

Joschka FISCHER

Në Spanjë, qeveria e rajonit autonom Katalunjës po kërkon gjithashtu sovranitet. Por qeveria aktuale spanjolle nuk po persekuton, burgos, torturon dhe ekzekuton popullin e Katalunjës, siç bëri dikur diktatura e gjeneralit Françisko Franko

Europa më së fundmi duket se e ka lënë pas krizën e vet ekonomike shumëvjeçare, por ajo mbetet e pazgjidhur. Për çdo arsye për optimizëm, duket se ka gjithnjë një shkak për shqetësim. Në qershor 2016, një shumicë e ngushtë votuesish britanikë zgjodhën nostalgjinë për të shkuarën e shekullit 19 ndaj çfarëdo premtimi që mund të ketë shekulli 21. Ndaj ata vendosën të hidhen nga një humnerë në emër të "sovranitetit". Ka shumë prova që sugjerojnë se Mbretërinë e Bashkuar e pret një largim i vështirë. Një cinik do të theksonte se do të duhej një "sovranitet" që funksionon siç duhet për të pakësuar impaktin.

Në Spanjë, qeveria e rajonit autonom Katalunjës po kërkon gjithashtu sovranitet. Por qeveria aktuale spanjolle nuk po persekuton, burgos, torturon dhe ekzekuton popullin e Katalunjës, siç bëri dikur diktatura e gjeneralit Françisko Franko. Spanja është një demokraci e qëndrueshme dhe një anëtare e Bashkimit Europian, eurozonës dhe NATO-s. Prej dekadash, ka ruajtur sundimin e ligjit sipas një kushtetute demokratike që është negociuar nga të gjitha partitë dhe rajonet, përfshirë Katalunjën. Më 1 tetor, qeveria katalane mbajti një referendum pavarësie ku më pak se gjysma – disa vlerësime thonë një e treta – e popullatës së rajonit mori pjesë. Nga standardet e BE-së dhe OSBE-së, votimi nuk mund të pranohej kurrë si "i lirë dhe i ndershëm". Përveçse është ilegal nga kushtetuta spanjolle, referendumi nuk kishte as një regjistër votimi për të përcaktuar se kush mund të merrte pjesë.

Referendumi 'alternativë' i Katalunjës tërhoqi një goditje nga qeveria e kryeministrit spanjoll Mariano Rajoy, i cili ndërhyri për të mbyllur qendrat e votimit dhe për të penguar votuesit. Kjo rezultoi të ishte një marrëzi e nivelit të lartë, sepse imazhet e policisë duke u përballur me protestues të paarmatosur i dhanë një legjitimitet separatistëve. Asnjë demokraci nuk mund të fitojë në këtë lloj konflikti. Dhe në rastin e Spanjës, mësymja krijoi imazhe që i ngjanin luftës civile 1936-1939 të vendit – traumës më të madhe historike sot e kësaj dite për Spanjën. Që Katalunja të arrijë pavarësi, duhet të gjejë një mënyrë që nuk përfshin Spanjën apo BE-në. Spanja, me mbështetjen e shumë shteteve të tjera anëtare që shqetësohen për lëvizjet pasuese brenda tyre, do të bllokojë çdo përpjekje katalane për anëtarësi në BE apo eurozonë. Pa anëtarësi në tregun e përbashkët europian, Katalunja do të përballej me perspektivë të errët të transformimit nga një ekonomi në lëvizje në një vend të varfër dhe të izoluar.

Por pavarësia për Katalunjën do të ofronte një problem fundamental për Europën gjithashtu. Si fillim, askush nuk do të përsëritet një ndarje e Jugosllavisë, për arsye të qarta. Por, më tepër, BE-ja nuk mund të tolerojë shpërbërjen e shteteve anëtare, sepse këto shtete përbëjnë thelbin e saj. BE-ja është një lidhje e shteteve, jo rajoneve. Megjithëse rajonet mund të luajnë një rol të rëndësishëm në BE, ato nuk mund të jenë një alternativë për shtetet anëtare. Nëse Katalunja do të vinte një precedent të ndarjes, duke inkurajuar rajone të tjera të pasojnë këtë, BE-ja do të hynte në një krizë të thellë ekzistenciale. Në fakt, dikush mund të argumentojë se asgjë më pak se e ardhmja e BE-së nuk vihet në rrezik në Katalunjë sot.

Për më tepër, synimi origjinal i BE-së ishte të tejkaloheshin problemet e shteteve duke integruar – e kundërta e ndarjes. Ajo supozohej të kalonte sistemin e shtetit që kishte rezultuar aq shkatërrimtar në gjysmën e dytë të shekullit 20.

Për shembull, Irlanda e Veriut, që rezultoi të ishte një shembull perfekt se si integrimi mund të tejkalojë kufijtë kombëtarë të BE-së, të ndërtojë ura mbi përçarjet historike dhe të sigurojë paqe dhe stabilitet. E njëjta gjë mund të thuhet për Katalunjën, që në fund të fundit ia ka borxh të gjithë suksesin ekonomik pranimit të Spanjës në BE në vitin 1986. Do të ishte historikisht absurde që shtetet anëtare të BE-së të hynë në një fazë përçarje dhe disintegrimi në shekullin 21. Përmasat e mëdha të aktorëve të tjerë globalë – Kina, India dhe Shtetet e Bashkuara – e kanë bërë më të nevojshme integrimin më të thellë europian dhe atë të marrëdhënieve ndërkomunitare. Shpresojmë që arsyetimi të prevalojë, veçanërisht në Barcelonë, por edhe në Madrid. Një Spanjë demokratike e paprekur është shumë e rëndësishme për t'u vënë në rrezik nga mosmarrëveshjet për alokimin e të ardhurave nga taksat mes rajoneve të vendit. Nuk ka alternativë përveç që dy anët të negociojë dhe të gjejnë një zgjidhje të kënaqshme për të dyja që i përshtatet kushtetutës spanjolle, parimeve demokratike dhe sundimit të ligjit.

Eksperiencat e miqve dhe aleatëve të Spanjës mund të jenë ndihmuese këtu. Gjermania, ashtu si Spanja është e organizuar si federatë. Megjithatë edhe në Gjermani, asgjë nuk është aq e vështirë sa negociatat për transfertat fiskale brenda qeverisë federale dhe shteteve individuale – mes rajoneve më të pasura dhe më të varfra. Por një marrëveshje mund të arrihet gjithnjë me kalimin e kohës dhe qëndron derisa të ngrihen të tjera mosmarrëveshje që sjellin negociata të reja. Sigurisht, paraja është e rëndësishme. Por nuk është aq e rëndësishme sa angazhimi i përbashkët i europianëve ndaj lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Begatia e Europës varet nga paqja dhe stabiliteti, dhe paqja dhe stabiliteti në Europë varen së pari dhe më e rëndësishmja nga fakti nëse europianët do të luftojnë për këto vlera. *(reporter.al)*

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Kujtimet e familjes shkodrane

ARRATISJA E ARSHI DHE FEIME PIPËS

Shtëpia kishte dy dhoma dhe një haur të vogël që e përdornim për kuzhinë. Ne e quanim atë "kështjella jonë e vogël". E kishim gjetur pasi komunistët na kishin detyruar të shpërnguleshim tre herë brenda gjashtë muajve

Bardha NERGJONI



Feime Pipa e arratisur së bashku me të vëllain Arshi Pipa në një numër i revistës "Albanica" i pranverës së vitit 1991 në Nju Jork ka botuar kujtime me episode mjerimi, brenge, persekutimi e torture që përjetoi familja e saj.

Udhëtimi i gjatë e i pashpresë për një strehë

Për pothuaj dy vjet ishim në zi për vdekjen e vëllait tonë, Myzaferit, dhe motrës, Bedit. Megjithatë, meqenëse po afronte dita e lëshimit nga burgu e Arshiut, filluam të ndjenim njëfarë lehtësimi. Babai, që dergjej në shtrat prej katër vjetësh, me femorën të thyer, u gjallërua disi dhe filloi të na tregonte, mua dhe motrave, ngjarje të jetës se tij. Nëna lau dhe hekurosi kostumin e Arshiut e i beri një kravatë të re. I duhej edhe një dyshek, por me mundësitë financiare që kishim, nuk mund t'ia blinim. Ne, motrat, ndjeheshim më mirë, veçanërisht unë që, në mënyrë të fshehtë isha lidhur me Arshinë, gjë që vetëm nëna e dinte. Ngushëlloheshim edhe pse, të paktën, tashti kishim një çati mbi kokë. Ishte një banesë primitive në periferi të Durresit, në fund të një rruge të gjatë të cilën shirat e dimrit e bënin të pakalueshme. Shtëpia kishte dy dhoma dhe një haur të vogël që e përdornim për kuzhinë. Ne e quanim atë "kështjella jonë e vogël". E kishim gjetur pasi komunistët na kishin detyruar të shpërnguleshim tre herë brenda gjashtë muajve. Banesa jonë e parë, e përkohshme ishte një apartament me dy dhoma. Ndërsa banonim aty, një anëtar partie, ish-student i Arshiut, u ngarkua ta takonte atë në burg. Kishte për detyrë të zbulonte nëse Arshiu, ndërkohë, kishte ndryshuar apo jo. Arshiu i kishte thënë se s'kishte bërë asgjë për t'u penduar.

Shpejt, pas kësaj, Zyra e Strehimit na shpërnguli nga apartamenti që kishim, në një dhome të një ndërtese tjetër. Sapo e bëmë atë dhome të banueshme, duke e larë dhe lyer, Zyra e Strehimit na transferoi te një apartament tjetër me një dhome me të vogël e me të ndyrë se e mëparshmja.

"Për ku pas kësaj?" – pyetëm kur për të tretën here u detyruam të largoheshim.

"Këtë herë ju do të keni një banesë më vete, bile me pamje të këndshme. Nuk do të lëvizni më prej saj."

Banesa e re ndodhej në zonën që quhej Stan, në zonën me të varfër të qytetit.

Shkova ta gjeja.

Gjatë rrugës, në kodër, dukeshin baraka e kasolle të rrënuara që pasonin njëra tjetrën, me oborre ballore ku ndereshin rrecka për t'u thare. Një plakë më tregoi se si shkohej tek shtëpia që kërkoja. Eca përmes kaçubash e ferrash që mbulonin një rrugicë e arrita në një lëndinë mbushur me lule të egra. Në largësi, deti vezullonte. Panorama qe mahnitëse. Mendoja babanë në shtrat, me kokën të ngritur me jastëkë që sodiste detin përballë. Vendi do të kishte qenë fare i mirë edhe për Bedin. Gjatë endjeve tona prej ciganësh, Bedi vdiq nga tuberkulozi, pa asnjë pranë nga familja, në një dhome të spitalit të Tiranës. Shoqja e saj e dhomës na tha se, para vdekjes, ndjehej e lumtur, pasi mendonte se së shpejti do ta merrnim në shtëpi.

Ishte një trillim i yni, për t'i lehtësuar asaj dhimbjen.

Shtëpia në lëndinë ishte rreth shtatë metra e gjatë dhe pesë metra e gjerë. Ishte e mbuluar me mbeturina fletësh alumini që kërcisnin, kur frynte erë. Dritare ishin dy vrima të zëna me dërrasa. Dera mbyllej me një copë tel. Brenda ishte e mbushur me kashtë të kalbur e bajga. Ishte përdorur më parë si stallë.

Atë natë asnjë prej nesh nuk fjeti. Të nesërmen, shkova në Zyrën e Strehimit për t'u thënë se nuk do të lëvizim nga banesa ku ndodheshim.

Njëri nga punonjësit me bërtiti "Çfarë prisni, vilë?! Është e vërtetë, shtëpia ka nevojë për riparime, por ju mund t'i bëni ato, ashtu siç bëtë edhe me banesat e tjera!"

"S'kemi mundësi të shndërrojmë stallën në shtëpi" – i u përgjigja, – por, edhe në qoftë se do të kishim, çezma është tepër larg, poshtë në luginë dhe kasollja nuk ka banjë, nuk ka korrent elektrik. Për më tepër, babai është i paralizuar. Si mund ta çojmë aty, ku s'ka rruge?"

"Me aeroplan, – u tall ai – lutuni Zotit t'ju ndihmojë".

"Ne kemi probleme strehimi me njerëzit tanë – tha një nëpunës tjetër, – në qoftë se gjeni vetë një vend tjetër, ne nuk kundërshtojmë."

Shanset për të gjetur shtëpinë tjetër ishin fare të pakta. Megjithatë, unë u lidha me Nuçin, një mik të familjes që na pat ndihmuar në shumë raste të vështira. Ai foli me Markun, një anëtar partie të cilin e njihja. Kishim bërë se bashku "punë vullnetare" në plazh. Marku, epileptik, ndërsa punonim një ditë me diell të fortë, pati një krizë epilepsie. Unë e ndihmova.

Marku na dha adresën e një familjeje që kishte një shtëpi me katër dhoma e një kuzhinë.

"Ata janë miq, – na shpjegoi, – por ju lutem, mos e përmendni emrin tim!".

Shtëpia ishte e një shoferi kamioni që banonte aty me nënë plakë dhe me gruan pa fëmijë. Ishte njeri me zemër të butë.

Babai ndjehej i lehtësuar në dhomën e tij: me diell në dimër e me freski në verë. Aty celebruam fejesën e njerëz prej motrave. Unë punoja në një fabrike makaronash. Po aty punonte, gjatë pushimeve të verës, Bukurushi, që do të martohej se shpejti. Deti, motra me e vogël, nganjëherë u jepte mësime privatë rusishteje shoqeve të saj të klasës. Por, ishte nëna që punonte më rënde. Përveçse që kujdesej për babanë, ajo gjente kohe për të bërë jorganë që i shiste një tregtar shëtitës. Kur fqinjët tanë kishin festa familjare, ajo u bënte ëmbëlsira. Ata e shpërblenin me qumësht, ushqim që gjendej me vështirësi. Qumështi dhe kosi ishin ushqimet kryesore për babanë. Ai nuk përdorte më protezat e dhëmbëve. Ato e vrisnin. Ushqimet më të mira i ruanim për babanë dhe për Arshinë.

Nuk mundëm kurrë të vendosnim një lule në varrin e vëllait tonë, Myzaferit. Ai u torturua për vdekje, përnjëherë pas arrestimit, në vitin 1946, në Degën e Sigurimit në Shkodër. Nuk dinim, dhe ende nuk dimë, vendin e varrit të tij.

Një ditë tregu, pasi do të blinim disa ushqime për Arshinë, mora një trastë në të cilën kisha futur një bluzë dhe kuletën me triskat e paret dhe u nisa për në dyqan. Në dyqan kishin mbetur vetëm marmelatë dhe djathë. Porosita nga dy kilogram prej të dyjave dhe nisa të kërkoja paret për të paguar. Kuleta nuk ndodhej në trastë. Si e çmendur, e boshatisa atë, kërkova në xhepat e bluzës, kuleta nuk ndodhej. U ktheva mbrapsht e kërkova disa here rreth dyqanit. Kur i humba

shpresat, u nisa e dëshpëruar për në shtëpi, duke tërhequr zvarre këmbët nëpër shi. Përveç pareve që mezi i kishim kursyer, kuleta kishte dhe tri triska buke për tetorin që sapo kishte filluar.

E sfilitur dhe krejtësisht e lagur, arrita aty ku rruga kryesore ndërpritej me rrugicën tonë. Befas pashë një send të zi në tokë që në fillim m'u duk si një cope gome. Ishte kuleta. Isha e sigurt se ishte kuleta ime, dhe sendet duhej të ndodheshin në të, pasi asnjë shqiptar, në atë kohe, nuk do të hidhte një kuletë boshe, sado e vjetër dhe e grisur që të ishte, por pata frike se shiu do të kishte prishur triskat dhe paret. Por, jo. Nëna i kishte mbështjellë ato në celofan. Më parë, si duket, kur unë kisha nxjerrë bluzën nga trasta për ta veshur, kuleta më kishte rënë. Që prej asaj kohe kishin kaluar tre ore. Njerëz, gomarë e mushka mund të kishin shkelur mbi të, por, për fat, s'e kishin venë re.

Në një pasdite nëntori të vitit 1947, kur unë me motrën time Bukurushin po ktheheshim për në shtëpi, pamë një xhip që ndaloi para Prokurorisë se Përgjithshme. Dy roje zbritën prei tij dhe hapen portën e të burgosurit. Prej saj doli vëllai ynë, Arshiu, me pizhame e pantofla. Gjatë daljes nga xhipi, ai ktheu kokën, na vështroi, dhe u fut në ndërtese.

Ne ngrimë. Arshinë e kishin nxjerrë nga infermieria. Pse? Ai duhej të lirohej pas tre muajsh.

Qëndruam para ndërtesës gjersa u err. Rrugët u boshatisën dhe dritat e rrugës u ndezën. Në këtë kohë dy roje dolën nga godina dhe na urdhëruan të largoheshim.

Babait nuk ia thamë. Në të tjerët jetuam në ankth, deri sa erdhi dita e takimit. Shkuam në burg, duke mos ditur ç'na priste. Kërkuam të takoheshim me Arshinë. Atij i thirrën emrin. Qe gjallë!

Myzafer Pipa (1914-1946)

Arshiu u gjykua për here të dytë. Gjatë gjykimit, mori vesh vdekjen e vëllait, Myzaferit. Na qortoi që nuk e kishim njoftuar. Nuk ia kishim thënë për të mos e munduar edhe më, ndërkohë që brengën e kishim mbytur brenda vetes tonë. Kur vizitonim Arshinë në burg, hiqnim rrobat e zisë dhe vishnim ato normale. Kur Arshiu na pyeste për Myzaferin, i thoshim se ishte mirë, duke mbajtur në zemrat tona pikëllimin.

Në korrik 1948, Arshiu u dërgua në kampin e punës se detyruar famëzi të Vloçishtit. Disa muaj më pas, në nëntor 1948, ai u dënua për herë të dytë me njëzet vjet dhe u transferua në kështjellën burg të Gjirokastrës.

Në vjeshtë të vitit 1949, regjimi shpërnguli nga Durrësi rreth njëzet familje të persekutuara dhe i vendosi në shtëpi boshe në plazh. Ne ishim, doemos, midis tyre. Kërkuam që babanë ta transportonin me autoambulancë.

Partia refuzoi. Pajtuam


Arshi Pipa


I dashtun Fajk,
ti falemnderit për i
mintârd (kît ma bâni të njoftum Tareja
nji gjâ e kândëshme për njerinin kuer shef
kît e vjetër nuk e kanë harrua . Edhe
pra të dërgoj kët fotografi, për shenj k
Ame mendue se, mbasi more vesh oé jam gjal
të jeshë kërcënuar edhe me dijtë si jam
kondisë, mbasi aq vjeçësh gji nuk jemi
ame mirinet mea të mirat e të persëcutu
Sarajevo, Maj 1958



një karroce me kalë, i vetmi mjet transporti që mund të gjendesh.

Për here të parë në katër vjet, babai i veshur me kostum, u detyrua të qëndronte në këmbë. Në karrocë ai i mbante ato të shtrira para vetes. Ne, motrat, ndiqnim nga pas karrocën. Plazhi ishte rreth 5 kilometra larg nga shtëpia që lamë.

Meqenëse rruga ishte e keqe e me gropa, iu lutëm karrocierit të ecte më ngadalë, për të mos trondituar babanë. Por, ai donte të kthehej në Durrës para se të fillonte shiu e, prandaj, nuk na e plotësoi lutjen. Në një çast babai u zbeh. Ndjente dhimbje. Karrocieri ndaloi karrocën. Nëna i mbështeti babait kokën në gjirin e saj. Kur arritëm në strehën e re, ishte bërë natë e binte shi. Babai vdiq po atë natë nga një goditje në zemër. Për ta varrosur, na u desh të shisnim orën e tij të xhepit. Përktheu Ilir Hashorva

Arshi Pipa ndër rreshtat e biografëve

Arshiu u lind në Shkodër në 28 korrik 1920. Ai ishte djalë i vetëm në krye të katër motrave. Vëllanë me të madh gjashtë vjet para tij, Muzaferin, e kishte të tillë nga babai. Kështu, ishte drita e syrit jo vetëm e prindërve, por edhe i motrave, të cilat gjithë jetën e kanë adhuruar. Por kjo nuk do të thotë aspak se në familjen Pipa, për Muzaferin nuk ishte po e njëjta gjë. Aty nuk bëhej asnjë dallim ndër dy djemtë e shtëpisë, si nga prindërit, ashtu edhe nga motrat. Ishte një familje me lidhje afektive shumë te theksuara, të pashlyeshme kurrë. Dhe kjo i detyrohet kryesisht nënës se tyre, zonjës së mrekullueshme Hatixhe, shkodrane e përkryer në të gjitha drejtimet, nënës së fortë, të dhembshur aq edhe të drejtë deri në shkallën e një modeli klasik.

Fëmi i mbarë, i shëndetshëm dhe i bukur, Arshiu ishte njëkohësisht edhe një "lojcak" i madh, si thonë në Shkodër, madjé edhe një "sherret", domethënë që nuk linte dy gurë bashkë. Pavarësisht kësaj faktet tregojnë se ai që në klasën e parë e deri në mature dilte gjithnjë i pari i klasës! Filloren e kreu tek shkolla e jezuitëve në Shkodrës, e në mos gaboj edhe në vitet e para të gjimnazit. Them vitet e para, sepse gjimnazet atëherë ishin me tetë e nëntë klasë, deri më vonë madjé, në kohën e regjimit komunist. Vërtetë ishin të paktë këto gjimnaze para luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, por ishin të saktë. Ejo vetëm gjimnazet (ai i Shkodrës, Tiranës, Korçës etj.) por edhe shkollat e mesme profesionale, si Normalja e Elbasanit, Normalja e Tiranës (vetëm për vajza) dhe Shkolla Teknike Amerikane e Fullcit në Tiranë apo ajo e Kavajës.

Tek jezuitët, Arshiu mori bazat e kulturës klasike, me greqishten e vjetër e latinishten dhe për pasojë, kur shkoi të vazhdoje në Gjimnazin shtetënor të Shkodrës, që quhej atëherë Lice, si ai i Korçës dhe i Tiranës, kishte baza të forta për të dalë i pari edhe në dy gjuhët klasike që përmendëm më lart. Dhe këto dy gjuhë, ai s'i ndau gjatë gjithë jetës. Përkthimet e bollshme, të lëna në dorëshkrim e dëshmojnë më së miri këtë fakt.

Gjatë kohës së arsimimit në shkollën e jezuitëve, ku jepnin mësim klerikë të shquar, i ati, duket për një lloj "ekuilibrimi" kulturash e futi që të ndjeki njëkohësisht edhe mejtepin, për të mësuar format e moralit islamik. Kështu Arshiu, deri në moshën e thyer, mbante mend akoma dhe i recitonte për bukuri shumë nga syret e Kuranit arabisht, për çudinë dhe admirimin e miqve shkodranë të dhënë fort pas kësaj feje, por që arabishten nuk e dinin fare, as me shkrim e as me lexim!...

Në Burgun e Burrelit, Arshiu hapte sportelin e birucave dhe u hidhte shokëve të dënuar atje duhan, ndopak sheqer a ç'të kishte mundur të mbledhë, me rrezik që po ta shohin rojet, e fusnin dhe atë në birucë, mes dimrit, në çimento, vetëm me mbathje e kanotjere në trup, për një muaj rresht, megjithëse ai ishte i sëmurë. Guximi i tij u konfirmua edhe gjatë momentit të arratisjes, kur ai çan kufinin, bashkë me të motrën Fehimen, me kobure në dorë, i vendosur të mos bijë në dorë i gjallë më tek rojet.

Me shokë Arshiu ishte, si me gjithë të tjerët i sjellur dhe shumë i dashur. Ai i ndihmonte ata vazhdimisht ne mësimet. Në albumin e familjes, mes të tjerave ka edhe një fotografi ku ai është bashkë me tre shokë të tij të klasës, para një tabele të zezë, në oborr në përgatitjen për provimet e maturës. Në tabelë, veç disa shprehjeve algjebrike, ka në një anë edhe një vjershe, me shkrimin e tij të njohur, vjershë që tregon bukur shpirtin e preokupuar të nxënësve para "torturës" së maturës:

me studime
e numra të shkreta.
kot na shkuen
të rijt e jeta...

Gjimnazi i kohës së tij, si dhe i kohës sime ndahej, mbas semimatures, në dy degë: Reale e klasike. Realja ishte e prirur më fort ndaj shkencave të natyrës, me preferim matematikën e fizikën. Klasikja ishte e prirun ndaj dijeve humanitare të gjuhëve. E Arshiu zgjodhi me dëshirë këtë të fundit. Duket që në moshë fare të re, ai e kishte përcaktuar rrugën e tij në jetë. Dhe kjo punë duket edhe nga dy fakte të tjerë. Gazeta "Cirka" e vitit 1936, kur Arshiu ishte dy vjet para maturës, kishte shpallur një konkurs poetik.

Në të mori pjesë edhe studenti i klasës së gjashtë të Gjimnazit shkodran, i degës klasike, Arshi Pipa. Vjersha e tij me titull "Në Lamën e Luftës" fitoi çmimin e tretë. Ishte një vjershë e gjatë me plot 26 strofa, secila gashtëvangëshe, herë me rimë e herë pa rimë. Vjersha kishte karakter epiko-lirik. Tema e saj ishte një lloj proteste e hapur kundër luftës, si një veprim mizor, që sjell vetëm vdekje. Pra, ishte tërthorazi një hymn për paqen, mirëkuptimin, vllazërimin e njerëzve e popujve. Kështu, humanizmi i shpirtit të tij nis e nxjerrë krye që në moshë fare të re, atë të një adolishenti gjimnazist. Prova e tij e dytë e botuar në shtypin e kohës, këtë herë në lëmin e prozës, shifet tek tregimi me titull "Liqeni", një tregim lirik, botuar tek "Vatra Shqiptare", shtatortetor 1941. Kjo prozë, sigurisht është shkruar në moshë fare të re, por u botua atëherë, siç tregon data, ndërkohë që autori i saj ishte tashmë pedagog në gjimnazin e Tiranës dhe jepte filozofi. Nuk e dimë me saktësi se kur poeti Arshi Pipa ka nisur të shkruajë poezi. Por një gjë është e sigurtë, që këtë punë ai e ka nisur që në bankat e gjimnazit të Shkodrës. Dhe këto poezi në shumicën e tyre do të mbushin më vonë faqet e librit të tij të parë, me titull "Lundertarë" botuar në Tiranë më 1944.

(Pjesa është marrë nga libri: "Arshi Pipa njeriu dhe vepra", shkrimtari Uran Kalakulla)







Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), nenit 54 paragrafi 3 të Ligjit për standardet e nxënësit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/05, 117/08, 17/11, 135/11, 15/13, 41/14, 146/15 dhe 30/16) dhe Vendimit për publikim të Konkursit për ndarje të 150 (njëqindepesëdhjetë) bursave për nxënësit – sportistë të talentuar nga shkollat e mesme shtetërore dhe private të Republikës së Maqedonisë për vitin shkollor 2017/2018, Ministria e arsimit dhe shkencës shpall

KONKURS

Për ndarje të 150 (njëqindepesëdhjetë) bursave për nxënës – sportistë të talentuar nga shkollat e mesme shtetërore dhe private në Republikën e Maqedonisë për vitin shkollor 2017/2018

Ministria e arsimit dhe shkencës për vitin shkollor 2017/2018 do të ndajë 150 (njëqindepesëdhjetë) bursa për nxënës-sportistë të talentuar nga shkollat e mesme shtetërore dhe private në Republikën e Maqedonisë.

I. KUSHTET PËR NDARJEN E BURSËS

Të drejtë për bursë kanë kandidatët të cilët mësojnë në shkollat e mesme shtetërore dhe private në Republikën e Maqedonisë, ndërsa i plotësojnë kushtet në vijim:

1. të jenë nxënës të rregullt të vitit të I të cilët gjatë tre viteve të fundit kanë fituar së paku dy çmime për vendin e I ose të II në gara ndërkombëtare ose shtetërore nga fusha e sportit të organizuara nga federatat nacionale të sportit që kanë vendim për kryerje të veprimtarisë sport të dhënë nga Agjencia për rini dhe sport;
2. të jenë nxënës të rregullt të vitit të II, III dhe IV, të cilët gjatë vitit të kaluar kanë fituar çmime për vendin e I ose II në gara ndërkombëtare ose shtetërore nga fusha e sportit të organizuara nga federatat nacionale të sportit që kanë vendim për kryerje të veprimtarisë sport të dhënë nga Agjencia për rini dhe sport;
3. të kenë të arritur sukses mesatar pre së paku notës 4,00 në arsimin e deritanishëm;
4. të mos kenë përsëritur vitin gjatë arsimimit;
5. të mos jenë shfrytëzues të bursave nga institucione ose firma të tjera;
6. të jenë shtetas të Republikës ës Maqedonisë.

Kriteret për ndarjen e bursave janë suksesi mesatar prej së paku notës 4,00 të realizuar gjatë shkollimit dhe çmimit të realizuar në gara shtetërore ose ndërkombëtare nga fusha e sportit (individual ose ekipor), gjatë së cilës nga kriteri sukses i realizuar gjatë shkollimit mund të fitohen së paku 40 pikë, ndërsa nga çmimet e fituara më së shumti 60 pikë.

Gjatë përcaktimit të pikave të përgjithshme nga çmimet e fituara për nxënësit e vitit të I, do të vlerësohen dy çmimet e fituara të ranguara më të larta, ndërsa për nxënësit prej vitit II, III dhe IV të vlerësohet vetëm një çmim më i lartë i ranguar i fituar.

10 pikat shtesë do ti marrin nxënësit të cilët do të dorëzojnë më shumë se çmimet/diplomat e parapara të fituara, ndërsa janë të një lloji të sportit.

Për çmimet e fituara në gara shtetërore nga sfera e sportit do të njihen vetëm çmimet e fituara në gara të organizuara nga federatat sportive nacionale që kanë vendim për kryerje të veprimtarisë sport të dhënë nga Agjencia për të rinj dhe sport, ndërsa jo nga klubet e sporteve, shoqatat etj.

II. MËNYRA DHE AFATI I PARAQITJES

Nxënësit të cilët paraqiten sipas konkursit, duhet të plotësojnë fletëparaqitje elektronike të vendosur në internet portalin http://konkursi.mon.gov.mk, duke filluar nga 25.10.2017 deri më 5.11.2017.

Para fillimit të paraqitjes elektronike, duhet patjetër ti kompletojnë të gjitha dokumentet e nevojshme nga pika III të këtij Konkursi.

Lista e kandidatëve të zgjedhur do të publikohet më 01.12.2017 në internet portalin http:// konkursi.mon.gov.mk.

III. VENDI DHE AFATI I DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Nxënësit të cilët janë paraqitur në mënyrë elektronike gjatë konkursit, është e nevojshme në Ministrinë e arsimit dhe shkencës, në rr. Sv. Kiril i Metodi nr. 54 – Shkup, prej datës 25.10.2017 – 5.11.2017 prej ora 09 deri në ora 15, ti sjellin dokumentet në vijim:

1. Listë evidentuese;
2. Vërtetim se është nxënës i rregullt në vitin shkollor 2017/2018;
3. Numër identifikimi nga fletëparaqitja e plotësuar me sukses elektronike;
4. Të vërtetuara në noter fotokopje të dëftesave për vitet e mbaruara më herët të arsimit (kandidatët e vitit të I dorëzojnë dëftesat prej klasës VI-IX);
5. Të vërtetuara në noter fotokopje të diplomave të çmimeve të fituara në garat shtetërore dhe/ose ndërkombëtare;
6. Deklaratë të nënshkruar nga prindi – kujdestari se kandidati nuk është shfrytëzues i bursës ose kredisë tjetër, të publikuar në internet portalin http://konkursi.mon.gov.mk;
7. Deklaratë të nënshkruar nga prindi-kujdestari se dokumentet e dorëzuara janë të vërteta dhe se të dhënat në ato janë identike me ato të dhëna të futura në fletëparaqitjen elektronike, të publikuar në internet portalin http://konkursi.mon.gov.mk;
8. Deklaratë të nënshkruar nga prindi-kujdestari për përpunim të të dhënave personale të kandidatit dhe familjes së tij më të ngushtë (prindër, kujdestar, vëllezër, motra), me të cilën pajtohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës përmes detyrës zyrtare të sigurojë dokumentet e nevojshme nga institucionet publike me të cilët ka lidhur marrëveshje për bashkëpunim, të publikuar në internet portalin http://konkursi.mon.gov.mk;

Ministria e arsimit dhe shkencës zyrtarisht, në pajtim me Rregulloren p;r formular të kërkesës për vendosje në shtëpi për nxënës dhe formular të kërkesës për ndarje të bursave, me dokumentacion të nevojshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 189/16), do të sigurojë dokumentet në vijim:

-certifikatë të shtetësisë të Republikës së Maqedonisë nga Ministria e punëve të brendshme.

Çmimet-diplomat ku nuk ka vend të zënë të specifikuar në garat shtetërore ose ndërkombëtare, gjegjësisht çmime dhe mirënjohje për pjesëmarrje në gara pa vend të zënë, çmimet-diplomat që nuk janë fituar në dy vitet e kaluara për nxënësit e vitit të I ose në vitin e kaluar për nxënësit e vitit të II, III dhe IV, nuk do të merren parasysh.

Kandidatët nuk do të rangohen nëse dokumentacioni i dorëzuar është:

-i pakompletuar dhe/ose
-i dorëzuar pas afatit.

Me parashtrimin e dokumenteve të kërkuara kandidatëve u rekomandohet të parashtrojnë edhe kopje të llogarisë së transaksionit në të cilën do të mund ti pranojnë paratë nëse fitojnë bursën.

IV. SHUMA E BURSËS

Shuma e bursës do të arrijë 2.970,00 denarë në muaj për nëntë muaj gjatë vitit shkollor.

Nxënësit që do të fitojnë bursë do të lidhin marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës me çka do të rregullohen të drejtat dhe obligimet.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTËR
Renata Deskoska

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), nenit 54 paragrafi 3 të Ligjit për standardin e nxënësit ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 52/05, 117/08, 17/11, 135/11, 15/13, 41/14, 146/15 dhe 30/16) dhe Vendimit për shpallje të Konkursit për ndarje të 50 (pesëdhjetë) bursave për nxënës të talentuar nga shkollat publike dhe private të mesme në Republikën e Maqedonisë për vitin shkollor 2017/2018, Ministria e arsimit dhe shkencës shpall

KONKURS

Për ndarje të 50 (pesëdhjetë) bursave për nxënës të talentuar nga shkollat publike dhe private të mesme në Republikën e Maqedonisë
Për vitin shkollor 2017/2018

Ministria e Arsimit dhe Shkencës për vitin shkollor 2017/2018 do të ndajë 50 (pesëdhjetë) bursa për nxënës të talentuar nga shkollat publike dhe private të mesme në Republikën e Maqedonisë.

I. KUSHTET PËR NDARJE TË BURSAVE

Të drejtë bursës kanë kandidatët që mësojnë në shkollat publike dhe private të mesme në Republikën e Maqedonisë dhe i plotësojnë kushtet në vijim:

1. të jenë nxënës të rregullt të vitit të I, të cilët gjatë arsimit fillor kanë marrë së paku dy çmime për marrje individuale të vendit të I, II ose III në gara ndërkombëtare ose në gara shtetërore nga lëmi i shkencës, teknikës, kulturës dhe artit, gjegjëse me profesionin që e mëson nxënësi në shkollë të mesme (Lista e lëndëve të rëndësishme për profesionin është shtesë e këtij konkursi të publikuar në internet portalin http://konkursi.mon.gov.mk);
2. të jenë nxënës të rregullt të vitit të II, III dhe IV, të cilët gjatë vitit të kaluar shkollor të kenë fituar së paku një çmim për marrje individuale të vendit I, II ose III në gara ndërkombëtare ose në gara shtetërore nga lëmi i shkencës, teknikës, kulturës dhe artit, gjegjëse me profesionin që e mëson nxënësi në shkollë të mesme (Lista e lëndëve të rëndësishme për profesionin është shtesë e këtij konkursi të publikuar në internet portalin http://konkursi.mon.gov.mk);
3. të kenë arritur sukses të shkëlqyeshëm me kontinuitet 5,00 në arsimin e deritashëm;
4. të mos kenë përsëritur vit gjatë arsimit;
5. të mos jenë shfrytëzues të bursës nga institucione apo firma të tjera;
6. të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë.

Kriteret për ndarje të bursave janë çmimet e fituara individuale në garat ndërkombëtare apo shtetërore.

Gjatë përcaktimit të pikave të përgjithshme nga çmimet e fituara për nxënësit e vitit të I do të vlerësohen dy çmimet më të larta të fituara të ranguara, ndërsa për nxënësit prej vitit të II, III dhe IV do të vlerësohet vetëm një çmim më i lartë i ranguar i fituar.

Për dorëzimin e dy ose më shumë çmimeve – diplomave për nxënësit e vitit të I, që janë fituar gjatë dy viteve të kaluara shkollore, gjegjësisht më shumë se një çmim-diplomë të fituar në vitin e fundit shkollor për nxënësit e vitit II, III dhe IV për fitim individual të vendit I, II ose të III në garë ndërkombëtare nga sfera e shkencës, teknikës, kulturës dhe artit përkatëse për profesionin që e mëson nxënësi në arsimin e mesëm, fitohen pikë shtesë edhe atë: për çdo vend të I (parë) të fituar në gara ndërkombëtare me 3 pikë shtesë, ndërsa në gara shtetërore me 2 pikë shtesë, ër çdo vend të II (dytë) të fituar në gara ndërkombëtare me 2 pikë plotësuese, ndërsa për gara shtetërore me 1 pikë, për çdo vend të III (tretë) të fituar në gara ndërkombëtare me 1 pikë plotësuese, ndërsa në gara shtetërore 0.5 pikë.

Për çmimet e fituara në nivel shtetëror do të pranohen vetëm çmimet e ndara nga shoqatat e akredituara të mësimdhënësve nga ana e Ministrisë së arsimit dhe shkencës të cilët organizojnë gara për nxënësit.

Me garë ndërkombëtare nënkuptohet garë mes nxënësve prej së paku dhjet shteteve të ndryshme.

Me parashtrimin e dokumenteve të kërkuara kandidatëve u rekomandohet të parashtrojnë edhe kopje të llogarisë së transaksionit në të cilën do të mund ti marrin paratë në rast se fitojnë bursën

II. MËNYRA DHE AFATI I PARAQITJES

Nxënësit që paraqiten në konkurs, duhet të plotësojnë fletëparaqitje elektronike që është e vënë në internet portalin http:// konkursi.mon.gov.mk, duke filluar nga 25.10.2017 deri 5.11.2017.

Para fillimit të paraqitjes elektronike, duhet patjetër ti kompletojnë të gjitha dokumentet e nevojshme nga pika III të këtij Konkursi.

Rang lista e kandidatëve të zgjedhur do të publikohet më 01.12.2017 në internet portalin http:// konkursi.mon.gov.mk.

III. VENDI DHE AFATI PËR DORËZIM TË DOKUMENTEVE

Nxënësit, që janë paraqitur në forme elektronike në konkurs, duhet që në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, rr. Sv. Kiril i Metodi nr. 54 – Shkup, në periudhën e njëjtë nga 25.10.2017 - 5.11.2017, nga ora 09 deri orën 15 t`i sjellin dokumentet në vijim:

1. Listë evidentuese;
2. Vërtetim se është nxënës i rregullt në vitin shkollor 2017/2018;
3. Numër identifikimi nga fletëparaqitja e plotësuar e suksesshme elektronike;
4. Fotokopje të vërtetuara në noter të dëftesave për mbarim të viteve të mëparshme të arsimit (kandidatët e vitit të I dorëzojnë dëftesat prej klasës VI-IX);
5. Diploma origjinale për çmime të fituara në gara ndërkombëtare ose shtetërore;
6. Dëshmi për karakterin ndërkombëtar të garave;
7. Deklaratë të nënshkruar nga prindi – kujdestari se kandidati nuk është shfrytëzues i ndonjë bursës apo kredie tjetër, të publikuar në internet portalin http:// konkursi.mon.gov.mk;
8. Deklaratë të nënshkruar nga prindi – kujdestari se dokumentet e dorëzuara janë të vërteta dhe të dhënat janë identike me të dhënat që janë dërguar në formë elektronike, të publikuar në internet portalin http:// konkursi.mon.gov.mk;
9. Deklaratë të nënshkruar nga prindi-kujdestari për përpunim të të dhënave personale të kandidatit dhe familjes së tij më të ngushtë (prindër, kujdestar, vëllezër, motra), me të cilën pajtohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës përmes detyrës zyrtare të sigurojë dokumentet e nevojshme nga institucionet publike me të cilët ka lidhur marrëveshje për bashkëpunim, të publikuar në internet portalin http://konkursi.mon.gov.mk

Ministria e arsimit dhe shkencës zyrtarisht, në pajtim me Rregulloren për formularin e kërkesës për vendosje në shtëpi të nxënësve dhe formularin e kërkesës për ndarje të bursës, me dokumentacion të nevojshëm ("Gazeta Zyrtare e Replikës së Maqedonisë" nr. 189/16), do të sigurojë dokumentin në vijim:

-certifikatë të shtetësisë të Republikës së Maqedonisë nga Ministria e punëve të brendshme.

Çmimet-diplomat ku nuk ka vend të zënë të specifikuar në garat shtetërore ose ndërkombëtare, gjegjësisht çmime dhe mirënjohje për pjesëmarrje në gara pa vend të zënë, çmimet-diplomat të cilat nuk janë fituar në dy vitet shkollore të kaluara për nxënësit e vitit të I, ose në vitin e kaluar tek nxënësit e viteve II, III dhe IV, nuk do të merren parasysh.

Kandidatët nuk do të rangohen nëse dokumentacioni i dorëzuar është:

-i pakompletuar dhe/ose
-i dorëzuar pas afatit.

Me parashtrimin e dokumenteve të kërkuara kandidatëve u rekomandohet të parashtrojnë edhe kopje të llogarisë së transaksionit në të cilën do të mund ti marrin paratë në rast se fitojnë bursën.

IV. SHUMA E BURSËS

Shuma e bursës do të arrijë 2.970,00 denarë në muaj për nëntë muaj gjatë vitit shkollor.

Nxënësit që do të fitojnë bursë do të lidhin marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës me çka do të rregullohen të drejtat dhe obligimet.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTËR
Renata Deskoska

E DHIMBSHME: Fotot tragjike të foshnjës që vdiq nga uria

Fotot tragjike të një foshnje siriane që ka vuajtur nga kequshqyerja, tregon për pasojat e rënda të luftës shkatërruese që zgjati 6 vjet. Sahari, bebja një mujashe i ka brinjët e dala mbi lëkurën e tejdukshme. Ai u trajtua nga një infermiere në një klinikë të kontrolluar nga opozita siriane, në qytetin Hamouria, në rajonin lindor Ghouta në periferi të

kryeqytetit Damask. Konflikti sirian nisi në vitin 2011, janë vrarë mijëra e qindra njerëz. Gjithashtu, kjo luftë bëri që gjysma e sirianëve të mbeten pa shtëpi dhe që solli krizën më të keqe të refugjatëve. Sarah dha frymën e fundit të shtunën në klinikë

për shkak të urisë. Pak ndihma humanitare arrijnë ndonjëherë në rajonin e zotëruar nga rebelët që prej vitit 2013, e për pasojë qindra fëmijë vuajnë nga kequshqyerja. Prindërit e Sahar Dofdaa thanë se foshnja e tyre peshonte vetëm 1.9 kg

Përfundimi i këtij biznesi armatimi qe bllokuar për disa muaj, edhe për shkak të një afere korrupsioni në Izrael. Tani marrëveshja u bë. Taksapaguesit gjerman ajo i kushton më shumë se gjysmë miliardi euro

Gjermania edhe i shet dhe i paguan nëndetëse Izraelit

Një marrëveshje përkatëse qeveritare për dërgimin e tri nëndetëseve marinës së Izraelit do të nënshkruhet të hënën, bëri të ditur zëdhënësi i qeverisë gjermane, Steffen Seibert. Detajet e marrëveshjes janë konfidenciale. Seibert tha se qeveria gjermane i ka mbajtur parasysh "të gjitha pikat me rëndësi" në marrëveshje.

Gjermania jo vetëm shet, por edhe jep mbështetje financiare në marrëveshjen për nëndetëset, që besohet se kap shumën e 1.5 miliardë eurove. Kjo argumentohet me faktin se Republika Federale ndihet veçanërisht përgjegjëse për sigurinë e shtetit Izrael. Kontributi financiar vlen si kontribut për mbrojtjen dhe për sigurimin e ekzistencës së Izraelit, u bë e ditur në Berlin. Bëhet fjalë për shitjen e tri nëndetëseve të Sistemeve të Marinës ThyssenKrupp (TKMS) në Kiel. Nëndetëset e klasës Dolphin mund të pajisen nga Izraeli edhe me armë atomike. Nëndetëset e reja do të hyjnë në shërbim në vitin 2027 dhe do të zëvendësojnë tri modele më të hershme. Qeveria gjermane do të mbështesë biznesin e nëndetëseve me Izraelin financiarisht me rreth një të tretën e shumës së blerjes. "Shuma maksimale është 540 milionë euro", i tha zëdhënësi i qeverisë Seibert agjencisë së lajmeve Reuters. Fjala është për rreth 30 për qind të vëllimit të biznesit. Shuma prek buxhetet federale të Gjermanisë të viteve 2018 deri 2027. Zyra kancelarore fillimisht në qershor e ndaloi shitjen e nëndetëseve të ThyssenKrupp-it Izraelit, për shkak të dyshimeve për ryshfet dhe hetimeve për korrupsion në Izrael.

Sipas raporteve të mediave izraelite, marrëveshja e re me qeverinë gjermane përmban edhe një klauzolë tërheqjeje nga marrëveshja, për rastin se do të konfirmohet dyshimi për vepra penale. Hetuesit e korrupsionit në Izrael patën arrestuar në kuadër të hetimeve partnerin izraelit të TKMS, Miki Ganor. Më tej ata arrestuan ish-shefin e zyrës së kryeministrit izraelit, Benjamin Netanjahu dhe një ish-bashkëpunëtor të tij. Arrestimet u bënë ndër të tjera edhe për shkak të dyshimit për larje parash dhe për mashtrim, u bë e ditur në korrik në Izrael. Fillimisht nën presion ishte edhe vetë Netanjahu. Atë e akuzuan se e kishte imponuar marrëveshjen për nëndetësen kundër dëshirës së ushtrisë dhe të ministrisë së Mbrojtjes.

"Uria dhe sëmundjet po shkaktojnë më shumë vdekje se sa përleshjet në rajonet e luftës. Ndalimi i ushqimit, ndihmave dhe prodhimit të ushqimit është krim lufte", tha Hilal Elver

Përdorimi i urisë si armë lufte është një krim lufte

Raportuesja Speciale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ushqimore, Hilal Elver thotë se uria dhe sëmundjet po shkaktojnë më shumë vdekje se sa përleshjet në rajonet e luftës. Elver në një konferencë për media në Qendrën e Përgjithshme të OKB-së njoftoi për raportin vjetor të prezantuar në Këshillin e Përgjithshëm të OKB-së. Ajo tha se bota këtë vit po ballafaqohet me fatkeqësinë më të madhe njerëzore në historinë e OKB-së. Elver thotë se 20 milionë persona në Jemen, Somali, Sudanin Jugor, Nigeri dhe Siri po përballen me urinë. Raportuesja e OKB-së vuri në dukje se 815 milionë persona në botë po përballen me ushqim jo të mjaftueshëm dhe se shtete të shumta nuk i përmbushin përgjegjësitë ligjore. “Uria dhe sëmundjet po shkaktojnë më shumë vdekje se sa përleshjet në rajonet e luftës. Ndalimi i ushqimit, ndihmave dhe prodhimit të ushqimit është krim lufte”, thotë Elver. Sipas saj, ushqyerja është e drejtë e të gjithë njerëzve në mënyrë të pakushtëzuar. Elver thekson se uria nuk duhet të përdoret si armë lufte dhe se ata të cilët e përdorin në këtë mënyrë duhet të dërgohen në Gjykatën Ndërkombëtare Penale. Ajo gjithashtu foli për krizën njerëzore në Arakan, ku shprehu se kërcënimi nga uria ka arritur në nivele serioze dhe paralajmëroi se gjendja do të përkeqësohet edhe më shumë në qoftë se bashkësia ndërkombëtare nuk merr masa. Elver i bëri thirrje Qeverisë së Mianmarit që të lejojë hyrjen e Komisionit të pavarur hetues të OKB-së në Arakan.

TURQIA SIGURON MBI 50 MILIONË DOLLARË PËR REFUGJATËT ROHINGYA

Konferenca ndërkombëtare e donatorëve në Gjenevë, që ka për qëllim të ndihmojë muslimanët Rohingya të cilët u larguan nga dhuna në Mianmar, filloi me Turqinë e cila premtoi se do të sigurojë mbi 50 milionë dollarë në mbështetje të refugjatëve Rohingya. Ambasadori i Turqisë në Zyrën e OKB-së në Gjenevë, Naci Koru, në konferencë bëri të ditur se në kuadër të ndihmës humanitare, Turqia planifikon të ndërtojë njësi strehimi afatmesëm për 100 mijë persona në një sipërfaqe prej tre milionë metra katrorë, dy spitale në terren, dhjetë qendra shëndetësore, si dhe puse të ujit të pijshëm dhe ushqim të freskët. “Së bashku me projektet dhe dërgesat e planifikuara, shuma e përgjithshme e ndihmës humanitare të siguruar nga Turqia do të kalojë 50 milionë dollarë”, theksoi Koru.

Tri dekadat e Murit që ndau botën

Përshkrimi: muri i sigurisë, materiali: beton arme, perimetri: 155 km, lartësia: 3.60m, vendi: Berlini lindor i Republikës Federale Demokratike të Gjermanisë, inagurimi: 13 gusht të 1961, domethënia: simboli më i madh i Luftës së Ftohtë mes SHBA-ve dhe Bashkimit Sovjetik

Kjo skedë është një enciklopedi historie për studentë dhe do të jetë e vetmja që mbetet pas 28 vitesh të atij burgu të madh në qiell të hapur në sektorin e Berlinit Lindor, pas Luftës së Dytë Botërore dhe pasojë e triunfit të aleatëve mbi Rajhun e Tretë. Berliner Mauer, emri i tij në gjermanisht i ngritur me shpejtësi supersonike dhe e pagëzuar nga Perëndimi si "muri i turpit" kishte një qëllim të vetëm, atë të pengimit të arratisjes masive të banorëve të zonës komuniste drejt lirisë. Për qarqet sovjetike kishte arsye komike: "Për të mbrojtur popullatën tonë nga elemente fashiste që konspirojnë kundër vullnetit popullor për të ndërtuar një shtet socialist në Gjermaninë Lindore". Vetëm disa filma bazuar mbi histori reale ose edhe trillime kanë si protagonist Murin e Berlinit dhe sjellin tmerrin gjatë ditës dhe natës të asaj barrikade. I fundit është filmi "Bridge of Spies" i Stiven Spilbergut me Tom Hanks dhe Mark Rylance si protagonistë. Rrëfen një histori të vërtetë, kur në vitin 1957 qeveria amerikane arreston Rudolf Abel, një rezident rus në Bruklin dhe e akuzon për spiunazh në favor të Bashkimit Sovjetik. Në vitin 1960 arrestohet piloti amerikan Gary Powers për spiunazh fotografish dhe një student i dyshuar për trafikim të informacioneve të rezervuara.

Departamenti i shtetit thërret James Donovanin, avokat i sigurimit dhe me famë negociatori që udhëton drejt Berlinit dhe shkëmben Abelin me pilotin dhe studentin. Në film Silbergu ndërton metër pas metri tmerrin e Murit. Kullat me ushtarë të armatosur dhe me urdhra për të qëlluar mbi këdo që përpiqet të largohet, me prozhektorët e mëdhenj, qentë e tmerrshëm, pastorët gjermanë të trajnuar për të sulmuar këdo. Një botë e kërcënuar mbi faqet e të cilit vdiqën më shumë se 200 njerëz që u përpoqën ta kapërcenin. Megjithatë goditjet e para ky Muri i mori brenda Kremlinit. Me vdekjen e Jozef Stalinit, bisha e zezë e komunizmit, të cilit i faturohen 10 milionë të vdekur në kampe pune dhe burgje, lindën dy lëvizje që u përoqën t'i japin një kthesë historisë nga më të shëmtuarat e diktaturës, të nisura në tetor të vitit 1917: 10 ditë që tronditën botën, por që kurrë nuk ish një diktaturë e proletariatit për të cilën fliste Lenini, por një regjim i hekurt që ndaloi çdo lloj forme lirie politike, sociale dhe kulturore. Këto lëvizje ishin "Glasnost " (transparencë) dhe "Perestroika" (ristrukturim) të ideuara nga Mihail Gorbaçov dhe të vazhduara nga Boris Yeltsin. Objektivi ishte futja e bllokut sovjetik në një botë të lirë, duke dekretuar lirinë e shtypit dhe me disa hapa drejt tregut të lirë.

Këto ndryshime të nisura në 1985 dhe me shtrirje deri në vitin 1999 e bënë të padobishëm ekzistencën e Murit të Berlinit, për më tepër ai e kishte përmbushur funksionin e tij. Para vitit 1961, viti i ndërtimit dhe që nga 1949 më shumë se tre milionë banorë gjermanë ishin arratisur nga Republika Demokratike gjermane drejt zonave perëndimore të të njëjtit qytet. Për këtë arsye u ngrit natën e 12 dhe 13 gushtit pa paralajmërim, nga mijëra punëtorë dhe u cilësua si mbrojtje kundër imigrimit, infiltrimit, spiunazhit, sabotazhit, kontrabandës, shitjeve dhe dhunimeve të perëndimorëve. Me kalimin e viteve filloi edhe shkatërrimi i kësaj pengese: avancimi i Moskës drejt formave sociale dhe ekonomike të ndërmarra, diktatura mbytëse staliniste, arratisjet e vazhdueshme pavarësisht rrezikut për jetën (në shtator të 1989 13 mijë gjermanë lindorë shpuan murin afër Hungarisë), manifestimet masive të protestave kundër qeverisë së Gjermanisë Lindore, të gjitha këto parashikuan fundin e Murit...para se të merrte të tatëpjetën. Gjithçka filloi në datën 6 nëntor të vitit 1989, kur një anëtar i Byrosë Politike, Günther Schabowski, në një konferencë për shtyp në televizionin e Gjermanisë Lindore njoftoi se lejoheshin udhëtimet jashtë dhe për këtë duheshin dhënë fillimisht viza.

Papritmas mijëra njerëz u grumbulluan përpara blloqeve gri. Ushtarët nuk guxonin të hapnin zjarr dhe presioni i madh i detyroi të hapnin pikat e kalimit. Në koferencën për shtyp gazetari i agjencisë italiane Ansa, Riccardo Ehrman e pyeti Schabowski-n se kur do të hynte në fuqi ligji për udhëtimet dhe Schabowski pa e parë fletën e dytë të dokumentit sipas të cilit ligji hynte në fuqi vetëm të nesërmen, u përgjigj: – Ab sofort (menjëherë). Shpërthimi i një vullkani dhe llava e tij do të kishin më pak efekte se vetëm ato dy fjalë të shqiptuara nga Schabowski. Radiot dhe kanalet televizive nga të dy anët e Berlinit bërtisnin: "Muri u hap!" Mijëra të tjerë berlinezë lindorë marshuan drejt pikave të kontrollit dhe kërkonin hapjen e tyre për të shkuar në zonën perëndimore. Trupat ushtarake dhe funksionarët nuk ishin në dijeni të episodit të konferencës për shtyp dhe nuk vepruan. Mes orës 11 të natës dhe mëngjesit të së nesërmes orteku njerëzor ishte i pandalshëm. Nga ana tjetër edhe Gjermania tjetër priste me ankth. Pronarët e lokaleve ofronin birra falas. Duar të njohura dhe të panjohura takoheshin me njëra-tjetrën. Ajri i lirisë po përhapej pa barriera. Deputetët e Bonit kënduan me zë himnin gjerman. Në datën e 9 nëntorit të 1989-ës, kishin kaluar 28 orë, kur mijëra punëtorë së bashku me ushtarë të panumërt ushtruan një akt drejtësie me lopata, kazma dhe çekiç kundër këtij masivi gri, ndërsa turma këndonte. Violençelisti i njohur, Mstislav Rostrópovich që jetonte në ekzil në Berlinin Perëndimor u jepte zemër prishësve të murit.

NJË FOTOGRAFI QË BËRI HISTORI...



Artisti gjerman Bodo Sperling arriti të shpëtonte disa blloqe për të filluar kështu galerinë e artit urban në vende të hapura dhe nga ai lindi "East Side Gallery" përgjatë lumit Spree, të tjerë pikturuan muralet në homazh të kësaj vepre. Me rënien e Murit nuk ranë vetëm blloqet, por edhe 70 kilometra tela dhe gjemba, 160 rrugë të ndriçuara, 150 tabela, 200 kulla ruajtëse dhe 30 pika kontrolli. Nuk ra vetëm një symbol i diktatuës komuniste, por i të gjitha diktaturave, një mësim i së shkuarës dhe së ardhmes: liria hapet përjetësisht. Po përveç thirrjeve për fitore kalimi i lindorëve në botën perëndimore nuk ishte i lehtë. Prapambetja e teknologjisë e asaj popullsie kërkonte kurse formimi, ndihmë sociale, krijim të vendstrehimeve, kujdes mjeksor dhe të gjitha derivatet e një regjimi që nga 1961 deri në 1989. Ky Mur dogji dy gjenerata dhe i la në injorancë, frikë dhe dyshim: tre forma klasike këto për të ushtruar pushtetin absolut. Kostoja e kësaj ngjarjeje historike është e pallogaritshme për Gjermaninë. Nga ana tjetër qëndron si kundërpeshë ndaj krimeve më të mëdha të historisë njerëzore, ajo e Hitlerit dhe e Rajhut të Tretë.

Dhurata e Hillary Clintonit

Mos pushoni së luftuar

Dalja e librit të saj "Çfarë ndodhi" muajin e kaluar, ka shënuar nisjen e fazës së pranimit dhe të zbulesës, për herë të parë, të një ane emocionale të karakterit të saj, që për një kohë të gjatë e kishte mbajtur nën kontroll

Hillary Rodham Klinton, më 26 tetor mbush 70 vjeç dhe është një ditëlindje e rëndësishme. Sepse është shifër e rrumbullakosur dhe sepse vjen në një moment krucial. Që kur humbi zgjedhjet, pothuajse një vit më parë, kandidatja, e cila dukej se e kishte fitoren tashmë në xhep, kaloi nëpër pothuajse të gjitha fazat e pikëllimit, me siguri shoku, zemërimi dhe depresioni. "Ka pasur raste kur e vetmja gjë që doja të bëja ishte të bërtisja me sa kisha në kokë, me fytyrë në jastëk," tha ajo për revistën javore Nju Jorker. E mbyllur në shtëpinë e tij në Chappaqua, në veri të Big Apple, Hillary e kaloi muajin e parë në vetmi, duke ecur në pyll, pa makijazh, me tuta, vite dritë larg përsosmërisë televizive të muajve zgjedhorë. "Pirja e Chardonnay më ka ndihmuar. Ashtu si edhe yoga".

Dalja e librit të saj "Çfarë ndodhi" muajin e kaluar, ka shënuar nisjen e fazës së pranimit dhe të zbulesës, për herë të parë, të një ane emocionale të karakterit të saj, që për një kohë të gjatë e kishte mbajtur nën kontroll, nga frika se mos gjykohej shumë me humor dhe e papërshtatshme për rolin e presidentes. Dy javë më parë, ajo ishte mysafire e emisionit televiziv të aktorit Jimmy Fallon. Në një moment, komediani tha se shumë nga autoret e programit, adhuruese të Clintonit, donin t'i jepnin disa shënime falënderimi. Clinton pranoi.

Njëra pas tjetrës, vajzat e moshës 20 deri 30 vjeç, u ulën në tryezën e Jimmy Fallon, në një ritual që u kthye shpejt nga komik, në shumë prekës.. "Faleminderit që jeni kandidatja e parë femër për Presidencën", shkruajti e para. "Faleminderit që jeni senatorja e parë e Shtetit të Nju Jorkut. Ju faleminderit që jeni zonja e parë që tejkaloni rolin e zonjës së parë dhe bëheni Sekretare e Shtetit. E pra, faleminderit që ishit Hillary Clinton i politikës amerikane".

Një tjetër shkruajti: "Faleminderit që e keni trajtuar këtë tranzicion me një hijeshi që nuk mendova se ishte e mundur ta kishit". Një e tretë: "Faleminderit për forcën që tregove para, gjatë dhe sidomos pas zgjedhjeve". Dhe kështu me radhë, deri tek ylli i popit Miley Cyrus, e cila mes lotëve, e falënderoi atë "sepse jeni një shembull i vazhdueshëm i forcës, shpresës dhe vendosmërisë për miliona gra të reja." Pastaj Hillary, dukshëm e prekur mori fjalën dhe shprehu ajo falënderime: "Faleminderit për të gjitha gratë dhe vajzat: ju jeni të forta, inteligjente dhe meritoni çdo mundësi. Së bashku kemi bërë të dëgjohen zërat tanë, kemi bërë gjëra të mëdha, kemi shkuar shumë larg. Nuk mund të ndalemi dhe nuk do të ndalemi".

Gati një vit pas fushatës, një humbje e bujshme që do të hyjë në histori, dhe për herë të parë Hillary u duk njerëzore, e brishtë por e dhembshur, e vendosur por jo e fortë. Shtresa e trashë e akullit me të cilën jemi mësuar ta shohim, ajo me të cilën u përball me të gjitha sfidat e jetës së saj, profesionale dhe njerëzore, për të paktën pesë minuta ishte shkrirë, duke i hapur rrugë një gruaje dhe një nëne të ndjeshme. Sa për të hequr një dyshim: po sikur gjatë zgjedhjeve, në vend të ushtares së akullt, të na kishte shfaqur këtë grua? Tani Hillari mund të jetë vetvetja. Dhe që, pas fazës së pranimit, të vijë shpresa, domethënë, të 70-at marrin një kuptim të ri, më të gjerë. Disa ditë më parë dolën lajme për tensione të forta me Billin: kur nuk e sulmojnë dot më për përmbajtjen, kalojnë tek thashethemet. Po ajo? "Asnjëherë mos pushoni së luftuari për atë që besoni. Shumë njerëz shpresonin se unë do të largohesha, do të zhdukesha", shkruan ajo në libër. "Por unë jam ende këtu". Sepse, edhe pse ka konfirmuar që nuk do të kandidojë më kurrë, Hillary Clinton është në këtë moment e nevojshme. Ndoshta sot më shumë se kurrë. *(Grazia)*

Ëndërrimtarja shqiptaro-amerikane

Rreziku nga depërtimi

Juana Skenderi, një regjisore 30-vjeçare, e cila aktualisht po punon në një projekt dokumentar për atë se si është të jesh një emigrant pa dokumente dhe për "ëndrrën e dështuar amerikane" të familjes së saj, po pret me padurim që negociatat e Kongresit të përfundojnë

Lura LIMANI

Juna Skenderi nuk ka dalë prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës qe 21 vjet. Fjalë-shpejtë dhe gazmore, ajo mund të përshkruhet si një vajzë 'alla amerikane'. Por, Skenderi, me origjinë nga Shqipëria, është një emigrante pa dokumente. "Ne e kemi tejkaluar vizën tonë për 18 vjet", shpjegoi Skenderi sinqerisht. Ajo është përfituese e Aksionit të Shtyrë për të Ardhur të Mitur, DACA, një program që presidenti Obama e krijoi me një urdhër ekzekutiv në vitin 2012 për t'i dhënë njerëzve pa dokumente që mbërritën në Shtetet e Bashkuara si fëmijë, një rrugë për tu arsimuar dhe për të punuar. Presidenti Donald Trump, i cili kandidoi me një platformë ksenofobike, e ndërpreu programin muajin që shkoi dhe Skenderi, e cila ka jetuar shumicën e jetës së saj në SHBA, ndoshta do të duhet të largohet nga vendi të cilin e quan shtëpi.

"Mënyra se si u shfuqizua DACA do ta përshkruaja si një ndarje shumë të keqe", më tha Skenderi në fillim të shtatorit, një javë pasi administrata e presidentit Trump kishte njoftuar se do të ndërpritej DACA dhe do të ndaloheshin aplikimet e reja.Programi, i nënshkruar nga Obama pas një sërë dështimesh për të miratuar një projektligj të njohur si "Akti DREAM" në Kongres, u ofron leje pune dhe mbrojtje dyvjeçare të rinovueshme nga dëbimi disa emigrantëve pa dokumente që kishin mbërri në SHBA para moshës 16 vjeçare. Si pjesë e programit, këta imigrantë ishin dashur të regjistroheshin pranë qeverisë dhe të jepnin një adresë shtëpie, gjë që tani shqetëson shumë përfitues që kanë frikë se mund të gjinden lehtë dhe të deportohen.

"Duke e anuluar programin në këtë mënyrë të pamëshirshme, ndoshta tërthorazi mund të jetë një gjë e mirë", tha Skenderi, duke shtuar se tani që të gjithë janë "shumë të vetëdijshëm dhe shumë të ndjeshëm", një zgjidhje mund të jetë e mundshme. Pas kundërshtimit të menjëhershëm të vendimit, presidenti filloi të jepte deklarata kontradiktore: disa orë pasi administrata e tij e anuloi programin, ai deklaroi dashurinë e tij për të ashtuquajturit Ëndërrimtarë dhe i dha Kongresit një afat kohor për të ratifikuar një projekt-ligj deri në mars 2018. Por pasi që Shtëpia e Bardhë publikoi kërkesa të rrepta për ndryshimin e ligjeve të imigracionit, duke përfshirë ndërtimin e një muri prej 10 miliardë dollarësh në kufi me Meksikën (një veprim që u quajt "sabotimi" nga Washington Post), të dielën që shkoi, një marrëveshje për të shpëtuar DACA-n duket e paarritshme.

"Duke e bërë këtë (presidenti Trump) më detyroi mua dhe shumë fëmijë, sepse ndihem si një fëmijë kur flas për këtë, ai na detyroi të jetojmë në të tashmen", më tha Skenderi derisa pinim çaj të gjelbër në qendër të qytetit në New York. "Ne nuk mund të bëjmë plane."

Skenderi, një regjisore 30-vjeçare, e cila aktualisht po punon në një projekt dokumentar për atë se si është të jesh një emigrant pa dokumente dhe për "ëndrrën e dështuar amerikane" të familjes së saj, po pret me padurim që negociatat e Kongresit të përfundojnë. Demokratët e Kongresit amerikan po përpiqen të shpëtojnë programin duke rënë dakord me kërkesat e Shtëpisë së Bardhë për politika më të rrepta të emigracionit, përderisa aktivistë të drejtave të imigrantëve vazhdojnë të protestojnë. Në vendlindjen e saj, udhëheqësja e pakicës në Kongres, Nancy Pelosi u përball me aktivistë, të cilët përmbytën skenën duke kërkuar "Të gjithë ose asnjëri!" "Termi 'Ëndërrimtar' ka qenë në familjen time për një kohë shumë të gjatë", tha Skenderi, e cila u shpërngul me prindërit dhe dy motrat e saj në New Jersey në vitin 1996 kur babai i saj mori një punë në një kompani amerikane. Jo shumë kohë pasi mbërritën, babai i Skenderit, një farmacist i specializuar në mjekësinë bimore, kuptoi se kompania po falimentonte. Pasi kjo ndodhi, ai humbi punën dhe nuk mundi ta ripërtërinte lejen e punës. Në prill të vitit 1999, familja kishte dy zgjedhje: të kthehej në Tiranë gjatë kulmit të luftës në Kosovë, ose të qëndronte në SHBA në mënyrë të paligjshme.

"Këtë e mora vesh vetëm kur fillova për tu bërë gati të aplikoja në kolegj", shpjegoi Skenderi, e cila studioi film në Universitetin Shtetëror të Montclair, duke punuar derisa ishte në kolegj pasi nuk kishte të drejtë të merrte kredi (kur e pyeta për këtë, ajo hapi sytë dhe tha: "Kredi? Jo." dhe qeshi me naivitetin tim). Historia e saj është shume e ngjashme me plot prej përfituesve të tjerë të DACA-s, disa prej të cilëve nuk e kuptojnë statusin e tyre derikur deri sa fillojnë të aplikojnë për leje shoferi ose për pranimin në kolegj.

"Ndjehem sikur jam duke qëndruar pezull në ajër. Jam në gjendje të flas për këtë tani, vetëm sepse kam qenë duke punuar në film", tha ajo. "Më duket se një vit më parë, do të isha vetëm duke qarë".

Ka rreth 11 milionë emigrantë pa dokumente në SHBA, rreth 800,000 prej të cilëve janë përfitues të DACA-s. Pjesa më e madhe, 78 për qind, janë nga Meksika, ndërsa emigrantët nga Guatemala dhe Koreja janë përkatësisht pesë dhe tre për qind. Në krahasim, numri i përfituesve të DACA-s nga Ballkani është i parëndësishëm: 250 nga Shqipëria; 70 nga Maqedonia; 50 nga Mali i Zi; 30 nga Serbia; 20 nga Kosova dhe Kroacia; dhe asnjë rast i regjistruara nga Bosnja dhe Hercegovina apo Sllovenia. Ndërsa Skenderi ndan



shpjegonte derisa dy rreze të dritës shponin qiellin e New Yorkut në memoriam, ndaj sulmit të 11 shtatorit: ajo kishte ngjitur një foto të Kullave Binjake duke u djegur dhe një afishe 'Zoti e Bekoftë Amerikën' në ditarin e saj. "Unë kurrë nuk jam ndier më shumë amerikane në jetën time … se, unë jam në këtë anë", tha ajo me seriozitet.

Përndryshe, albumi i saj me fotografi të ngjitura dokumenton një fëmijëri të lumtur. Skenderi dhe dy motrat e saj e mësuan anglishten për një vit dhe "u integruan shpejt në shoqërinë amerikane, deri në atë pikë sa nuk mendoj se kisha një kohë për të vënë në dyshim gjërat deri më vonë kur isha në shkollë të mesme."

Skenderi vetë ishte e popullarizuar që nga fillimi. Në ditën e parë të shkollës ajo fitoi një garë, duke mposhtur një vajzë të fortë dhe u bë shpejtë shoqe me vajzat e popullarizuara "Duke u bërë e popullarizuar … unë u pranova menjëherë".Vetëm më vonë, në shkollën e mesme, ajo e kuptoi se për dallim nga shumë prej miqëve të saj ajo nuk kishte shumë privilegje, por ishte "pranuar menjëherë" për shkak se ishte e bardhë. Në shkollën e mesme ajo gjithashtu e kuptoi se ajo nuk mund t'u thoshte bashkëmoshatarëve emigrantë me ngjyrë se "ajo ishte njëra prej tyre". Ajo e kujton këtë me faj, duke e kuptuar se nje prej arsyeve që s'e kishte bërë këtë si adoleshente ishte sepse do të kishte rrezikuar statusin e saj si një vajzë e bardhë, e popullarizuar. Puna e parë e Skenderit ishte në bibliotekën e qytetit në Rutherford, kur ajo ishte 16 vjeçe. "Për shkak se isha 16 vjeç, ata nuk kërkuan autorizim … gjithçka që kisha ishte një letër nga shkolla që thoshte "po, ke leje të punosh", tha ajo, duke shtuar se kjo ishte "puna me të cilën e pagoi kolegjin, njëra prej shumë punëve të tjera".Pasi që kursimet e prindërve të saj mbaruan, babai i saj i cili, e theksoi Skenderi, ka një doktoraturë, kishte bërë dërgesa të picave dhe punuar në një pompë benzine, ndërsa nëna e saj kishte punuar si dado ("Shumë përkujdes ndaj fëmijëve si dado në krejt familjen tonë"). Juna dhe motra e saj më e madhe gjithashtu kishin ndihmuar me qera më vonë. Skenderi, e cila gjithmonë e kishte ditur se donte të ishte një artiste, mësoi se si të xhironte video në shkollë të mesme dhe vendosi të studionte filmin në Montclair."Sinqerisht, ishte opsioni im i vetëm, sepse ishte një kolegj publik dhe unë mund të llogarisja si një student brenda shtetit [të New Jersey-t]", tha ajo, duke shtuar me modesti se pasi ajo ishte e e zonja në punën e saj dhe sharmante, zakonisht i ecte.

"Unë s'e besoj që e kam ditë fort mirë këtë gjë. Thjesht mendoja se ne ishim duke punuar në drejtim të marrjes së Kartelave Jeshile, por për ndonjë arsye ishte disi më sfiduese për ne".

Pajisur me një Numër të Sigurimit Shoqëror, SSN, të cilën prindërit e saj e kishin marrë kur kishin akoma leje ligjore, Skenderi ishte në gjendje të punonte punë të ndryshme në restorante apo nëpër seta filmash dhe të paguante taksat.

"S'kam gënjyer kurrë për statusin tim. Krejt çka thoja ishte: 'Gjithçka që kam është këtë SSN; kam punuar në bibliotekën time dhe kam paguar taksat'. Në të njëjtën kohë mundohesha që t'i bëja të punëdhënësit të mi të bashkëndjenin", tha ajo, duke shtuar me modesti se pasi ajo ishte e e zonja në punën e saj dhe sharmante, zakonisht i ecte.

"Ishte ironike, sepse për shkak të anglishtes sime të përsosur dhe lëkurës sime të bardhë, unë pranohesha në punë, derisa në bodrum dhe në kuzhinë kishte turlifarë njerëz pa dokumente që punonin, të cilët duhej t'i falsifikonin dokumentet dhe po i bënin gjithë këto gjëra. Unë kurrë s'e kam bërë, por thjesht kam qenë në gjendje të them 'Kjo është e gjitha që kam' dhe kjo mjaftonte", tha ajo. Kur u prezantua DACA në vitin 2012, Skënderi ishte ndjerë lehtësuar: tani ajo mund të gjente diçka më shumë se një punë të përkohshme në restorant. Duke qenë pjesë e botës së artit, ja kujtonte asaj edhe se sa po humbiste. Miqtë e saj kanë filluar të kursejnë dhe të udhëtojnë, ose të blejnë shtëpi, gjëra që ajo dëshiron t'i bëjë por që nuk mundet.Në fillim të zgjedhjeve presidenciale, Juna ishte e tmerruar. Trump kishte premtuar të hiqte qafe DACA-n në ditën e parë të presidencës së tij. Ajo u bë më e tërhequr dhe filloi të kishte mendime të errëta. Si një formë e përballimit me këtë, ajo filloi të qëndiste, një artizanat të cilën nëna e saj ia kishte mësuar dhe që ajo e sheh si një mënyrë për t'u lidhur me rrënjët e saj shqiptare. Mund të jetë momenti i fundit për Skenderin, e cila mezi flet ndonjë fjalë shqip, për të filluar që të ushtrojë këtë më tepër.

"Tani për tani ndjej zemërim që ka ardhur puna në këtë pikë për kaq shumë njerëz … që të mund të ndodhë që motra ime dhe unë duhet ta bëjmë atë zgjedhje: t'i paketojmë valixhet tona dhe të ikim", psherëtiu ajo. "Familja ime ende ka një apartament të vogël në Shqipëri, unë kam familje në Shqipëri që do të kujdeset për mua. Unë nuk e kam edhe aq keq", tha ajo, duke u përpjekur për të gjetur një fije shpresë. *(reporter.al)*

Profile: Kristaq Dhamo

Një jetë me filmin



Dhamo vazhdon ta ndjek me shumë vëmendje ecurinë e kinematografisë shqiptare dhe i vjen keq për tërë ata kineastë të talentuar që nuk po mundin dot t'i shprehin aftësitë e tyre për mungesë fondesh financiare

Në radhën e figurave më të shquara të kinematografisë shqiptare, sidomos të dekadave të para të jetës së saj, pa as më të voglin dyshim Kristaq Dhamo zë një vend shumë të nderuar.

Po cili është Kristaq Dhamo?

I lindur më 20 prill të vitit 1933 në Libofshë të rrethit të Fierit në një familje të mirënjohur për kontribut atdhetar, Kristaq Dhamo në vitin 1952 do të mbaronte Liceun Artistik "Jordan Misja", në degën e dramaturgjisë. Ai është i vetmi nxënës në historinë e këtij Liceu, që mbrojti diplomën me vënien në skenë të pjesës "Dëftesa e pjekurisë" të autorit sovjetik K. Simonov, e cila u shfaq disa herë në Teatrin Popullor. Në të interpretuan për herë të parë P. Mani, K. Spahivogli, E. Oktrova, M. Luarasi e të tjerë, që, më vonë, do të bëheshin figura të shquara të skenës shqiptare. Në vitet 1952 – 1956 Kristaq Dhamo do të studionte në Budapest të Hungarisë për regji filmi në Institutin e Lartë të Teatrit dhe të Kinematografisë së atij vendi. Duke vlerësuar përgatitjen e tij të lartë, në qershor të vitit 1956 Këshilli Pedagogjik i këtij Instituti i besoi, si punë diplome, xhirimin e filmit artistik "Histori dashurie". Ishte një provë jo vetëm për këtë student, por edhe për vetë Institutin, pasi ishte filmi i parë me metrazh të gjatë që realizohej me vetë forcat e shkollës. Për fat të keq, u arrit të xhiroheshin vetëm nëntë minuta, sepse, pas ngjarjeve të revolucionit hungarez të tetorit 1956, Qeveria shqiptare nuk e lejoi qëndrimin e mëtejshëm të këtij studenti në Hungari. Një muaj mbas kthimit prej Budapestit, pikërisht më 18 dhjetor 1956 Kristaq Dhamo emërohet regjisor në Kinostudion "Shqipëria e re". Tanimë ai do t'i kushtohej detyrave të shumta dhe, për më tepër, mjaft të vështira. Sepse, hidheshin hapat e para në rrugën e kinematografisë shqiptare. Më 1 qershor 1957 fillon xhirimin e filmit të parë artistik shqiptar me metrazh të gjatë: "Tana", me skenar të Fatmir Gjatës, Nasho Jorgaqit e të vet Kristaqit. Filmi mbaron së xhiruari në nëntor të po atij viti, domethënë brenda gjatë muajve! Mirëpo… në rrethana krejt misterioze zhduket negativi dhe pozitivi origjinal i montuar! Ajo çka shikohet sot, nuk është tjetër, veçse një rimontim i materialit të cilësuar si i pavlefshëm në variantin e parë, me disa episode shtesë, të kërkuara këto nga instancat partiake, për ta bërë filmin "sa me realist"!

Qe për këtë arsye, që ky film të shfaqej më 1958, duke u ndryshuar kësisoj edhe data e prodhimit! Filmi "Tana" ka hyrë në historinë e filmit shqiptar edhe si vepra e parë artistike me metrazh të gjatë. Në një boshllëk total teknik e organizativ të Kinostudios së kohës, dilte nevoja për një kompletim tërësor të këtij institucioni. Falë këmbënguljes së disa kineastëve të kohës, në mënyrë të veçantë të regjisorit të ri të Kinostudios, Kristaq Dhamo, u ngrit prapavija e nevojshme për prodhimin e filmit artistik (reparti i dekoreve, rrobaqepësia, kostumeria, rekuizita, ndriçimi, butaforia etj. Në punë e sipër u përgatitën edhe punonjësit teknikë e artistikë, që, më pas, do të ishin një prapavijë e fuqishme e filmit artistik shqiptar. Në vazhdim të punës si regjisor, Kristaq Dhamo do të ishte autor i disa filmave. Kështu, më 1959, në bashkëregji me sovjetikun J. Ozerov, xhirojnë bashkëprodhimin sovjeto – shqiptar "Furtuna". Më pas do të xhiroheshin dokumentarët "Ne u dashuruam me Shqipërinë" (1959) dhe "Asambli i Këngëve dhe i Valleve" (1960), realizuar këta në bashkëpunim me G. Erebarën, me të cilat nis edhe krijimtaria kinematografike e suksesshme e këtij të fundit. Kineast me interesa të gjëra intelektuale, Kristaq Dhamo do t'i shpaloste aftësitë e veta edhe në fusha të tjera të kinematografisë. Më 1959, si anëtar i stafit pedagogjik punoi për formulimin e programeve të Shkollës së lartë për Aktorë "Aleksandër Moisiu", ndërsa më 1960 dha në të leksionet e para në vendin tonë për regjinë, teorinë dhe estetikën e filmit, si dhe për historinë e kinemasë.

Ndërkohë, nuk e ndërpreu veprimtarinë krijuese. Në vitin 1963 realizoi filmin "Detyrë e posaçme", për të arritur më 1965 te filmi "Vitet e para", vlerësuar me çmimin e Republikës të klasit II dhe me Diplomë Nderi në festivalin e parë të Filmit Ballkanik në Varna (Bullgari, 1965) për "regjinë e skenave masive me vërtetësi kronikale". Veprimtarinë artistike e vazhdon me dokumentarin "Ata nuk vdesin" (1966) me bashkëskenarist P. Dadon. Ky është një dokumentar me vlera të spikatura për heroizmin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Po me P. Dadon si bashkëskenarist, më 1969 realizohet filmi "Gjurma", që shfaqet më 1970, pas një kalvari të gjatë korrigjimesh, rezultat i asaj fryme që kishte të bënte me luftën kundër dukurive të huaja në art e kulturë?! Ripunimeve të theksuara iu nënshtrua edhe filmi "Brazdat".Fatmirësisht, në arkiv ruhet i plotë varianti origjinal.

Dhamo, iniciator dhe drejtues i Festivalit të Filmit Shqiptar, që sot është harruar

Dy vjet më parë qe xhiruar filmi "Mëngjese lufte", një ndër krijimet filmike më të arrira me temën e fëmijëve gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Më pas vijnë filmat "Nga mesi i errësirës" – vlerësuar me çmim "Për regjinë më të mirë" në festivalin e filmit shqiptar 1979, "Qortimet e vjeshtës" – vlerësuar me çmim të dytë në festivalin e 5-të të Filmit Artistik (1983), "Vendimi" – i vlerësuar me çmimin e dytë në festivalin e 6-të të Filmit (1985) dhe "Botë e padukshme", që cilësohet si filmi më i mirë i vitit 1987 dhe nderohet me Çmimin "Aleksandër Moisiu".

Njohës mjaft i mirë i gjuhës filmike, kërkues në punën krijuese me aktorin, sqimatarë dhe i kujdesshëm maksimalisht me montazhin, me krijimtarinë e tij Kristaq Dhamo zë një vend të rëndësishëm në historinë e Kinematografisë shqiptare. Në tërësi kjo krijimtari shquhet për vërtetësi e realizëm artistik në pasqyrimin e atmosferës së kohës, të cilën e arrin përmes paraqitjes realiste të mjedisit sendor – figurativ me atë të marrëdhënieve njerëzore. Tregimi i qetë, analitik, mizanskenat që burojnë nga logjika konkrete e dramës dhe e personazhit, detajet jetësore e artistike, metafora dhe figura të tjera artistike janë, gjithashtu, karakteristike në krijimtarinë e këtij kineasti të shquar. Si udhëheqës artistik i Kinostudios për një kohë të gjatë (1973 – 1981) dhe 1984 – 1992, si iniciues dhe drejtues artistik e pedagogjik i studios artistike (1973) dhe i kurseve pasuniversitare (1974 – 1992), Kristaq Dhamo ka dhënë një ndihmesë tejet të veçantë në përgatitjen dhe formimin e artistëve të rinj, që, me kalimin e kohës, u bënë personalitete të mirënjohura në fushën e artit filmik: I. Muçaj, K. Mitro, E. Musliu, S. Kumbaro, R. Ljarja, K. Gjonaj, S. Pecani, H. Kamberi, N. Tafa, F. Koçi, B. Bisha, GJ. Xhuvani, E.Ibro, B. Martiniani, I. Kasapi e disa të tjerë. Është e vështirë, që, në dhjetëra e dhjetëra filma të viteve 1973 – 1992, të mos gjesh gjurmët e dukshme të këshillave dhe të ideve krijuese, që Kristaq Dhamo i shpërndante gjithandej me bujari.

Kristaq Dhamo ka qenë zgjedhur anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë dhe kryetar i Komisionit të talenteve të reja të skenës dhe të ekranit. Ndërkohë, ka qenë iniciator i organizimit të Festivalit të Filmit Shqiptar dhe drejtuesi i tyre që nga i pari (1976) dhe deri më 1991. Paralelisht me këto detyra, ka udhëhequr mbrojtje diplomash për probleme të dramaturgjisë kinematografike, sikurse ka shkruar mjaft artikuj e studime për probleme të kinemasë. Ai është edhe përkthyes i disa prej veprave të kinestetëve të njohur, bashkautor në tekstin Historia e Artit 4 etj. Në vitin 1979 Kristaq Dhamos i jepet titulli Artist i Merituar, ndërsa në vitin 1982 i jepet titulli më i lartë: Artist i Popullit. Në Festivalin e 11-të të Filmit Shqiptar (2000) nderohet me "Çmimin e karrierës si regjisor". Tashmë 84-vjeçar, Artisti i Popullit Kristaq Dhamo vazhdon ta ndjek me shumë vëmendje ecurinë e kinematografisë shqiptare dhe i vjen keq për tërë ata kineastë të talentuar që nuk po mundin dot t'i shprehin aftësitë e tyre për mungesë fondesh financiare! Ndërkaq, jeton me dhimbje përçapjet e disa intelektualëve, mjerisht edhe deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, që shprehen kundër tërë atij prodhimi filmik të para vitit 1990, që, në fund të fundit, mbante vulën e kohës.



Brodsky: "Pjesa më e rrezikshme e trupit, tregoni kujdes…"

Në tërësi, përpiquni ta respektoni jetën jo vetëm për bukuritë por edhe për vështirësitë e saj. Ato janë pjesë e lojës dhe ajo që është e mirë për një vështirësi është se nuk është mashtrim

Me çdo kusht përpiquni t'ia kurseni vetes statusin e viktimës. Nga të gjitha pjesët e trupit tuaj, jini më vigjilent ndaj gishtit tuaj tregues, sepse është i etur për të fajësuar të tjerët. Një gisht i drejtuar është logoja e viktimës. Pa marrë parasysh se sa e vështirë mund të jetë gjendja juaj, mos fajëso asgjë dhe asnjë: as historinë, as shtetin, as eprorët, racën, prindërit, fazat e hënës, fëmijërinë, trajnimin etj. Menuja është e gjatë dhe e lodhshme.

Momentin që e vendosni fajin diku, ju e minoni vendosmërinë tuaj për të ndryshuar ndonjë gjë. Në fund të fundit, viktimizimi i vetes na josh me ëmbëlsinë e tij. Ky rol imponon dhembshuri, ju dallon nga fatet e tjera, madje kombet dhe kontinente të tëra përqendrohen te vërshimet e gjendjeve mendore të shpallura si ndërgjegje e viktimës.

Natyrisht, kjo është terapeutike dhe, duke pasur parasysh kufizimin e burimeve, ndoshta edhe për të përmbushur nevojat bazike jetësore, kështu që për mungesën e një identiteti më të mirë, mund edhe ta përqafosh – por përpiqu dhe bëj çmos ta kundërshtosh atë.

Sadoqë të jetë i mjaftueshëm dhe i pakundërshtueshëm fakti se mund të gjendeni në anën e përmbysur të fatit, mohojeni komoditetin e rolit të viktimës për sa kohë që keni respekt për veten, për sa kohë që buzët tuaja mund të shprehin "Jo".

Në tërësi, përpiquni ta respektoni jetën jo vetëm për bukuritë por edhe për vështirësitë e saj. Ato janë pjesë e lojës dhe ajo që është e mirë për një vështirësi është se nuk është mashtrim. Sa herë që jeni në vështirësi, në ndonjë hall, në prag të dëshpërimit ose në dëshpërim, mbani mend: kjo është jeta që flet me ju në gjuhën e vetme që njeh mirë.Përpiquni të mbani mend se dinjiteti njerëzor është një nocion i përplotshëm, jo i pjesëzuar, që nuk aplikohet vetëm në disa raste të veçanta të posaçme. Nëse ju e gjeni këtë argumentim paksa në anën e gabuar, mendoni të paktën se duke e konsideruar veten një viktimë ju e zmadhoni boshllëkun e papërgjegjshmërisë brenda vetes që demonët ose demagogët e duan kaq shumë për ta mbushur, meqë një vullnet me paterica nuk është i denjë për engjëjt.

Ndeshja me Pobedën për ne është shumë e rëndësishme. Duhet të japim maksimumin dhe tre pikët të mbeten në Çair. Me ndihmën e 'Shvercerave' do ta kemi më lehtë, ndërsa me fitoren eventuale do të hyjmë më të relaksuar në ndeshjet e mbetur

Liga e parë, xhiroja e 12

Akademia Pandev sfidon Shkëndijën

E mërkura në sportin vendor është rezervuar për ndeshjet e javës së 12-të në Ligën e parë futbollistike të Maqedonisë. Në program do të jenë gjithsejtë pesë ndeshje, mes tyre tre derbi, ajo në Strumicë mes Akademia Pandev e Shkëndijës, derbi lokal mes Rabotniçkit dhe Vardarit si dhe ai në Çair mes Shkupit dhe Pobedës

Koha Bujar KURTAJ

DYSHET:
A.Pandev – Shkëndija
Pelisteri – Sileksi
Rabotniçki – Vardari
Renova – Skopje
Shkupi – Pobeda

Shkup, 24 tetor – Skuadra e Shkëndijës, e cila deri më tani po dominon në futbollin vendor, do të rikthehet të luajë në stadiumin "Mlladost" në Strumicë, stadiumin ku në verë i zhvillonte si nikoqir ndeshjet e Liga Evropës. Por, kësaj radhe kuqezinjtë do të përballen me skuadrën e Akademia Pandev, skuadër e cila është befasia më e madhe në 11-të xhirot e para. Skuadra nga Strumica me 18-të pikë të grumbulluara mban pozitën e tretë në renditjen tabelore dhe në bazë të paraqitjeve të deritanishme, djemtë e trajnerit Qatip Osmani nuk do ta kenë lehtë të vijnë deri te fitorja edhe pse realisht roli i favoritit u takon atyre. Në Strumicë kuqezinjtë janë nga dita e djeshme ku kanë qëndruar në karantinë për tu përgatitur sa më mirë për këtë ndeshje dhe njëkohësisht të vazhdohet ecuria pozitive drejt titullit të dytë në historinë e saj. Nga radhët e ekipit kuqezi pohojnë se në Strumicë kanë shkuar si në çdo ndeshje tjetër, me qëllim që të dalin fitues. Kështu mendon edhe mbrojtësi i talentuar Egzon Bejtullai. "Jemi kthyer të dielën në rrugën e fitores dhe tani skuadra ka nevojë për vazhdimësi. Pas triumfit me Shkupin kemi punuar në rikuperim dhe mendoj se të gatshëm do të hyjmë kundër Akademia Pandevit. Bëhet fjalë për skuadër cilësore, debutuese në Ligën e Parë por që me paraqitjet e deritashme dëshmon se ka ambicie të larta. Ne shkojmë si në çdo ndeshje tjetër, me respekt për kundërshtarin, por edhe me besim në cilësinë tonë. Do të dalim për të dhënë më të mirën dhe besoj se me një tjetër paraqitje pozitive të dalim me tre pikë nga kjo përballje", deklaroi për gazetën KOHA, Egzon Bejtullai. Shkupi do të kërkojë fitoren ndaj Pobedës, e cila të dielën bëri befasinë më të madhe duke e mundur kampionin aktual Vardarin me 1-0. Për bardhekaltërit kjo përballje konsiderohet shumë e rëndësishme, andaj djemtë e trajnerit Ardian Nuhiu, pritet të japin maksimumin që tre pikët të ngelin në Çair. Pos, Mbellas i cili u ndëshkua me të kuq në përballjen e fundit me Akademia Pandev, trajneri Nuhiu në dispozicion do ti ketë të gjithë futbollistët tjerë. "Ndeshja me Pobedën për ne është shumë e rëndësishme. Duhet të japim maksimumin dhe tre pikët të mbeten në Çair. Me ndihmën e 'Shvercerave' do ta kemi më lehtë, ndërsa me fitoren eventuale do të hyjmë më të relaksuar në ndeshjet e mbetur. Caku jonë dihet dhe ai është që të jemi sa më lartë kreut të tabelës", deklaroi Edis Maliqi, njëri prej futbollistëve më të mirë të Shkupit.

Pas disfatës së papritur nga Pobeda, Vardarin e pret edhe një përballje e vështirë, ajo me Rabotniçkin."Romantikët" këtë sezon nuk po luajnë mirë dhe aktualisht gjenden në pozitën e parafundit me vetëm 10-të pikë. Por, fitorja e fundit ndaj Pelisterit u ka dhënë krah dhe vetëbesim atyre që edhe ndaj Vardarit të arrijnë një rezultat pozitiv. Në anën tjetër, futbollistët e Vardarit edhe pse kanë dy ndeshje më pak, nuk duhet t'i lejojnë vetes edhe një kiks, pasi që me një fitore eventuale të Shkëndijës, epërsia do të thellohej më shumë dhe gara për mbrojtjen e titullit do të behet akoma më e vështirë. Ndërkohë, të gjitha ndeshjet e javës së 12-të në LPFM-së do të fillojnë në ora 14.30.

Mateus, trajner i ri i Kosovës?

Duket se Përfaqësuesja e Kosovës do të udhëhiqet nga një trajner i njohur. Në fakt, kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokrri, është takuar mbrëmë në gala mbrëmjen e zgjedhjes së futbollistit të vitit me legjendën e futbollit gjerman, Lotar Mateus, i cili mund të jetë pasardhës i Albert Bunjakit, i cili u largua nga përfaqësuesja e Kosovës pas eliminatoreve për Botërorin "Rusia 2018" Mateus e udhëhoqi si kapiten Gjermaninë Perëndimore drejt triumfit në Kupën e Botës në vitin 1990, dhe u shpall lojtari i vitit në Evropë po atë vit. Në vitin 1991, ai u bë lojtar i parë ndonjëherë që fiton çmimin lojtari i vitit i FIFA-s. Si lojtar, ai ka luajtur për ekipe të mëdha evropiane si Bajern Munih dhe Inter. Ndërsa si trajner, ai ka drejtuar ekipe kombëtare si Hungaria (2004-06) dhe Bullgaria (2010-11). Ai i ka drejtuar edhe skuadrat si Rapid Vien, Partizan Beograd, Red Bull Salzburg e të tjera.

Batha dëshirën rikthimin e Cuculit te Partizani

Skuadra e Partizanit nga Tirana vijon përgatitjet për ndeshjen e radhës me Flamurtarin, takim i cili do të zhvillohet ,ë 29 tetor dhe në të cilin trajner Mark Juliano do të ketë në dispozicion edhe mbrojtësin Gëzim Krasniqi, i cili u ndëshkua me Luftëtarin me karton të kuq dhe mungoi në Shkodër. Të gatshëm do të jenë edhe Malota e Kalari, që dolën me probleme nga loja në sfidën me Vllazninë. Asgjë serioze për ta dhe stafi teknik mund t'i llogarisë për ndeshjen me vlonjatët. Ndërkohë, kapiteni Batha, në një lidhje direkte me emisionin "Zona Gol" në Supersport" ka treguar edhe dëshirën e merkatos: "Cuculi do të na bënte shumë punë. Ai është lojtar shumë i mirë dhe përshtatet në çdo pozicion që

luan. Do të na ndihmonte", ka thënë mes të tjerash Batha. Cekim, Ardian Cuculi edhe në të kaluarën ka qenë pjesë e Partizanit, derisa aktualisht mbron ngjyrat e KF Shkëndija nga Tetova.

Publicitet

Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopishtes

Tel. ++389 2 27 85 100
Faks. ++389 2 27 85 109
Rr. 2, nr. 2, f. Sopishte, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk
gradonacalnik@opstinasopiste.gov.mk

nr. 28-52/17 e datës 20.10.2017

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës publike dhe prezantimit publik në lidhje me **PAU për formimin e parcelës ndërtimore PK 1274 dhe pjesë të PK 1272 dhe 1273, në Bllokun 2 të SPU Sopishte, KK Sopishte-jnd Komuna e Sopishtes, me qëllim E2 – superstrukturë komunale – central fotovoltaik deri në 1 mV, me sipërfaqe prej 0.77 ha, sipas Certifikatës nga SPU.**
Realizohet prezantim publik dhe anketë publike për **PAU për formimin e parcelës ndërtimore PK 1274 dhe pjesë të PK 1272 dhe 1273, në Bllokun 2 të SPU Sopishte, KK Sopishte-jnd Komuna e Sopishtes, me qëllim E2 – superstrukturë komunale – central fotovoltaik deri në 1 mV, me sipërfaqe prej 0.77 ha, sipas Certifikatës nga SPU.**
Përfshirja planore e dokumentit **PAU për formimin e parcelës ndërtimore PK 1274 dhe pjesë të PK 1272 dhe 1273, në Bllokun 2 të SPU Sopishte, KK Sopishte-jnd Komuna e Sopishtes, me qëllim E2 – superstrukturë komunale – central fotovoltaik deri në 1 mV, me sipërfaqe prej 0.77 ha, sipas Certifikatës nga SPU** është me sipërfaqe prej 7712 m2.

1. Prezantimi publik dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës Sopishte më datë **30.10.2017** në ora **11.00.**
2. Anketa publike do të zgjasë deri më **07.11.2017**, në bazë të nenit 51 paragrafi 10 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15 dhe 31/16).
3. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni përkatës të përfshirë në plan në afatin e lartpërmendur të parashtrojnë vërejtje, propozime dhe mendime në listat anketuese në administratën komunale.
4. Informacione në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës së Sopishtes
Stefçe Trpkovski

Publicitet

Institucioni nacional
Qendra për kulturë "Grigor Përlliçev" – Ohër
Rr "Makedonski Prosvetiteli" 4 F. P 94 tel/faks: 046 261 063

Në pajtim me nenin 9 paragrafi (1), (2), (3) dhe (5) të Statutit të IN Qendra për kulturë "Grigor Përlliçev" – Ohër (nr. 01-396/1) shpallet

KONKURS
PËR ZGJEDHJE TË POEMËS MË TË MIRË "GRIGOR PËRLIÇEV" PËR VITIN 2017

Konkursi për zgjedhje të poemës përkatëse zgjatë deri më 25 nëntor 2017. Përmbajtja tematike e poemës me të cilën konkurrohet është e karakterit të lirë, por nuk duhet të jetë më e vogël se 912 vargje. Konkursi është anonim, ndërsa për poemën më të mirë është paraparë edhe çmim në të holla.

Për zgjedhjen gjegjësisht çmimin vendosë komisioni tre anëtarësh i përbërë nga autorë me renome nga rajoni i Komunës së Ohrit dhe Republikës së Maqedonisë. Ftohen të gjithë autorët e interesuar që të dërgojnë poemë të papublikuar në katër kopje të shifruara në adresën në vijim: IN Qendra për kulturë "Grigor Përlliçev" – Ohër, rr. "Makedonski prosvetiteli" nr. 4, 6000 Ohër,. Me shenjë "Paraqitje për zgjedhje të poemës më të mirë 'Grigor Përlliçev' për vitin 2017". Komisioni në pajtim me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje të poemës më të mirë, do të informojë autorët që kanë parashtruar aplikacion të rregullt për rezultatet e zgjedhjes, më së voni deri më 25 dhjetor 2017.

Për informacione plotësuese na kontaktoni në:
tel. 046/ 261 - 063
centarzakultura_ohrid@yahoo.com

IN Qendra për kulturë "Grigor Përlliçev" – Ohër,
Drejtor,
u.d Strezo Stamatoski

S H P A L L J E

Shitet tokë në Shkup,e cila gjendet në PK 4397, Vendi quajtur BUTELSKI LOZJA, kultura ZZ-PS, klasa 3, me sipërfaqe prej 8663 m2 E regjistruar në Fletë Pronësi nr. 102139 për KK Radishani, me pronësinë e Amedi Afrim:
Të interesuarit dhe të gjithë ata që kufizohen me parcelën në fjalë, ofertat mund ti paraqesin në zyrën e Noterit Naser Zyberit, rr. Xhon Kenedi nr. 9A, Shkup.

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), nenit 54 të Ligjit për standardin e nxënësit ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 52/05, 117/08, 17/11, 135/11, 15/13, 41/14, 146/15 dhe 30/16) dhe Vendimit për publikim të konkursit për ndarje të 400 (katërqind) bursave për ndihmë sociale për nxënësit nga shkollat publike dhe private të mesme në Republikën e Maqedonisë për vitin shkollor 2017/2018, Ministria e arsimit dhe shkencës shpall

KONKURS

Për ndarje të 400 (katërqind) bursave për ndihmë sociale për nxënës nga shkollat publike dhe private të mesme në Republikën e Maqedonisë për vitin shkollor 2017/2018

Ministria e Arsimit dhe Shkencës për vitin shkollor 2017/2018 do të ndajë 400 (katërqind) bursa për ndihmë sociale për nxënës nga shkollat publike dhe private të mesme në Republikën e Maqedonisë

KUSHTET PËR NDARJE TË BURSAVE

Të drejtë bursës kanë kandidatët që mësojnë në shkollat publike dhe private të mesme në Republikën e Maqedonisë dhe i plotësojnë kushtet në vijim:

1. të jenë nxënës të rregullt të vitit të I, të cilët gjatë arsimit fillor kanë arritur sukses të vazhdueshëm prej së paku 4,00;
2. të jenë nxënës të rregullt të vitit të II, III dhe IV, të cilët gjatë arsimit të mesëm të kenë arritur sukses të vazhdueshëm prej së paku 4,00;
3. të mos kenë përsëritur vit gjatë arsimit;
4. të mos jenë shfrytëzues të bursës nga institucione apo firma të tjera;
5. të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë.

Kriteret për ndarje të bursave janë:

- suksesi i realizuar,
- gjendja materiale e familjes më të ngushtë të nxënësit,
- çmim të fituar në garat ndërkombëtare/vendore të fituara gjatë dy viteve shkollore të kaluara për nxënësit e vitit të parë, gjegjësisht gjatë vitit të kaluar për nxënësit e vitit të II, III dhe IV dhe
- gjendja sociale e familjes më të ngushtë të nxënësit.

Një nxënës mund të fitojë më së shumti 100 pikë edhe atë: për suksesin e realizuar gjatë shkollimit mund të fitohet më së shumti deri në 25 pikë, nga çmimet e fituara më së shumti deri në 10 pikë, për të hyrat e realizuara (mujore dhe vjetore) nga anëtarët e familjes më të ngushtë më së shumti deri në 60 pikë dhe nga 5 pikë fitojnë nxënësit – fëmijë të prindërve kryefamiljar, nxënës të shfrytëzuesve të ndihmës sociale dhe nxënës të shfrytëzuesve të kompensimit në bazë të tepricës teknologjike tek të cilët të hyrat e përgjithshme në familje janë deri në neto pagesën minimale të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë.

Për çmimet e fituara në nivel shtetëror do të pranohen vetëm çmimet e ndara nga shoqatat e akredituara të mësimdhënësve nga ana e Ministrisë së arsimit dhe shkencës të cilët organizojnë gara për nxënësit.

Me garë ndërkombëtare nënkuptohet garë mes nxënësve prej së paku dhjetë shteteve të ndryshme.

II. MËNYRA DHE AFATI I PARAQITJES

Nxënësit të cilët paraqiten në konkurs, duhet të plotësojnë fletëparaqitjen elektronike të vendosur në internet portalin http:// konkursi.mon.gov.mk, duke filluar prej 25.10.2017 deri më 5.11.2017.

Para fillimit të paraqitjes elektronike, është e domosdoshme të kompletoni të gjitha dokumentet e nevojshme nga pika III e këtij Konkursi.

Rang lista me kandidatët e zgjedhur do të publikohet më 01.12.2017 në internet portalin http:// konkursi.mon.gov.mk.

III. VENDI DHE AFATI I DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Nxënësit të cilët janë paraqitur në mënyrë elektronike gjatë konkursit, është e nevojshme në Ministrinë e arsimit dhe shkencës në rr. "Kiril i Metodi" nr. 54 – Shkup, në periudhën e njëjtë prej datës 25.10.2017 – 5.11.2017 prej ora 09 deri në ora 15, ti sjellin dokumentet në vijim:

1. Listë evidentuese;
2. Vërtetim se është nxënës i rregullt në vitin shkollor 2017/2018;
3. Numër identifikimi të fletëparaqitjes së plotësuar me rregull elektronike;
4. Kopje të vërtetuara në noter të dëftesave për vitet e kaluara të mbaruara të arsimit (kandidatët e vitit të I dorëzojnë kopje të dëftesave prej klasës së VI deri të klasës së IX);
5. Diploma origjinale për vërtetim dhe kopje të vulosura në noter për çmimet e fituara në garat vendore dhe/ose ndërkombëtare;
6. Vërtetim për neto rrogën e realizuar të të punësuarve në familje për muajin shtator 2015 ose përderisa për këtë muaj nuk është paguar rrogë të dorëzohet vërtetim për rrogën e fundit të paguar (për prindërit-kujdestarët të punësuar në institucione shtetërore dhe publike të dorëzohet vërtetim për rrogë të vërtetuar nga organi përgjegjës, ndërsa për prindërit-kujdestarët të punësuar në firma private të dorëzohet vërtetim për rrogë si dhe deklaracion për pranim të rrogës); për anëtarët e pensionuar të familjes të dorëzojë dokument për shumën e pensionit; për prindërit e shkurorëzuar të dorëzohet dëshmi për shkurorëzim dhe nëse kandidati pranon alimentacion të njëjtën ta tregojë si të hyrë mujore, për shfrytëzuesit e ndihmës sociale të dorëzojnë vërtetim të fundit ose çekun e fundit, për invaliditet të dorëzojë vërtetim të mjekut, ndërsa për vëllezërit/motrat e kandidatit, të cilët janë nxënës/studentë, dorëzohet vërtetim nga shkolla, gjegjësisht nga fakulteti ose institucion tjetër;
7. Deklaratë të nënshkruar nga prindi ose kujdestari se kandidatit nuk është shfrytëzues i bursave ose kredive të tjera, të publikuar në internet në portalin http:// konkursi.mon.gov.mk;
8. Deklaratë të nënshkruar nga prindi – kujdestari se dokumentet e dorëzuara janë të vërteta dhe të dhënat në atë janë identike me të dhënat të futura në fletëparaqitjen elektronike të publikuar në internet portalin http:// konkursi.mon.gov.mk;
9. Deklaratë të nënshkruar nga prindi – kujdestari për përpunimin e të dhënave personale të kandidatit dhe familjen e tij të ngushtë (prindër-kujdestar, vëllezër, motra), me të cilën pajtohet Ministria e arsimit dhe shkencës me detyrë zyrtare të sigurojë dokumentet e nevojshme nga institucionet publike me të cilët ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, të publikuar në internet portalin http:// konkursi.mon.gov.mk;

Ministria e arsimit dhe shkencës zyrtarisht, në pajtim formularin e kërkesës për vendosje në shtëpi për nxënës dhe formularin e kërkesës për ndarje të bursës me dokumentacion të nevojshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 189/16), do të sigurojë dokumentet në vijim:

- Certifikatë nga Drejtoria e të Hyrave Publike, për të hyrat e realizuara vjetore në baza të ndryshme për vitin paraprak (të hyra nga veprimtari të pavarura, të hyra për veprimtari bujqësore, të hyra nga prona dhe e drejta pronësore, të hyra nga kapitali, fitime kapitale, fitime nga lojërat e fatit dhe lojërat e tjera shpërblyese, dhe të hyra të tjera) për të dy prindërit – kujdestarët e kandidatit;
- vërtetim se janë të papunë ose pranojnë/nuk pranojnë kompensim në të holla anëtarët e papunë të familjes më të ngushtë nga Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë;

-certifikatë të lindjes për vëllezërit/motrat nën moshën 6 vjeçare, si dhe certifikatë të vdekjes për prindërit e vdekur nga Drejtoria e librave të amzës;

-certifikatë të shtetësisë të Republikës së Maqedonisë nga Ministria e punëve të brendshme.

Kandidatët nuk do të rangohen nëse dokumentacioni i dorëzuar është:

-i pakompletuar dhe/ose

-i dorëzuar pas afatit.

Çmimet-diplomat ku nuk ka vend të zënë të specifikuar në garat shtetërore ose ndërkombëtare, gjegjësisht çmime dhe mirënjohje për pjesëmarrje në gara pa vend të zënë, çmimet-diplomat që nuk janë fituar në dy vitet e kaluara shkollore për nxënësit e vitit të I ose nga viti i kaluar shkollor për nxënësit e vitit të II, III dhe IV nuk do të merren parasysh.

Me parashtrimin e dokumenteve të kërkuara kandidatëve u rekomandohet të parashtrojnë edhe kopje të llogarisë së transaksionit në të cilën do të mund ti marrin paratë në rast se fitojnë bursën.

IV. SHUMA E BURSËS

Shuma e bursës do të arrijë 2.200,00 denarë në muaj për nëntë muaj gjatë vitit shkollor.

Nxënësit që do të fitojnë bursë do të lidhin marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës me çka do të rregullohen të drejtat dhe obligimet.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTËR
Renata Deskoska

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), nenit 54 të Ligjit për standardin e nxënësit ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 52/05, 117/08, 17/11, 135/11, 15/13, 41/14, 146/15 dhe 30/16) dhe Vendimit për publikim të Konkursit për ndarje të 50 (pesëdhjetë) bursave për nxënësit me nevojat e posaçme nga shkollat e mesme shtetërore dhe private në Republikën e Maqedonisë për vitin shkollor 2017/2018, Ministria e arsimit dhe shkencës shpall

KONKURS

Për ndarje të 50 (pesëdhjetë) bursave për nxënësit me nevoja të posaçme në shkollat e mesme shtetërore dhe private në Republikën e Maqedonisë për vitin shkollor 2017/2018

Ministria e arsimit dhe shkencës për vitin shkollor 2017/2018 do të ndajë 50 (pesëdhjetë) bursa për nxënësit me nevoja të posaçme nga shkollat e mesme shtetërore dhe private në Republikën e Maqedonisë.

I. KUSHTET PËR NDARJE TË BURSËS

Të drejtë për bursë kanë kandidatët të cilët mësojnë në shkollat e mesme shtetërore dhe private në Republikën e Maqedonisë, ndërsa i plotësojnë kushtet në vijim:

1. të jenë nxënës të rregullt nga viti i I, të cilët gjatë arsimit fillor kanë arritur sukses me mesatare së paku 3,00;
2. të jenë nxënës të rregullt në vitin e II, III dhe IV, të cilët gjatë arsimit të mesëm kanë arritur sukses me mesatare prej së paku 3,00;
3. të kenë diagnozë dhe mendim për llojin dhe shkallën e pengesës së zhvillimit fizik ose psikik dhe nevojat specifike të dhënë nga institucioni kompetent, ndërsa në pajtim me Rregulloren për vlerësimin e nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik dhe psikik;
4. të mos kenë përsëritur vitin gjatë arsimit;
5. të mos jenë shfrytëzues të bursave nga institucione ose firma të tjera;
6. të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë.

Kriteret për ndarjen e bursave janë suksesi i realizuar, gjatë së cilës një nxënës mund të merr më së shumti 100 pikë.

II. MËNYRA, VENDI DHE AFATI I DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Nxënësit të cilët paraqiten në konkurs, është e nevojshme që në Ministrinë e arsimit dhe shkencës, rr. Sv. Kiril i Metodi nr. 54 – Shkup, prej datës 25.10.2017 - 5.11.2017, prej ora 09 deri në ora 15, të dorëzojnë dokumentet në vijim:

1. Listë evidentuese;
2. Vërtetim se është nxënës i rregullt në vitin shkollor 2017/2018;
3. Kopje të dëftesave për vitet e kaluara të mbaruara të arsimit (kandidatët e vitit të I dorëzojnë dëftesat prej klasës VI-IX);
4. të kenë diagnozë dhe mendim për llojin dhe shkallën e pengesës së zhvillimit fizik ose psikik dhe nevojat specifike të dhënë nga institucioni kompetent, ndërsa në pajtim me Rregulloren për vlerësimin e nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik dhe psikik;
5. Deklaratë të nënshkruar nga prindi ose kujdestari se kandidatit nuk është shfrytëzues i bursave ose kredive të tjera, të publikuar në internet në portalin http:// konkursi.mon.gov.mk;
6. Deklaratë të nënshkruar nga prindi-kujdestari për përpunim të të dhënave personale të kandidatit dhe familjes së tij më të ngushtë (prindër, kujdestar, vëllezër, motra), me të cilën pajtohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës përmes detyrës zyrtare të sigurojë dokumentet e nevojshme nga institucionet publike me të cilët ka lidhur marrëveshje për bashkëpunim, të publikuar në internet portalin http://konkursi.mon.gov.mk

Lista me kandidatët e zgjedhur do të publikohet më 01.12.2017 në internet portalin http://konkursi.mon.gov.mk.

Ministria e arsimit dhe shkencës zyrtarisht, në pajtim me Rregulloren për formularin e kërkesës për vendosje në shtëpi të nxënësve dhe formularin e kërkesës për dhënie të bursave me dokumentacion të nevojshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 189/16), do të sigurojë dokumentet në vijim:

-certifikatë të shtetësisë të Republikës së Maqedonisë nga Ministria e punëve të brendshme.

Kandidatët nuk do të rangohen nëse dokumentacioni i dorëzuar është:

-i pakompletuar dhe/ose

-i dorëzuar pas afatit.

IV. SHUMA E BURSËS

Shuma e bursës do të arrijë 2.750,00 denarë në muaj për nëntë muaj gjatë vitit shkollor.

Nxënësit që do të fitojnë bursë do të lidhin marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës me çka do të rregullohen të drejtat dhe obligimet.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTËR
Renata Deskoska

Për momentin gjithçka po shkon mirë, jemi të parët dhe po punojmë çdo ditë për objektivat tona. Kavani e Nejmar janë lojtarë të mëdhenj, e kanë treguar tashmë, por nuk jemi ne ata që duhet të themi se jemi më të mirët

Pesë skuadra plot klasë

Kreu i Serisë A, më i ekuilibruar së kurrë

Që kur në rregulloren e futbollit u vendos që fitorja të vlerësohej me tre pikë, kurrë nuk ka pasur kaq shumë ekuilibër mes skuadrave më të mira të futbollit italian. Së bashku kanë grumbulluar plot 110 pikë në vetëm nëntë javë

Napoli, Inter, Juventus, Lazio dhe Roma. Janë këto pesë skuadrat kryesuese të Serisë A, me vendin e parë dhe të pestë që ndahen me vetëm shtatë pikë. Që kur në rregulloren e futbollit u vendos që fitorja të vlerësohej me tre pikë, kurrë nuk ka pasur kaq shumë ekuilibër mes skuadrave më të mira të futbollit italian. Së bashku kanë grumbulluar plot 110 pikë në vetëm nëntë javë.

Napoli i Sarrit është skuadra më e bukur, me lojë më të pasur dhe shumë pranë perfeksionit teknik. Një rritje progresive e cilësisë së lojës që kur ekipin e drejton Maurizio Sarri. Mirëpo deri tani nuk ka mjaftuar për të mposhtur Juventusin në rivalitetin për titullin kampion.

Futbolli i Interit nuk është futbolli i Spaletit. Të gjitha skuadrat që ka drejtuar më parë, Empoli, Udinese, Zeniti dhe Roma luanin më mirë se Interi i sotëm. Më një skuadër që ka në përbërje lojtarë me të dhëna të ndryshme, Spaletti po ndjek një linjë tjetër. Nuk dihet nëse Interi do t'ia dalë gjatë këtij sezoni të rrisë nivelin teknik të skuadrës.

Shifrat tregojnë se kemi një Juventusi tranzitor. Është paksa e çuditshme që në një skuadër, ku luajnë Dybala, Higuain, Manxhukiç, por edhe Daglas Kosta, Kuadrado dhe Bernardeski, ai që realizon tre gola në një ndeshje është mesfushori Khedira. Juventusi ka pasur mbrojtjen më të mirë në Itali, por në këtë sezon në 13 ndeshje zyrtare vetëm 5 prej tyre i ka mbyllur pa pësuar. Në total ka marrë 16 gola. Por njëkohësisht ka shënuar shumë, plot 33 herë, 27 vetëm në kampionat.

Lacio është thjeshtë e mrekullueshme në këtë fillim sezoni. Kur e rrit ritmin, me atë mesfushë të jashtëzakonshme që ka, kalon çdo pengesë që i del përpara. Është një skuadër entuziaste, zbulimi i vërtetë i këtij sezoni, jo vetëm për rezultatet që ka arritur, por edhe për lojën që zhvillon.

Di Françesko ka ditur ta kapërcejë skepticizmin që ekzistonte për të kur mori drejtimin e Romës. Ka një dhunti për të ndërtuar një skuadër, mbi të gjitha, me ekuilibër. Ançeloti thotë se është një trajner i mirë, por nuk duhet të qëndrojë një hap pas apo një hap para ekipit. Thjesht duhet ta shoqërojë. Në janar pret përforcime të rëndësishme, për t'i dhënë më shumë forcë një grupi të ekuilibruar.

Ançeloti do të punojë në një kontinent tjetër

Karlo Ançeloti vështirë se do të rikthehet në Angli, aty ku është spekuluar së fundmi. Destinacioni i tij i ardhshëm duket se do të jetë Superliga kineze. Sipas mediave aziatike, italiani është shumë pranë klubit Guangzhou Evergrande dhe nuk do ta mbajë fjalën për dhjetë muajt pushim që kishte paralajmëruar pas largimit nga Bajern Munih. Lajmi specifikisht vjen nga "Nanfang Daily", ku shkruhet se 3-herë fituesi i Ligës së Kampionëve po përgatitet për lëvizjen e tij të radhës te pasanikët. Mund të merret parasysh që paga e majme e ka joshur trajnerin. Ai tashmë është në vitet e fundit të karrierës, sepse është 58 vjeç. Edhe vetë "mentori" i tij, Arrigo Saki, para disa javësh u shpreh se me kalimin e viteve pasioni ikën dhe është e vështirë të punosh me ritëm të lartë. Ai e kishte fjalën pikërisht për Don Karlon. Duke marrë parasysh këtë, ndoshta trajneri po e mendon aventurën kineze si të fundit në karrierën e tij dhe si një investim për vitet e pleqërisë.

Giggs mes Evertonit dhe Leiçesterit

Legjenda e Mançester Junajtedit dhe e Kombëtares së Uellsit, Rajan Giggs, është gati të marrë drejtimit Leiçester Sitit ose të Evertonit, dy skuadra që brenda pak ditësh kanë shkarkuar trajnerët respektive, Kraig Shakspir dhe Ronald Kuman.

Giggs ka qenë ndihmës Luis van Gal, kur holandezi drejtonte "Djajtë e Kuq". "Jam i interesuar për t'i drejtuar këto dy klube.

Gjithmonë e kam thënë se jam i hapur për të biseduar me skuadra që kanë projekt serioz. Gjithsesi, ka shumë trajnerë të mirë në qarkullim që mund të emërohen në këtë detyrë", deklaroi Giggs. 43-vjeçari nuk ka qenë pjesë e një klubi të madh që kur mbylli karrierën 29-vjeçare në radhët e Mançester Junajtedit. Uellsiani preferoi të bënte një vit pushim, por gjithmonë ka qenë i interesuar për të vijuar karrierën si trajner në një skuadër ambicioze.

Publicitet

REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA DOGANORE

01.10.00.PA.001.03-OB.13.03

Në bazë të nenit 50 paragrafi 2 të Ligjit doganor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr 39/05, 04/08, 48/10, 158/10, 44/11, 53/11, 11/12, 171/12, 187/13, 15/15, 129/15, 154/15, 192/15 dhe 23/16), nenit 148 të Urdhëresës për zbatimin e Ligjit doganor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 66/05, 73/06, 40/07, 62/07, 42/09, 48/09, 38/10, 46/10, 61/10, 141/11, 147/11, 158/11, 14/12, 2/13, 92/13, 177/13, 62/15, 111/15, 215/15, 192/16 dhe 21/17) dhe pikës 8 të Udhëzimit të Drejtorisë doganore për kushtet minimale dhe mënyrën e përcaktimit të hapësirës punuese ku malli i automjeteve transportuese vihet në shikim dhe bëhet kontrolli nga ana e organeve doganore nr. 01-013669/15-0002 datë 10.03.2015.

DREJTORIA DOGANORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
Shpall
THIRRJE PUBLIKE Nr.1/17
Për mbledhjen e ofertave për të lidhur kontratë për shfrytëzimin e hapësirës punuese për organin doganor:

1. Njësia doganore Ohër (për hapësirën e dedikuar për import dhe eksport – terminal).
Dokumentet të cilat ofertuesi duhet t'i dorëzoj dhe kushtet që duhet t'i plotësoj, si dhe mënyra e përzgjedhjes janë dhënë në Udhëzimin për kushtet minimale dhe mënyrën e përcaktimit të hapësirës punuese ku malli i automjeteve transportuese vihet në shikim dhe bëhet kontrolli nga ana e organeve doganore nr. 01-013669/15-0002 datë 10.03.2015 i publikuar në faqen e internetit të Drejtorisë doganore www.customs.gov.mk – Thirrje publike numër 1, nga ku edhe mund të merret.
Afati për dorëzimin e ofertave është 14 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike në mjetet e informimit publik.
Ofertat të cilat nuk do të dorëzohen në afatin e paraparë, si dhe ato të cilat nuk do t'i përmbajnë të gjitha dokumentet e nevojshme nuk do të merren në shqyrtim.
Ofertat dorëzohen në këtë adresë:
Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë
Sektori për punë administrative dhe teknike
(me shënimin "për Thirrjen publike nr. 1/17")
Rr. Llazar Liçenovski nr.13
1000 Shkup

Shkurt

Gomez larg Milanit

E ardhmja e Gustavo Gomez parashikohet të jetë larg Milanit, pavarësisht se kontrata e mbrojtësit skadon në vitin 2021. 24-vjeçari nuk bën pjesë në planet e trajnerit Montella dhe emri i tij është i pari në listën e largimeve gjatë merkatos së Janarit. Sipas mediave italiane, për paraguaianin nuk mungojnë ofertat dhe me shumë mundësi e ardhmja e tij do të jetë në Turqi, pasi skuadra e Fenerbaçes ka kohë që e ndjek futbollistin. Drejtuesit e klubit nga Stambolli gjatë muajit dhjetorit do t'i paraqesin kuqezinjve ofertën e parë për shërbimet e futbollistit.

• • •

Benevento me trajner të ri

Benevento ka vendosur një rekord absolut në Serinë A, duke mos arritur të marrë asnjë pikë, në 9 javët e para të luajtura. Pikërisht për këtë arsye, drejtuesit e klubit kanë vendosur të largojnë nga bankina, trajnerin Marko Baroni, për t'ia besuar stolin një tjetër tekniku. Bëhet fjalë për Roberto De Zerbin, që ka drejtuar për 3 muaj Palermon, vitin e kaluar. Te Benevento luajnë edhe dy futbollistët e kombëtares shqiptare, Mesfushori Ledian Memushaj dhe mbrojtësi, Berat Gjimshiti.

• • •

"Puma" mbush arkën e Milanit

Milani zyrtarizoi fundin e bashkëpunimit me sponsorin teknik "Adidas", me firmën prestigjioze gjermane që siguronte prej 20 vitesh uniformat e kuqezinjve. 19.7 milionë euro ka përfituar Milani nga kjo kontratë afatgjatë, por, duke nisur që nga sezoni i ardhshëm, "Djalli" do të vishet me Puma, për 10-15 milionë euro në sezon. Marrëveshja nuk është bërë ende zyrtare, madje në njoftimin për shtyp në faqen e Milanit thuhet se nga 1 korriku klubi italian do të ketë një sponsor të ri teknik, me detajet që do të zbulohen muajt e ardhshëm. Gjatë 20 viteve të bashkëpunimit me "Adidas", Milani ka arritur suksese të rëndësishme, duke fituar në total 12 trofe: 3 tituj të Serisë A, 2 Çampions, 2 Superkupa të Evropës, 1 Botëror për Klube, 3 Superkupa dhe 1 Kupë të Italisë.

• • •

Kasillas largohet nga Porto

Iker Kasillas do të largohet nga Porto, gjatë afatit kalimtar të janarit. E përditshmja portugeze "A Bola" raporton se portieri spanjoll është i gatshëm të gjejë një skuadër të re. Kasillas është përplasur me trajnerin Sergjo Konseisao i cili e ka lënë jashtë formacionit bazë në dy ndeshjet e fundit. Andaj, çështja do të zgjidhet vetëm me largimin e ish kapitenit të Real Madridit në fillim të vitit 2018.

• • •

Goretzka vazhdon të kërkohet nga Barcelona

Barcelona ka ringjallur interesimin për transferimin e mesfushorit të Shalkes, Leon Goretzka. "Mundo Deportivo" ka njoftuar se një përfaqësues i klubit katalan ishte prezent në ndeshjen kundër Mainzit në Bundesligë për ta ndjekur paraqitjen e tij. Goretzka ka hyrë në vitin e fundit të kontratës në Shalke. Ai kërkohet edhe nga klube të ndryshme evropiane por Barcelona konsiderohet si favorite për blerjen e tij në janar.

Dua të falënderoj të gjithë që më keni votuar. Duhet të përmend edhe Mesin dhe Nejmarin . Tifozët e Real Madridit, ekipin tim, trajnerin dhe presidentin. Ju falënderoj të gjithëve. Jam shumë i lumtur. E vlerësoj këtë çmim dhe jam shumë i lumtur

Duke folur me gazetarët në Londër, Ronaldo fillimisht kërkoi të rrëzonte rivalitetin para se të paraqiste një sfidë afatgjatë ndaj Messit 30-vjeçar, të cilin e përshëndeti përzemërsisht, duke u ulur së bashku me njëri-tjetrin gjatë ceremonisë

Gara me Mesin nuk ka mbaruar, është vetëm fillimi

Kristiano Ronaldo beson se rivaliteti i tij me Lionel Messin ka shumë largësi për të kandiduar, pasi ka fituar çmimin e lojtarit më të mirë të FIFA-s në Londër. Superstari i Real Madridit u nderua në garë, pasi në një votim të trajnerëve ndërkombëtarë, kapitenëve dhe anëtarëve të mediave doli përpara homologut të Barcelonës, Messi, ndërsa braziliani i PSZH siguroi vendin e tretë. Duke përfshirë vitet kur çmimi individual i FIFA-s u bashkua me "Topin e Artë", Ronaldo dhe Messi tani janë cilësuar si lojtarët më të mirë në botë nga trupa globale e drejtimit të futbollit, nga pesë herë secili. Kapiteni i Portugalisë ka dalë në krye në katër nga pesë vitet e fundit, me Messin në vendin e dytë, në çdo rast. Megjithatë, Messi ka qenë në një formë të pasur për klubin dhe kombëtaren e tij gjatë muajve të fundit, duke udhëhequr Barçën në krye të La Liga-s me 11 gola në 9 ndeshje dhe duke i siguruar Argjentinës një vend në finalet e Kupës së Botës 2018 me një "hat-trick" madhështor kundër Ekuadorit. Duke pasur parasysh se ata janë lojtarët kryesorë të të gjitha kohërave për klubet dhe kombëtaret e tyre respektive, të dy liderë në La Liga dhe në historinë e Ligës së Kampionëve, debati rreth asaj se cili është më superior nga Messi dhe Ronaldo, do të ngërthejë tifozët e futbollit për një kohë të ardhshme. Duke folur me gazetarët në Londër, Ronaldo fillimisht kërkoi të rrëzonte rivalitetin para se të paraqiste një sfidë afatgjatë ndaj Messit 30-vjeçar, të cilin e përshëndeti përzemërsisht, duke u ulur së bashku me njëri-tjetrin gjatë ceremonisë. "Unë nuk konkurroj me Leon", – tha KR7. – Ai është një lojtar, i cili është në të njëjtën epokë me mua. E ka fituar pesë herë këtë çmim, sa e kam fituar edhe unë, kështu që gjërat janë ashtu siç janë. Natyrisht, jam i lumtur, sepse, siç thashë më parë, jam në klubin më të mirë në botë. Kam pasur rastin të tregoj se jam në një nivel shumë të lartë gjatë viteve të fundit dhe jam ende fizikisht shumë mirë. Unë jam shumë i qetë, do të shoh se çfarë do të ndodhë nesër, por për momentin duhet të shijoj këtë çast të bukur të jetës sime, sepse kurrë nuk e di se çfarë do të ndodhë më pas". Por, i pyetur nëse Ronaldo kundrejt Messit ka mbaruar si garë, 32-vjeçari shton: "Nuk ka mbaruar akoma, është vetëm fillimi", shtoi më tej Ronaldo. Sa i përket çmimit, portugezi nuk e fshehu gëzimin. "Dua të falënderoj të gjithë që më keni votuar. Duhet të përmend edhe Mesin dhe Nejmarin . Tifozët e Real Madridit, ekipin tim, trajnerin dhe presidentin. Ju falënderoj të gjithëve. Jam shumë i lumtur. E vlerësoj këtë çmim dhe jam shumë i lumtur", përfundoi Kristiano Ronaldo.

E MUND ME MË SHUMË DIFERENCË SE VJET

Portugezi triumfoi në votime kundër Leo Messit, i cili ishte i dyti pas yllit të Real Madridit, si në edicionin e parë të çmimit të FIFA-s. Kristiano Ronaldo fitoi me 43.16 për qind të votave të hedhura nga lojtarët, trajnerët, gazetarët dhe tifozët nga e gjithë bota. Messi mori 19.25 për qind të mbështetjes, ndërsa Nejmar përfundoi i treti me 6.97 për qind të votave. KR7 u kthye për të kapërcyer Messin edhe këtë herë, me një ndryshim më të madh. Në "The Best" të vitit të kaluar, portugezi kishte marrë 34.54 për qind të votave, karshi 26.42 për qind të argjentinasit. Këtë vit, Ronaldo ka qenë edhe më i mirë se rivali i tij i madh për fronin e futbollit botëror.

Nuk e dorëzoj shiritin, Milani zgjedhja e duhur!

"Një nga mbrojtësit qendrorë më imponues dhe teknikisht ndër më të mirët në botë. Aftësitë e tij udhëheqëse e ndihmuan Juventusin të fitonte titullin e gjashtë radhazi në Serinë A", ishte kjo "bileta" e Leonardo Bonuçit në mbrëmjen gala të FIFA-s. Fundjavën që lamë pas në fakt, mbrojtësi italian u ndëshkua me karton të kuq për goditje me bërryl të kundërshtarit, e më pas u pezullua dy ndeshje për atë veprim të cilin këmbëngul se e ka bërë në mënyrë të pavullnetshme. "Gjesti im ishte i pavullnetshëm, po kërkoja thjesht të çlirohesha nga krahu i Rosit. Më vjen shumë keq që e lëndova, e pyeta menjëherë se si ndihej. I kam parë disa herë pamjet e përsëritura dhe e theksoj se nuk ka qenë ndërhyrje e vullnetshme. Më vjen keq që ndodhi kështu, por gjithsesi i kam kërkuar falje Milanit dhe shokëve të skuadrës", u shpreh Bonuçi.

Bonuçi jep një mesazh të drejtpërdrejtë për të gjithë ata që mendojnë se nuk është njeriu i duhur për të marrë përgjegjësitë si kapiteni "kuqezi". "Nuk e kam dorëzuar kurrë shiritin e kapitenit, këtë përgjegjësi e kam marrë që në fillim të sezonit dhe e kam për nder. Kurrë nuk jam penduar që kam zgjedhur Milanin", përfundoi ish-mbrojtësi i Juventusit.

Hejnkes ka sjellë një erë të re te Bajerni

Toni Kroos ka një arsye të madhe për ta ndjekur nga televizioni Bajernin, aty ku ka luajtur për shtatë vite. Në Munih është rikthyer Jupp Hejnkes, një nga dy trajnerët të cilët e kanë ndihmuar më shumë gjatë karrierës së tij. Mesfushori i Real Madridit pati fituar gjithçka në vitin 2013 me 72-vjeçarin në krye të skuadrës bavareze dhe tani sigurisht që ka emocione shtesë kur e sheh sërish në stol. pyetur për

këtë në ceremoninë e çmimeve të FIFA-s për vitin 2017 në Londër, kampioni i botës u shpreh. "Të gjithë e dinë se kam një marrëdhënie të mirë me Jupin dhe natyrisht që besoj se ai do të sjellë një erë të re te Bajern. Në fakt, që tani e ka bërë". Përveç kampionëve të Bundesligës, 27-vjeçari gjerman përmendi edhe klubet angleze dhe Barcelonën si pretendentët kryesorë për të rrëzuar madrilenët nga froni si kampionë Evrope.

Milanin e pret një e ardhme e zymtë

Pas një heshtjeje të gjatë, Silvio BerlusKoni është rikthyer të flasë për Milanin dhe ka ngrirë të gjithë tifozët kuqezi. "E kam ditur që ka disa probleme financiare. Më shqetëson shumë heshtja e z. Li. nëse gjërat vijojnë të shkojnë kaq keq, është e vërtetë që në pranverë skuadrën mund ta marrë përsipër fondi 'Elliot', por problemet financiare nuk zhduken", tha Berluskoni. Ish presidenti i kuqezinjve thekson se nëse kuqezinjtë nuk do t'ia dalin të kualifikohen në Çampions Ligë, atëherë situata ekonomike do të jetë shumë alarmante. "Nëse gjërat do të shkojnë keq dhe nuk do të kualifikohemi në Çampions, atëherë e ardhmja do të jetë e zymtë. Edhe pse skuadrën mund ta marrë fondi 'Elliot', sërish bilancit do t'i shtohet një humbje prej më tepër se 100 milionë eurosh dhe kjo gropë do të kërkojë vite që të mbyllet", tha Berluskoni.

DASHI (20/III-20/IV)

Do t'iu mungojë durimi, stabiliteti dhe vetëkontrolli. Keqkuptimet e vazhdueshme me partnerin mund t'iu dërgojë deri tek aventura e ndaluar. Në aspektin shëndetësor do të jeni mjaft të ndjeshëm, sidomos nëse vuani nga problemet me tretje.

DEMI (21/IV-20/V)

Do të gjendeni për mrekulli në punët që kërkojnë bashkëpunim, por vetëm nëse menjëherë në fillim të jeni të hapur dhe tolerantë. Dashurinë mund t'ua shpall një mik i vjetër apo një bashkëpunëtor. Mos u ngutni me përgjigje.

BINJAKËT (21/V-20/VI)

Mund të mashtroheni pas premtimeve dhe të besoni në tregime të bukura të disa njohësve sipërfaqësor. Më shumë besojini vetës e sa më pak të tjerëve. Mos i përdorni gënjeshtrat për të arritur tek qëllimi; dikush mund t'ua kalojë.

GAFORRJA (21/VI-22/VII)

Emocionet e fuqishme që do t'i përjetoni do të pasqyrohen në gjendjen tuaj psikike, ndërsa në punë do të përqendroheni me vështirësi. Do t'iu mungojë dyshimi se partneri po iu fsheh diçka, sidomos nëse në të kaluarën keni pasur disa përvoja të këqija.

LUANI (23/VII-22/VIII)

Mos u ktheni pas ftesave për shoqërim dhe mos ikni nga diskutimet e ashpra sepse pas të gjithave do të qeshi të gjithë. Kujdes vetëm mos i mërzitni njerëzit që kanë shumë punë, qoftë fjala për familjar, miq apo bashkëpunëtor.

VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)

Do të realizoni një komunikim të gjallë edhe me bashkëpunëtor edhe me miq. Shumë brenga do t'iu shkaktojnë prindërit që do të kërkojnë ndihëm tuaj në momentin më të keq. Nëse jeni në lidhje, nga ju varet se si do të zhvillohen gjërat.

PESHORJA (23/IX-22/X)

Do të njiheni me njerëz interesantë në vende ku aspak nuk e keni pritur. Me lehtësi do të vendosni kontakt, duke e ditur se çka mund të prisni nga kushdo. Nëse dëshironi të zgjidhni problemet intime, kërkoni një mik të mirë.

AKREPI (22/X-21/XII)

Mund të shpresoni për rezultatet të mira në provime dhe negociata të punës. Edhe me pak fjalë do të arrini shumë, sidomos nëse pas jush qëndrojnë rezultate të mira. Zëri juaj i brendshëm do t'ua tregojë rrugën më ë shkurtër deri tek personi i dashur.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)

Raporti me rrethin e afërt kryesisht do të jenë të mira, ndonëse do të dini ta ngrehni zërin, pak kush do t'ua zë për të madhe. Do të veçoheni me ide të mira, e nëse jeni të lirë do të futeni në lidhje të re pa u menduar shumë.

BRICJAPI (22/XII-20/I)

Do të jeni të ashpër në fjalë, e nganjëherë edhe shumë sarkastik. Por një personi shkaku i sjelljes së tillë do t'i dukeni tërheqës dhe interesant. Bëhuni të durueshëm kur i zgjidhni çështjet familjare; mos refuzoni shanset për pajtim.

UJORI (20/I-19/II)

Në punë, gjërat do të zhvillohen ngadalë, andaj në dashuri do të keni mjaft sukses. Njohjet e reja dhe interesante do të ndodhin përmes bashkëpunëtorëve dhe njerëzve me të cilët jeni në kontakt të vazhdueshëm. Mos i zbuloni të gjithat rreth jush menjëherë.

PESHQIT (20/II-19/III)

Do të leni përshtypje të madhe në njerëzit me të cilët komunikoni, e disa prej tyre do t'iu ofrojnë jo vetëm bashkëpunim por edhe miqësi. Heshtja dhe misteri do të tregohen si taktik e shkëlqyeshme në pushtimin e personit që ju ka rënë në sy.



Mensur Mamuti	VEPËR E AUTORIT NË FOTO "... MBRETËRORE" / VEPËR E AUTORIT NË FOTO	M	ISH VOKALI I GRUPIT "QUEEN", MERKURI	PLAGOSJA, TË QËLLUARIT PËR VDEKJE (KRAHIN.)
FUSHË, VEND PA MALE E PA KODRA TË LARTA				
GAZI QË MBËSHTJELL TOKËN, OKSIGJENI / KËNGËTARI BOGUJEVCI				
I				
MARKË VETURASH GJERMANE / PREKJE E TË DREJTAVE				
C				
JO BARDHË			INTENSITETI / AKTORI EGJIPTAS, SHARIF	
LUMË NË ETIOPI				I YTI
KOHA	QË I TAKON ROMËS SË VJETËR	POEZI TË AUTORIT NË FOTO, "FSHATI ..."	LLAMBË NDRIÇIMI ME VAJGURÍ , FENER (SH. PASHQ.)	SULM / AUSTRIA	A	BISK QË DEL NË NJË BIMË (SHQ.) / DASMOR QË SHKON PËR TË MARRË NUSEN				
AUTORI KOSOVAR NË FOTO / KAFSHË SHTËPIAKE										
L				FUTBOLLISTI KILIAN, VIDAL / FLORI						
VEPËR E AUTORIT NË FOTO, "... I PËRHIMTË"							RUMANIA / ROK - BEND AMERIKAN		TEMPERATURA / SHËNIM NË GOLF	
E DHJETA QË PAGUHEJ SI TAKSË / TEPË KASHTË OKRE					THUPRA / ASTATI					
O				REGJISORI JAPONEZ, KUROSAVA / LL						Ë
QË ËSHTË ESELL						RADHË, VARG (BISED.)				

ZGJIDHJET: M, RRAFSH, AJRI, ISMET, AUDI, ÇENIM, ZI, I, OMO, A, GEMI, RIFAT KUKAJ, LOPA, ARTURO, MINAKU, R, T, ASHAR, SHKOPI, OKËR, AKIRA, ESËLLT, SËRË.

Sudoku

shumë i lehtë

		2			9	5		
9	5				2		3	4
			5	6				
	8							6
2			8		6			7
4							1	
			3	1				
6	1				5		8	2
		5			8	4		

mesatar

	6		4					2
						1		
		2						3
	4		2	8				
	7				6	4		
	8		9		4	7		6
4	3			9				
7						5		9
	9	8			5		3	

Shumë i lehtë: 172439568, 956782134, 843561729, 587193246, 231846957, 469257813, 728314695, 614975382, 395628471. **Mesatar:** 867431952, 354629178, 912578643, 641287395, 279356481, 583914726, 435192867, 726843519, 198765234.

Në një qendër votimi në Podujevë votuan 102 për qind?

Në një qendër votimi në Podujevë mund të jetë përsëritur kurioziteti i daljes në votime mbi 100 për qind. Në qendrën e votimit 1810E/02D, sipas rezultateve të paraqitura nga KQZ-ja në faqen zyrtare të saj del se kanë votuar 883 vetë nga 877 votues të regjistruar aty. Ose kthyer në përqindje

102.28 për qind. Nëse është kështu i bie se ka pasur keqpërdorim të votave. KQZ ka përmirësuar rezultatin e kësaj qendre tek pas pyetjes së shtruar nga Koha.net. Pas përditësimit i bie që aty janë numëruar 409 fletëvotime të vlefshme, nga 877 votues të regjistruar, apo 47.89 për qind.

Tjetër skandal në Hollywood, 40 gra akuzojnë regjisorin

Rasti i manjatit të filmave Harey Weinstein, i përfshirë në një skandal të madh seksual, duket se nuk ka qenë i izoluar në Holliywood. Pikërisht në kohën kur akuzat për të sa vijnë e shtohen, një tjetër regjisor i kandiduar për Oskar vihet në shënjestër të akuzave të ngjashme. Gati 40 femra akuzojnë James Toback për ngacmime seksuale. Gazeta amerikane "Los Angeles Times" tha se të paktën

31 prej tyre kishin treguar eksperiencat përgjatë 3 dekadave. Producenti, tani 72 vjeç mohon pretendimet dhe thotë se nuk kishte takuar asnjë prej femrave në fjalë. "Nëse e kam bërë ka qenë vetëm për 5 minuta, e nuk mbaj mend gjë", ishin fjalët e tij. Skenaristi dhe regjisori u kandidua për çmim Oskar në kategorinë e skenarit më të mirë për filmin "Bugsy" të vitit 1991.

Të trajtosh kancerin e mushkërive me krimba toke

Shkencëtarët polakë thonë se studimi i tyre mbi përdorimin e mundshëm të lëngut të krimbave për trajtimin e kancerit në mushkëri ka sjellë rezultate premtuese. Krimbat e tokës ushqehen me kërpudha, bakterie dhe mbeturinat e bimëve të pranishme në tokë dhe tretin çdo mikroorganizëm, si patogjenë ashtu edhe jo patogjenë. Për të mbijetuar në një mjedis të tillë, krimbat e tokës kanë evoluar duke krijuar një sistem imunitar të aftë për të mbrojtur veten nga in-

feksionet. Një nga këto mekanizma është në zorrët e tyre, të cilat prodhojnë substanca shumë të fuqishme bio-shkatërrimtare dhe antibiotike. Në provat e mëparshme laboratorike, lëngu i nxjerrë direkt nga krimbat ka vrarë qelizat e kancerit dhe qelizat e shëndetshme. Provat e fundit, rezultatet e të cilave janë dorëzuar për publikim dhe analizë të mëtejshme nga shkencëtarë të tjerë, ishin më të suksesshme. Ato përfshinin ngrohjen e lëngut në 70 gradë celsius dhe ndryshimin e dietës së krimbave. Gjatë provave në 75 deri 80 për qind të rasteve, qelizat e kancerit të mushkërive u shkatërruan, ndërsa qelizat normale mbetën të padëmtuara. Megjithatë, shkencëtarët thonë se duhen prova dhe analiza më të hollësishme të kësaj metode.

KALENDARI HISTORIK 25 TETOR

1390 - Gjykimi i parë i shtrigave në Paris.
1618 - Aventuristit, shkrimtarit dhe oborrtarit anglez Sir Walter Raleigh i prehet koka për gjoja komplot kundër Xhejmsit I të Anglisë.
1665 - Beteja e Ambuilës: Forcat portugeze mundin forcat Mbretërisë së Kongos.
1794 - Trupat franceze okupojnë Venlon.
1859 - Spanja i shpallë luftë Marokut.
1894 - Zgjedhjet e para për Republikën e Havait.
1914 - Rusia i shpall luftë Turqisë.
1915 - Aristide Briand bëhet kryeministër i Francës.
1923 - Turqia shpall pavarësinë (trashëgimtare e Perandorisë Osmane).
1947 - Belgjika, Luksemburgu dhe Holanda formojnë Bashkimin e Shteteve të Beneluksit.
1957 - Granatë dore eksplodon në Knesetin (Parlamentin) Izraelit.
2007 - Argjentina zgjedhë kryetarin e parë të shtetit femër, Cristina Fernandez de Kirchner.

A E DINI SE...

Kulla e parë në botë, është ajo e Babel-it. Njerëzimi e kishte ndërtuar atë për ta arritur qiellin. Në librin e Zanafillës shkruan kështu: Njerëzit donin ta mbërrinin qiellin. Kështu, vendosën ta ndërtonin një Kullë, përmes së cilës të arrinin lartë. Mirëpo, Perëndia duke e parë këtë gjest jot ë mirë të tyre, vendosi të shkatërroi atë (Kullën). Kjo ndikoi që njerëzit të shpërndaheshin kudo në botë, dhe të krijonin gjuhë dhe zakone të reja.

Një rol të rëndësishëm në fushën e letërsisë ka dhënë edhe autori pers Saadiu. Ai shkroi dy veprat e tij të famshme, Bostani dhe Gjylistani. Në veprën e parë ai shkroi fragmente nga jeta kulturore, mblodhi fakte të ndryshme që i dhanë ngjyrim jetës letrare. Ndërsa në veprën e dytë Gjylistani - autori shkruan për rregullat fetare (të një jete të shëndoshë). Një pjesë e rregullave të shkruara në këtë libër, janë huazuar edhe në shkrimet e shenjta monoteiste (Urdhërimet e Moisiut).

BARSOLETA

SA KOHË E KENI KËTË PROBLEM?

Një burrë, i cili kishte një problem seksual, shkon tek doktori dhe i thotë:
- Doktor kam një problem shumë të madh, kur bëj dashuri me gruan, nuk mund të rezistoj me shumë se 3 minuta.
Doktori: Sa kohë e keni këtë problem?
Zotëria: Qe atëherë që u martuam!
Doktori: Kishit rezistuar ndonjëherë më shumë, në këto vite që jeni i martuar?
Zotëria: Vetëm një herë, rezistova 1 orë e 3 minuta.
Doktori: Hmmm 1 orë e 3 minuta thatë? Kur ndodhi kjo?
Zotëria: Vjet në vjeshtë, kur u ndërrua ora.

THËNIA E DITËS

Kush di të lëpijë, di edhe të kafshojë! (Blasie Pascal)